

**Print ISSN 2222-5846**  
**Online ISSN 2312-5349**

**Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike**

**REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE**  
**ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW**  
Revistë Social Ekonomike katërmujore

Viti XXIX, Nr. 2 (111)  
(Maj – Gusht 2023)

Tiranë, 2023

**QSHKE**  
**QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE**  
**REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE**  
**ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW**  
**Revistë Social Ekonomike katërmujore**  
**Viti i XXIX, Nr. 2 (112)**  
**(Maj – Gusht 2023)**

**Komiteti shkencor**

Dr. Zef PREÇI – Kryeredaktor - Shqipëri  
Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES - Portugali  
Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO - Portugali  
Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA, Poloni  
Prof. Dr. Elena HORSKA, Sllovaki  
Prof. Dr. Fatmir MEMAJ - Shqipëri  
Prof. Dr. Heinz-Dieter WENZEL - Gjermani  
Prof. Dr. Iraj HASH - UK  
Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR - Slloveni  
Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA - Kosovë  
Prof. Dr. Luigi D'AMBRA - Itali  
Prof. Dr. Nasir SELIMI – Maqedonia e Veriut  
Prof. Dr. Statty STATTEV – Bullgari  
Prof. Dr. Shyqyri LLACI - Shqipëri  
Prof. Dr. Tomasz MROCZKOWSKI - ShBA  
Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS – Greqi  
Prof. Dr. Zhaklina PETO – Shqipëri  
Prof. Asoc. Dr. Dorina HOXHA - Shqipëri  
Prof. Asoc. Dr. Etleva LEKSKAJ - Shqipëri  
Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA – Rumani  
Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO - Itali  
Dr. Elmira KUSHTA - Shqipëri  
Dr. Zamira SINAJ - Shqipëri

**Redaktor:**

Prof. Dr. Fatmir MEMAJ

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike – QSHKE nuk është përgjegjëse për mendimet e shprehura nga autorët në artikujt e tyre. Mendimet janë thjeshtë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë as opinionet e QSHKE-së dhe as qëndrimet dhe opinionet e institucioneve ku autorët punojnë.

Me kërkesë zyrtare të palëve të treta të interesuara, botuesi vë në dispozicion deklaratën e origjinalitetit të nënshkruar prej autorëve të shkrimeve të botuara.

*Adresa e Redaksisë:*

*Rr. "Ismail Qemali", Nr. 1, Hyrja 1, Kati 3, Ap. 6*

*Kutia Postare 2934, Tiranë, SHQIPERI*

*Tel/Fax: 04 2274 603*

*Tirazhi: 1000 kopje*

## PËRMBAJTJA

---

ENIS URUÇI	Metodat dhe instrumentat e vleresimit ekonomik dhe shëndetëesor dhe Kontrolli i Shpenzimeve në Shëndetësi	f. 5
Skerdi ZAHAJ Denis MEMA	Dallimet gjinore në bjerrjen profesionale	f. 15
Matilda VELIU	A ndikojnë Rajonet në të Ardhurat e siguruara nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar? Rasti i Shqipërisë, para efektit të Covid-19	f. 25
Enriko CEKO	Një analizë deskriptive dhe regresive për vendet e Ballkani Perëndimor për indeksin e certifikatave ISO	f. 35
Armira LAZAJ Valma PRIFTI Dea SINOIMERI	Tendencat e fundit në investimet e huaja direkte (IHD). Rast Studimi: Ballkani Perendimor	f. 53
Denisa MILLO Nevila BACI Bejana SPAHO	Chatbot-i, rëndësia dhe përdorimi i tij: Rast studimi i krijimit të një modeli të thjeshtëzuar në Python	f. 63
Klei KAÇUPI	Vështrim historik i dorëzarisë si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve	f. 73
Ines DIKA	Largimi i trurit dhe faktorët që ndikojnë	f. 81
	Komiteti shkencor	f. 91
	Recenzentë në këtë numër	f. 96
	Kriteret për botimin e artikujve	f. 97



# METODAT DHE INSTRUMENTAT E VLERESIMIT EKONOMIK DHE SHENDETESOR DHE KONTROLLI I SHPENZIMEVE NE SHENDETESI

Dr. ENIS URUCI<sup>1</sup>, Dr. Emirjeta KUNIQI<sup>2</sup>

## Abstract

In order to make the study of health from an economic point of view possible, appropriate working instruments must be used to study and analyze. Most of these instruments have been perfected by economists who have proven their efficiency in this field. These methods are treatment methods that allow us to derive some objective criteria to enable the solution of a problem in the field of health economics.

Knowing these criteria makes it possible for us to critically analyze the various problems that arise in health systems.

These are:

- Comparison instruments
- Cost-benefit studies.
- cost efficiency.
- cost-debit

The specificities and shortcomings that characterize the health market dictate the methods that make it possible to clarify decisions and determine the choice that must be made. These methods have their starting point from some others used a few years ago and known as "rationalization of budget choices" (RZB) in France and "systems planning, rationalization and budgeting (PRB) in America. To evaluate a health policy, a health care strategy, or a prevention program, you must deliver on their value. This definition is not very clear, so it should be defined well. It is important to know who makes the judgment, how this judgment was made, what is the evaluation scale that is used, that is, what is the "instrument" that allows us to compare a decision with other possible ones.

This instrument would enable us to classify the possible decisions in relation to each other and sometimes, we also express some degree of preference. It is clear that the solution of the comparison instrument and all the policies and strategies that are compared will condition the outcome of this evaluation.

## Hyrje

Për të bërë të mundur studimin e shëndetit nga pikëpamja ekonomike, duhen përdorur instrumente pune të përshtatshme për të studiuar dhe analizuar. Shumica e këtyre instrumenteve janë prefeksionuar paraprakisht nga ekonomistët, të cilët e kanë provuar efikasitetin e tyre në këtë fushë. Këto metoda janë mënyra trajtimi që na lejojnë të nxjerrim disa kritere objektive për të mundësuar zgjidhjen e një problemi në fushën e ekonomisë së shëndetit.

Njohja e këtyre kritereve na bën të mundur të analizojmë në mënyrë kritike problemet e ndryshme që u dalin sistemeve të shëndetësisë.

Këto janë:

---

<sup>1</sup> Lektor, Universiteti Aleksander Moisiu, Durres, e-mail: .enisuruci@gmail.com

<sup>2</sup>Lektore, Universiteti Aleksander Moisiu, Durres, e-mail: emirjetakuniqui@gmail.com

- *Instrumentat e krahasimit*
- *Studimet kosto-fitim.*
- *kosto efikasitet.*
- *kosto-debi.*

Specifikat dhe mangësitë që karakterizojnë tregun e shëndetit diktojnë metodat të cilat bëjnë të mundur sqarimin e vendimeve dhe përcaktojnë zgjedhjen që duhet bërë. Këto metoda e kanë pikënisjen nga disa të tjera të përdorura disa vite më parë dhe që njihen me emrin “racionalizimi i zgjedhjeve buxhetore” (RZB) në Francë dhe “planifikimi, racionalizimi dhe buxhetimi i sistemeve (PRB) në Amerikë. Për të vlerësuar një politikë shëndeti, një strategji të ndihmës mjekësore ose një program parandalimi, duhet të japësh mbi vlerën e tyre. Ky përkufizim është jo shumë i qartë, ndaj duhet përcaktuar mirë. Është e rëndësishme të njohësh se kush e bën gjykimin, si është marrë ky gjykim, cila është shkalla e vlerësimit që përdoret, domethënë cili është “instrumenti” që na lejon të krahasojmë një vendim me të tjerë të mundshëm.

Ky instrument do të na mundësonte klasifikimin e vendimeve të mundshme në raport me njëri - tjetrin dhe ndonjëherë, edhe ne shprehim ndonjë shkallë preference. Është e qartë se zgjidhja e instrumentit të krahasimit dhe e të gjitha politikave dhe strategjive që krahasohen do të kushtëzojnë rezultatin e këtij vlerësimi. Prandaj, duhet njohur se kush e zgjedh instrumentin dhe se si strategjitë alternative janë përgjedhur. Instrumente të krahasimit janë të shumta por ato të gjitha ngrihen mbi të njëjtin parim.

Një sërë kriteresh përcaktohen për të përshkruar rrjedhojat e çdo strategjie që është në vlerësim.

Këto kritere zgjidhen në mënyrë që të jetë e mundur të klasifikosh në raport me secilin prej tyre rrjedhojat e strategjive që duam të krahasojmë.

Problemet teknike që hasim gjatë përpilimit të procesit të vlerësimit. Problem parësor është ai i metodave të matjes. Si mund të përcaktohet shuma e shpenzimeve të duhura gjatë përdorimit të një strategjie të dhënë? A mund të përcaktohet duke u nisur nga një protokoll i ndihmës mjekësore teorike ose nga një studim i shpenzimeve të kryera mbi një protokoll i ndihmës mjekësore teorike ose nga një studim i shpenzimeve të kryera mbi një grup pacientësh të zgjedhur me kujdes? Në këtë rast, a duhet të përdoret një shpenzim mesatar apo të bazohet në klasifikimin duke u nisur nga cilësitë e shpërndarjes statistikore të shpenzimeve? Në të njëjtën mënyrë, do të duhet të përcaktohet protokollit statistikor që do të çojë në përfundimin se probabiliteti i shërimit me një strategji të caktuar është më i madh se ai i një strategjie tjetër. Zgjidhja e këtyre problemeve nuk është e thjeshtë, për këtë na vijnë në ndihmë metodat statistikore, kalkulimet e probabilitetit, epidemiologjia dhe ekonometria. Problem i dytë lidhet me transformimin (shndërrimin) e klasifikimeve të strategjive sipas çdo kriteri, në një klasifikim të vetëm dhe global që mundëson përcaktimin e strategjisë më të mirë (në funksion të procesit të vlerësimit të adaptuar paraprakisht).

Ky problem quhet “agregati i preferencave”. Një ndër të parët që e studioi ishte markezi i Condorcet.

### **Studimet kosto-fitim**

Studimet kosto-fitim kryhen për të realizuar lidhjet që kanë kostot e nje veprimi mjekësor me rrjedhojat e tyre të shprehura në vlera monetare. Këto shpenzime përcaktojnë një nomenklaturë që i shpreh të gjitha kriteret në terma monetare. Për secilin nga këto kriteret, llogaritet vlera absolute e diferencës midis modalitetit që afron strategjia që vlerësohet. Kostoja e strategjisë del duke mbledhur vlerat absolute të këtyre ndryshimeve (diferencave) për kriteret në rastin e të cilëve, situata e referimit parapëlqehet ndaj strategjisë në fjalë. Fitimi del duke mbledhur vlerat absolute të diferencave për kriteret në rastin e të cilëve strategjia në fjalë parapëlqehet ndaj situatës së referimit.

Për t'a ilustruar marrim shembullin e mëposhtëm:

Duke vlerësuar dy strategji parandaluese të osteoporozës nëpërmjet një trajtimi hormonal (zevendësues) tek gruaja në menopauzë.

I - Strategjia e parë konsiston në dhënien grave, që nuk paraqesin ndonjë kundër-indikim, një trajtim hormonal përgjatë 15-viteveve duke filluar nga mosha 50 vjeç.

II - Strategjia e dytë ka të bëjë me dhënien e të njëjtit trajtim përgjatë gjithë jetës grave të moshës 50-vjeç e lart që nuk paraqesin ndonjë kundër-indikim.

- Situatë e referimit konsiston në faktin që nuk ndërmarrim asnjë veprim.

Duhet të vendoset se cilat nga strategjitë do të pëlqejnë.

Ne mund të zgjedhim një nga dy procedurat e quajtura aggregate:

#### **1. Agregati kosto-fitim absolut.**

Agregati kosto-fitim absolut konsiston në zgjedhjen e strategjisë që jep fitim më të lartë d.m.th.diferenca më e madhe midis fitimit dhe kostos.

#### **2. Agregati kosto-fitim relative.**

Në prespektivën e një agregati kosto-fitim relative, strategjia e trajtimit gjatë gjithë jetës parapëlqehet kësaj radhe ndaj strategjisë së trajtimit për 15 vjet.

Sado të përpikta, këto metoda llogaritjeje japin rezultate të kundërta duke e lënë vëzhguesin në mëdyshje.

Në fakt, në ekonominë e shëndetit më shumë se në çdo vend tjetër, intesiteti paraqesin jo aq rezultatet "bruto" se sa vetë diskutimi i këtyre rezultateve në funksion të hipotezave që kanë qenë formuluar. Çdo konkluzion mund të vihet në pikëpyetje nga zbatimi i një metodologjie tjetër të bazuar në hipoteza të ndryshme.

### **Studimet kosto-efikasitet**

Studimet kosto-efikasitet hedhin dritë mbi lidhjen që ekziston midis kostove të një veprimi mjekësor dhe rrjedhojave të tij të shprehura në njësi fizike. Në këto studime përdorim një procedurë agregati nomenklatura e të cilit përbëhet nga një kriter jomonetar (kriter i efikasitetit) dhe nga disa kriteret, njesitë e të cilëve shprehen në sasi monetare. Kriteret monetare përfshihen në një kriter të vetëm, që është fitimi i strategjive në fjalë në raport me një strategji referencë. Çdo strategji e bashkangjitet fitimi që sjell efikasitet në raport me situatën e referimit.

Ekzistojnë dy procedura për të ndihmuar të marrjen e një vendimi:

- Agregati kosto-efikasitet i marrë mesatarisht.
- Agregati kosto-efikasitet marzhinal.

Edhe njëra edhe tjetra strategji kanë të njëjtin objektiv atë të daljes në një situatë ku efikasiteti i të dy strategjive është i njëjtë dhe pastaj të krahasohen kostot e tyre respektive. Është e nevojshme të supozohet se për çdo strategji që fitimi është funksion i nivelit të efikasitetit të fituar.

Në agregatin kosto-efikasitet mesatar supozohet që ky funksion të jetë i tipit linear. Është pra, e mundshme llogaritja e fitimit të një njësie efikasiteti dhe strategjia do të jetë ajo strategji, fitimi i së cilës për një njësi efikasiteti do të jetë më i madh.

Në rastet e shpeshta, ku kjo strategji nuk mund të përmbushet, mund të përdoret agregati kosto-efikasitet ” marzhinal”. Agregati kosto-efekasitet marzhinal nxjerr vështirësi në vënien në përdorim, sepse ai supozon që fitimet dhe efikasitetet e të dy strategjive që krahasohen të jenë të përafërta.

Nga ana tjetër, është e nevojshme të përcaktohet se për secilin nga të dy nivelet e efikasitetit do të kryhet klasifikimi i fitimeve, në nivelin e efikasitetit të strategjisë së parë apo të së dytës.

### **Kontrolli i Shpenzimeve në Shëndetësi.**

Progresioni i shpenzimeve në shëndet, shqetëson më tepër shoqërinë se progresioni i tipave të tjerë të konsumimit.

Financimi i shëndetit kolektiv, do të jetë në fakt, gjithmonë e më tepër i vështirë, sigurisht pa limite, sidomos për vendet me rritje të dobët ekonomike. Nëse pjesa më e madhe e analizave ekonomike dëmtojnë progresin konstant të shpenzimeve në shëndet, aspektet positive të saj nënvizohen rrallë.

Sektori i shëndetit merr pjesë kështu në shumë nivele të zhvillimit ekonomik:

- Në zhvillimin e sektorit të rëndësishëm të industrisë së medikamenteve që kanë një treg të favorshëm në eksportime.
- Në zgjatjen e jetës aktive të individëve që përmirëson produktivitetin e punës.
- Në zhvillimin e vendeve të punës sanitare të lidhur direkt ose indirect me shëndetin.

### **Metodat kryesore të analizës së koston**

Metoda më e përdorur në analizën e koston është ajo që konsiston në krahasimin e koston me sasinë e produkteve të shëndetit. Megjithatë, këto janë mjaft të vështira për t'u matur, meqë shëndeti matet me vështirësi nga ana sasiore dhe cilësore. Në spital p.sh. llogaritja e koston për ditë shtrimi në spital bëhet shpesh. Bëhet fjalë për çmim mesatar në ditë, i cili përfaqëson vetëm në mënyrë jo të plotë koston reale. Në fakt, një i sëmurë në spital nuk konsumon rregullisht të njëjtën sasi kujdesi çdo ditë qëndrimi në spital. Për më tepër, çdo i sëmurë ka një sjellje dhe një kërkesë të ndryshme në të njëjtin spital, aq më tepër në spitale të ndryshme. Llogaritja e koston për të sëmurë të shtruar në spital është më e saktë, por numri i madh i sëmundjeve, format e stadet e ekonimizimit të tyre kërkon bërjen e një klasifikimi. Kjo do të lejojë marrjen në konsideratë të një kostoje mesatare të sëmundjeve përballë konsumimeve të krahasueshme. Kjo metodë e



importuar nga SHBA ka nxitur projektin financiar të medikalizimit të sistemit të informacionit, për të cilin do të flitet më poshtë.

Një tjetër tip llogaritjeje lejon të ndërtohet një relacion matematikor midis mjeteve të përdorura dhe rezultateve të marra në saj të këtyre mjeteve. Ky relacion, i quajtur model, do të lejojë si për të bërë parashikime, ashtu edhe për të studiuar skenarët (simulim i përfundimeve).

### **Evolucioni i zakonshëm i shpenzimeve në shëndet.**

Shpenzimet e shëndetit rriten me pasurimin e vendeve. Rritja e shpenzimeve të shëndetit (për banorë) përbën kështu shpesh një tregues të zhvillimit ekonomik. Shoqëritë moderne shtyhen gjithnjë e më tepër në bërjen e gjykimeve midis financave të shëndetit, ato të edukimit, të mbrojtjes, urbanizimit etj. Shpesh vërehet se rritja e shpenzimeve në shëndet rritet më shpejt se PBB (prodhimi i përgjithshëm bruto).

Kjo ngritje e kostos, nëse ajo është krejtësisht e ponderuar nga inflacioni mund të shpjegohet në disa mënyra:

- Shfaqja konstante e teknikave të reja.
- Specializimi në rritje të praktikentëve dhe zhvillimin e medikamenteve të reja.
- Rritja e kërkesës për shëndet të populates.
- Evolucioni i menyrës së jetesës.
- Theksimi i fatkeqësive të reja (SIDA, sëmundja Alzheimer, toksikomanitë).
- Nga zhvillimi i demografisë medikale, përgjegjës i një kërkese induite.
- Nga mekanizmi i fortë i problemeve sociale lidhur me mungesën e strukturave adaptive të pritjes. - Nga zhvillimi i tepruar i formave të shpenzimit të kotë.

Rritja e kostos së shëndetit është e tepruar me që ajo reflekton drejtpërsëdrejti evoluimin e shoqërive. Pjesa e shpenzimeve në shëndet të një vendi është në këtë vështrim, një tregues i zhvillimit të saj.

### **Tarifikimi në mjedis hospitalier**

Përpunimi i një tarifikimi hospitalier ka shumë problem për shumë arsye: Pjesa më e madhe e spitaleve publike në botë subvencionohen tërësisht nga shteti, regjioni, komuna ose organizma bamirëse. Funkzionimi i spitaleve evolon në mënyrë të konsiderueshme në kohë. Aktualisht, spitalet e mëdha marrin përsipër funksionet e shërbimit, kujdesit spitalor, konsultat, mësimdhënien si dhe kërkimin shkencor. Një pacient si dhe kujdesi që ai merr për sëmundje e tij në një mjedis të dhënë, përbëjnë çdo herë një ansambël unik që e bën të vështirë përpunimin e kufijve tarifor. Sistemi më i thjeshtë dhe më i përdorshëm është ai i çmimit të ditës së qëndrimit. Ky i faturohet të sëmurit ose siguracionit të tij për çdo ditë të kaluar në spital. Ky sistem nuk është shumë i mirë meqë ai bën pjesë për një akord që i "përfshin të gjitha", ndërsa çdo i sëmurë nuk kërkon gjithë kohën kujdes në të gjitha shërbimet. Shërbimet kanë prirje për të mbajtur pacientët në shtrat më tepër që i kërkon gjendja e tyre. Në SHBA në fillim të viteve 80 u fut një tarifikim prospektiv i shpenzimeve të shtimit në spital marrë në ngarkim nga

shteti për personat e shkuar në moshë dhe personat e varfër. Ky tarifikim bazohet në marrjen në konsideratë të kostos mesatare të një tipi sëmundjesh, dhenë sipas grupit homogjen të sëmundjes.

### **Përfaqja e kostos me sëmundjen .**

Problem i kostos së sëmundjes është një fushë mjaft e rëndë e mjaft e rëndësishme e ekonomisë së shëndetit. Vlerësimi i kostos për çdo patologji lejon, gjithashtu të krahasohen sëmundjet midis tyre dhe të realizohen përparësitë në kuadrin e një planifikimi sanitarë. Ky tip studimi është gjithashtu mjaft i rëndësishëm për të treguar që shpenzimet e shëndetit, nëse ato janë adekuate, nuk përbëjnë shpenzime ” bosh” për shoqërinë, por mund të konsiderohen si një investim i vështirë financiar.

### **Kostoja direkte**

Këto kosto direkte përfaqësojnë atë të kujdesit të konsultimeve, të medikamenteve, të shtrimit në spital, shpenzimet e transportit etj. Edhe më delikate është marrja në konsideratë e kostos së amortizimit të vlerave mobilare që kanë kushtuar shumë para direkt në kujdesin ndaj të sëmurit. Në të gjitha rastet përdorimi i tarifikimeve të caktuara zyrtare nuk rekomandohet me që ato respektojnë vetëm koston reale të shpenzimeve.

### **Kostoja indirekte**

Një sëmundje ka një kosto ekonomike më të rëndësishme se ajo e shpenzimeve të thjeshta mjekësore, një pacient i sëmurë është në fakt gati gjithmonë i detyruar të ndërpresë aktivitetin e tij profesional për një periudhë që është e dëmshme për punëdhënësin dhe indirekt për shoqërinë. Për më tepër sëmundja është përgjegjëse për shpenzime të shumta ose hargjim kohe shtesë për të sëmurin dhe mjedin e tij. Të gjitha këto shpenzime duhet të merren në konsideratë në koston totale të sëmundjes. Ajo përbën koston indirekte dhe konsiderohen nga ekonomistët si një kosto e vërtetë sociale nga humbja e mundshme e prodhimit.

Shuma e kostos direkte dhe indirekte përfaqëson koston totale të sëmundjes. Është e mundur të llogaritet për pacient ose për sëmundje në një unitet si rajon ose shtet. Njohja e kostos së çdo sëmundje lejon realizimin e krahasimeve midis patologjive ose për të njëjtën patologji midis vendeve. Këto krahasime janë të vlefshme për krahasimin e impakteve në shoqëri, aq të nevojshme për të drejtuar vendimet e politikës sanitare.

Koncepti i kostos së sëmundjes çon 12 në çdo rast në në funksionin e individit në shoqëri. Ky funksion ka një çmim dhe shtron problem universal të çmimit eventual të jetës moderne.

### **Konkluzione.**

Open Data Albania po hulumton mbi shpenzimet buxhetore për Shëndetësi planifikuar për vitin 2022. Sipas klasifikimit funksional shëndetësia është një nga dhjetë funksionet që garantojnë nga shteti. Në këtë funksion përfshihen shpenzime për: Produktet mjekësore, aplikimet, dhe pajisjet; Shërbimet ambulator (për pacientet e jashtëm-pra që

nuk kërkojnë hospitalizim); Shërbimet spitalore; Shërbimet e shëndetit publik; kërkim dhe zhvillim në sektorin e shëndetësisë etj të paklasifikuara por që lidhen me Sektorin. Tek Shpenzimet e analizuara për shërbim shëndetësor janë konsideruar vetëm shpenzimet që mbulohen me fonde publike nga shteti si përgjegjës për ofrimin publik të kujdesit shëndetësor, pra nuk konsiderohet ofrimi privat i shërbimeve mjeksore.

Për vitin 2022 planifikohen rreth 65 miliardë lekë nga Buxheti për ofrimin dhe garantimin publik të funksionit shëndetësor nga 638 miliardë lekë që është planifikuar totali i shpenzimeve buxhetore. Shpenzimet për Shëndetësinë janë planifikuar sa 10.2% etotalit shpenzime buxhetore të vitit. Kjo vlerë parashikon rritje nominale të mbështetjes buxhetore për shëndetësinë me rreth 7.5 miliardë lekë më shumë së plani i vitit 2021.

### **Shpenzimet ne Shëndetësi zënë 3.5% të Produktit të Brendshëm Bruto.**

Nga këto fonde, rreth 58 përqind ose 37.85 miliardë lekë janë financim për skemën e Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme për Kujdes Shëndetësor (FSDKSH) planifikuar për vitin 2022.

Referuar klasifikimit ekonomik të shpenzimeve pra sipas natyres së transaksionit, vërehet se shpenzimet korrente dominojnë shpenzimet e shëndetësisë, përkatësisht rreth 95.6 përqind kundrejt vetëm 4.4% Investime. Shpenzimet korrente janë për: paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli; kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore; mallra dhe sherbime te tjera; subvencionet; transferimet korrente te brendeshme; transferimet korrente jashte; transferta per buxhetet familiare dhe individet; fondi i veçante dhe rezervat. Nga ana tjetër shpenzimet kapitale apo investime janë thuajse të papërfillshme në shëndetësi 4.4% ose 2.9 miliardë lekë.

Pavarësisht rritjes së financimit të shpenzimeve shëndetësore, niveli mesatar i shpenzimeve për banorë sektori Shëndetësi Publike, mbetet në nivele të ulëta. Referuar planifikimit për vitin 2022, nëse shpenzimet totale për shëndetësi do të përktheheshin në shpenzime për banor, rreth 22 679 (njëzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë janë shpenzime vjetore në shëndetsi për banor. Ky mbulim shëndetësor është pothuaj sa detyrimi direkt për kontribut shëndetsor që paguhet nga një individ me pagë mesatare (56 mijë lekë). Duke konsideruar detyrimin e kontributit shëndetësor në masen 3.4 përqind e pages mujore (1.7% nga punëdhënës dhe 1.7% nga punëmarrës) një individ me pagë mesatare paguan total rreth 23 mijë lekë në vit. Megjithatë ky nuk është detyrimi i vetëm që paguan qytetari për kontribut shëndetësor. Po nga buxheti i shtetit planifikohen për financimin e Fondi të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor rreth 15 miliardë lekë, këto financohen nga kontribute e të tjera, pra nga kontributet që zbriten nga paga, ndërsa pjesa më e madhe ose 37.8 miliardë lekë janë transfertë e buxhetit të shtetit nga taksa apo të ardhura të tjera që Shtetit i transferon për Fondin për të mbuluar shërbimin mjekësor publik në tërësi. Kjo transfertë financohet nga të ardhura nga taksa apo tatime apo burime të tjera që mblidhen, që do të përkthehej si një pagesë shtesë vjetore me mesatare për banor rreth 13 mijë lekë. Pra një qytetar që ka një pagë mesatare paguan drejtpërdrejtë 23 mijë lekë si detyrim për kontributin shëndetsor, por paguan dhe 13 mijë lekë si detyrime taksash apo të tjera për të mbuluar shpenzimet shëndetësore për popullsinë jo aktive ekonomikisht. Detyrimi total për shpenzime shëndetësore

vjetore për një individ të punësuar me pagë mesatare rezultojnë rreth 36 mijë lekë, ndërkohë që shpenzimet për shërbim shëndetësor për banorë në Shqipëri rezultojnë më pak 23 mijë lekë.

Nga analiza kosto-përfitime konstatohet se detyrimet e një individi me pagë mesatare apo pagë mbi atë mesataren, janë shumë më të larta se mbulimi shëndetësor që përfitojnë publikisht nga shteti. Por edhe një individ me pagë minimale paguan më shumë detyrime direkte dhe indirekte për mbulim shëndetësor krahasuar më nivelin mesatar të përfitimit. Sa më e larta paga që përfiton një i punësuar aq më i lartë dhe kontributi shëndetësor që paguan, kështu hendeu detyrim-përfitime sa vjen e thellohet. Defekti dhe Deficiti në Skema dhe Fonde Publike të Detyrueshëm për efekt Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, vjen në thellim. Kjo e ndikuar edhe nga politika fiskale që aplikon shteti ku vetëm të punësuarit taten në mënyrë progresive. Janë rreth 48% të të punësuarve në vend të deklaruar si të punësuar me pagë minimale ose të vetëpunësuar. Kategoria e dytë më shumë se grup me të ardhura të vogla nga aktiviteti, përkon me individ që kanë zgjedhur të përfitojnë nga angazhimi profesional si persona fizik të vetëpunësuar, ku detyrimet tatimore janë minimaliste krahasuar me detyrimeve që kanë rrogëtarët.

#### LITERATURA

1. Frank H.R. and Bernanke S. B. (2004). Principles of Economics, Second Edition, New York, USA, by the McGraw-Hill Companies.
2. Hysa, B. (2004). "Basic principles of the economy of health", SHBLU Tirana, pp.119 and 271.
3. Jacobs, P. (2003). *The Economics of Health and Medical Care*.
4. King, R. (2003). Across the sea and over the mountains: documenting *Albanian migration*, in: Scottish Geographical Journal 119 (3), 283-309.
5. Ministry of Health (2004). Long term Strategy of the Development of the Albanian Health Sector. Chapter "Health Services", Tirana, p. 32.
6. Scalera, F. (2011). "Peugeot Celebrates its 200 Years of Life. History, Strategies, Organization and Future Prospects of the French Car Company. A Comparison with Fiat Auto," *Procedia – Social and Behavioral Sciences*, Elsevier, Vol. 24, p. 1253. On-line ISSN: 1877-0428; DOI: 10.1016/j.sbspro.2011.09.031.
7. Stephen, P. R. and DeCenzo, D. (2012). "Management Foundations, Concepts and Basic applications", UET PRESS publication, Tirana, pp.37-38.
8. Stephen, P. R. and DeCenzo, D. (2012). "Management foundations, Concepts and basic applications", UET PRESS, Tirana, p. 35.
9. Uruci, E. (2006). "Albanian migration and Labor Market", 3<sup>rd</sup> Publication, International Conference, "Regional Economic Cooperation in South East Europe", Bulgaria, pp. 264-283.
10. Uruci, E. and Kuniqi, E. (2014). "Health market and policies of the public sector in Albania", scientific article in the international Conference "Toward EU single market: Experiences, models and proposals in the integration process", "Aleksander Xhuvani" University, Elbasan.
11. Uruci, E., Mema, M. and Sokoli, J. (2011). "Economics Managerial", TOENA publications, Tirana.

- 12.Uruci, E. and Scalera, F. (2014). "Health market in Albania, problems and challenges", scientific article in the international scientific Conference "Economic Policy and EU integration", UAMD, Durres, pp. 2.
13. Womack, J. and Jones, D. (1997). "Lean Thinking", Guerini & Associati, Milano, p. 59.
14. World Bank/IMF (2004). "Albania: Joint Staff Assessment of the Poverty Reduction Strategy Paper Annual Progress Report".
- 15.Prof.Dr. Bakllamaja Arben- Disa vleresime e konsiderata mbi temen e doktoratures te studentit doktoral Enis Uruci "Tregu shendetesor ne Shqiperi, probleme dhe sfida". Viti 2014.
- 16."Strategjia afatgjate e sistemit shendetesor ne Shqiperi", Viti 2004, Botim I Ministrise se Shendetesise.
- 17.Strategjia afatgjate e Zhvillimit te Sistemit Shendetesor Shqiptar. Kapitulli "Sherbimet Shendetesore".
- 18.Prof. Dr. Bajram Hysa "Parimet baze te ekonomise se shendetit", Viti 2004.
- 19.Stephen P.Robbins & David DeCenzo "Bazat e menaxhimit, Koncepte dhe aplikime themelore", Botim I UET PRESS.
- 20.PhD. Cand.Uruci Enis- Prof.Dr.Scalera Francesco, "Tregu shendetesor ne Shqiperi, probleme dhe sfida", Artikull shkencor ne Konferencen shkencore nderkombetare "Economic Policy and EU integration", UAMD, Durres,Viti 2014.
- 21.PhD. Cand.Uruci Enis- MSc.MD Kuniqi Emirjeta, " Tregu shendetesor dhe politikat e sektorit publik ne Shqiperi", Artikull shkencor ne Konferencen nderkombetare " Toward EU single market: Experiences, models and proposals in the integration process", Universiteti "Aleksander Xhuvani", Elbasan,Viti 2014.
- 22.Prof.Dr.Uruci Esmeralda, Prof.Dr.Mema Mit'hat, MSc. Sokoli Julinda "Ekonomiks Menaxherial", Botime TOENA, Tirane 2011.
- 23.Prof.Dr.Uruci Esmeralda , "Albanian migration and Labor Market", Botim I 3<sup>rd</sup> International Conference, "Regional Economic Cooperation in South Eastern Europe", Viti 2006, Bulgaria.
- 24.Frank H.Robert, Bernanke S.Ben, Principles of Economics, Second Edition, Viti 2004, New York,USA, by the McGraw-Hill Companies.
- 25.Stephen P.Robbins & David DeCenzo "Bazat e menaxhimit, Koncepte dhe aplikime themelore", UET PRESS.
- 26.Adam Smith –Pasurite e kombeve 1776.
- Frederik Taylor –Parimet e menaxhimit shkencor 1911.
- Katermbedhjetë parimet e menaxhimit nga Fayol.
- Burokracia ideale e Weberit.
- Hugo Munsterberg –Psikologjia dhe eficensa industriale 1913.
- Chester Barnard- Funksionet e drejtuesve ekzekutiv 1938.
27. FDI, Theory, evidence and practise-Imaad A. Mossa 2002
- 28.Dunning, John H. (2000-4). "The eclectic paradigm as an envelope for economic and business theories of MNE activity". Retrieved 2011-10-12.
- 29.UNCTAD UNDP Albania- Raporti i Investimeve te Huaja Direkte ne Shqiperi 2010
- 30.UNCTAD UNDP Albania- Raporti i Investimeve te Huaja Direkte ne Shqiperi 2011
- 31.OECD (2010). "South East Europe - Investment Reform Index 2010: Monitoring Policies and Institutions for Direct Investment", Paris: OECD.
- 32.UNCTAD (WIR10). World Investment Report 2010: New York and Geneva: United Nations.

33. Banka Botërore, IFC, Të bësh biznes, 2011: Të sjellësh ndryshimin për sipërmarrjet, botim i përbashkët i Palgrave MacMillan, IFC dhe Bankës Botërore Uashington D.C.: Bank
34. Stjepan Tanic- Eastern Europe and Central Asia Agroindustry Development Country brief, ALBANIA FAO Regional Office for Europe and Central Asia.
35. Banka e Shqipërisë- Analizë e zhvillimeve në sektorin e jashtëm të ekonomisë-2012, O. Mitre, M. Boka, Departamenti i Politikës Monetare, Prill 2013.

# DALLIMET GJINORE NË BJERRJEN PROFESIONALE

## Skerdi ZAHAJ<sup>1</sup> and Denis MEMA<sup>2</sup>

### **Abstract:**

(1) Background. (1) In the majority of professional fields, extended working hours are recognized as a significant contributing factor to the development of occupational burnout and the presence of psychological concerns. While prolonged working hours pose a risk, gender differences have been observed in the perceived symptoms of burnout and the experience of psychological symptoms. (2) Objective: This study aims to assess the association between working hours and the development of burnout symptoms. Additionally, it explores gender differences and examines the impact of early maladaptive schemas on burnout development. (3) Method: A total of 200 professionals participated in the study and completed three assessment tools: The Burnout Assessment Tool (BAT), the Perceived Stress Scale (PSS-10), and the Symptom Checklist-90 (SCL90). The Young Schema Questionnaire-Short Form (YSQ-SF) was also administered to evaluate early maladaptive schemas. (4) Results: Female participants displayed higher scores in burnout and its components, as well as in psychological symptoms. However, no gender differences were observed in early maladaptive schemas or in the development of burnout. (5) Conclusions: Within the same professional environments, female professionals may be more susceptible to developing burnout symptoms when exposed to extended working hours. The implementation of training strategies aimed at addressing occupational burnout may contribute to mitigating its impact.

**Keywords:** perceived distress; burnout; early maladaptive schemas

### **I. Hyrje**

Në mjediset e sotme ku ritmi i punës është i shpejtë dhe kërkues, bjerrja profesionale është bërë një term shumë i njohur. Ndërsa individët përpiqen të përmbushin pritshmëritë dhe presionet gjithnjë në rritje të punës së tyre, shumë e gjejnë veten të bllokuar në një cikël frustrues të stresit kronik. Kjo sindromë e lidhur me profesionin, e njohur si bjerrje profesionale, mund të ketë pasoja shkatërruese në mirëqenien, produktivitetin dhe cilësinë e përgjithshme të jetës.

Bjerrja profesionale përfaqëson një sindromë psikologjike që përfshin ndjenjat e rraskapitjes, cinizmit dhe joefikasitetit brenda mjedisit të punës. Ajo konsiderohet si një gjendje e shkaktuar nga stresi e përjetuar nga individët, e ndërthurur me dinamika të ndërlikuara sociale dhe përfshin perceptimin e dikujt si për veten ashtu edhe për kolegët në vendin e punës. Në kontrast me modelet e thjeshta të stresit, kjo kornizë gjithëpërfshirëse e përcakton bjerrjen nga tre elementët e saj themelorë: (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2019)

Rraskapitja ka të bëjë me përvojën e të qenit i ezauruar dhe i varfëruar nga burimet emocionale dhe fizike. Individët e prekur nga bjerrja profesionale ndihen plotësisht bosh dhe të paaftë për t'u rikuperuar. Atyre u mungon energjia e nevojshme për t'u

---

<sup>1</sup> Departamenti i Psikologjisë dhe i Pedagogjisë, Universiteti i Tiranës, Email: skerdizahaj@gmail.com

<sup>2</sup> German Agency for International Cooperation GmbH, Email: denis.mema@giz.de

përballur me një ditë tjetër ose për të ndihmuar të tjerët në nevojë. Ky komponent i raskapitjes përfaqëson dimensionin themelor të stresit brenda kontekstit të bjerres. (Maslach & Leiter, 2007).

Cinizmi përfshin një qëndrim negativ, armiqësor ose tepër të shkëputur ndaj punës së dikujt, shpesh i shoqëruar nga një humbje e idealizmit. Kjo përgjigje zakonisht lind si një mekanizëm mbrojtës në reagim ndaj lodhjes së madhe emocionale, duke shërbyer si një mburojë emocionale për shqetësimin. Megjithatë, ekziston një rrezik i mundshëm që kjo shkëputje të mund të evoluojë në dehumanizim. Komponenti i cinizmit nënkupton dimensionin ndërpersonal të bjerres profesionale. (Maslach et al, 2001).

Joefikasiteti është një ndjesi e rënies së kompetencës dhe produktivitetit brenda vendit të punës. Individët fillojnë të zhvillojnë një ndjenjë të pamjaftueshmërisë në lidhje me aftësinë e tyre për të kryer punën në mënyrë efektive, e cila mund të çojë në një ndjenjë të vetë-perceptuar dështimi. Komponenti i joefikasitetit përfaqëson dimensionin e vetëvlerësimit të bjerres profesionale, ku individët vlerësojnë aftësitë dhe produktivitetin e tyre. (Maslach et al, 2016)

Studime të shumta të kryera gjatë viteve kanë demonstruar vazhdimisht lidhjen midis bjerres në punë dhe shqetësimeve fizike dhe psikologjike (Hakonnen et al, 2006) (Lee et al, 2011). Bazuar në një meta-analizë të kohëve të fundit, ekziston një korrelacion i fortë midis bjerres profesionale dhe shqetësimeve të ndryshme shëndetësore fiziologjike dhe psikologjike. Këto përfshijnë nivele të larta të kolesterolit, obezitetit, çrregullimeve kardiovaskulare, dhimbjeve muskuloskeletore, komplikimeve gastrointestinale, dhimbjeve të kokës, pagjumësisë, si dhe niveleve të rritura të ankthit dhe depresionit (Salvagioni et al, 2017), (Aghilineja et al, 2014), (Brand et al, 2010).

Hulumtimet kanë treguar se bjerria profesionale është e lidhur fort me zakone apo sjellje jo të shëndetshme, duke përfshirë konsumin e lartë të alkoolit, abuzimin me drogën dhe përfshirjen në sjellje të rrezikshme. (Ahola et al 2010). Ndikimi i pandemisë COVID-19 i ka përkeqësuar këto sjellje, duke çuar në një përforsim të mëtejshëm të rritjes së konsumit të alkoolit, abuzimit me drogën dhe përfshirjes në sjellje të rrezikshme tek individët që përjetojnë bjerrije profesionale. (Serby et al, 2022) Bjerria profesionale është identifikuar si një parashikues domethënës në shpeshtësinë e marrjes së lejeve mjekësore tek individët. (Toppinen-Tanner et al 2005). Individët që po përjetojnë bjerrije profesionale kanë më shumë gjasa të vuajnë nga pagjumësia, të kenë dhimbje në qafë, të mos konsumojnë drekën, të ndjejnë lodhje dhe të kenë vështirësi të flenë gjumë (Zippia, 2023)

Bjerria profesionale duket se është e lidhur ngushtë me funksionin e trurit dhe mirëqenien mendore. Individët që përjetojnë bjerrije profesionale ndeshen me sfida me kujtesën dhe përqendrimin në jetën e tyre të përditshme. Studimet kanë identifikuar tre funksione primare njohëse që priren të përkeqësohen në lidhje me bjerrien profesionale: funksioni ekzekutiv, vëmendja dhe kujtesa. (Pavlos et al, 2014). Hulumtimet sugjerojnë se bjerria profesionale jo vetëm që lidhet me sfidat e lidhura me vendin e punës, por gjithashtu duket të jetë e lidhur me depresionin dhe ankthin. (Koutsimani et al, 2019) Është zbuluar se bjerria profesionale mund të ndikojë në



metilimin e ADN-së, i cili është i përfshirë në rregullimin e formave shprehëse të gjeneve në raport me stresin. Ndikimi i bjerrjes në metilimin e ADN-së thekson rolin e tij të mundshëm në zhvillimin ose përkeqësimin e kushteve të shëndetit mendor si depresioni dhe ankthi. (Bakusic et al, 2016)

Studimet i kanë kushtuar rëndësi ekzaminimit të ndikimit të gjinisë si në bjerrjen profesionale, angazhimin në punë dhe faktorët demografikë. Studime të ndryshme kanë gjetur lidhjen e gjinisë dhe manifestimin e bjerrjes profesionale për sa i përket zakoneve të sjelljes. (Demerouti et al, 2001) (Kalimo et al, 2003). Megjithëse studime të shumta ofrojnë mbështetje për këto gjetje (Schaufeli et al, 2006) (Artz & Kaya, 2022), studime të tjera tregojnë një mungesë korrelacioni midis variablave gjinorë (Brewer & Shapard, 2004), duke e bërë këtë çështje jokonkluzive dhe në nevojë për eksplorim të mëtejshëm.

Ekzistojnë studime që sugjerojnë se gjenerata e fëmijëve të lindur prej 1990 janë më të ndjeshëm ndaj zhvillimit të bjerrjes profesionale në krahasim me gjeneratat e tjera. Statistikat tregojnë se afërsisht 84% e tyre raportojnë se përjetojnë simptoma të bjerrjes profesionale. Për më tepër, gati gjysma e kesaj gjenerate kanë marrë vendimin për të lënë punën e tyre si rezultat i drejtpërdrejtë i përjetimit të bjerrjes profesionale. Këto shifra nxjerrin në pah ndikimin e rëndësishëm që mund të ketë bjerrja profesionale në mirëqenien dhe zgjedhjet e karrierës së individëve (Deloitte, 2018). Në vitin 2021, Gjenerata X dëshmoi një rritje të konsiderueshme të bjerrjes profesionale, me përqindjen që u rrit nga 14% në 40% (Indeed, 2021).

Hulumtimi i fundit i kryer nga Zippia ka zbuluar gjetje interesante për profesionet më të prirura ndaj bjerrjes. Profesionistët e kujdesit shëndetësor shfaqin nivelet më të larta të bjerrjes, të ndjekur nga ata në industrinë e transportit, mallrat e konsumit dhe sektorët e prodhimit. (Zippia, 2023). Një studim kërkimor i kryer nga një grup studiuesish turq, eksploroj bjerrjen profesionale brenda departamenteve të kujdesit shëndetësor dhe zbuloi se të ardhurat mund të shërbejnë si një faktor lehtësues në reduktimin e simptomave të bjerrjes. Studimi nxjerr në pah ndikimin e mundshëm të niveleve të të ardhurave në zbutjen e bjerrjes profesionale midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor. (Tarcan, 2017). Ndërsa bjerrja profesionale perceptohet si një çështje individuale, hulumtimi ka treguar se bjerrja profesionale e lidhur me punën ndikohet kryesisht nga kushtet negative të punës. Këto kushte përfshijnë faktorë të tillë si perspektivat e pabarabarta të promovimit, autonomia ose fleksibiliteti i kufizuar, një ndjenjë e përjashtimit ose mospërkatësisë dhe një mospërputhje vlerash, siç është mbështetja e pamjaftueshme për punonjësit që janë dhe prindër. (Leiter & Maslach, 1999)

Teoricienët modernë sugjerojnë se bjerrja profesionale ndikohet si nga karakteristikat personale ashtu edhe nga faktorët e lidhur me punën. (Bianchi, 2018). Kur bëhet fjalë për faktorët që lidhen me punën, shumica e studimeve janë në të njëjtën linjë. Këta faktorë të lidhur me punën mund të përmbledhen si: (1) mbingarkesa; (2) padrejtësia, (3) mungesa e autonomisë, (4) vlerat; (5) promovimi; (6) ndërveprimi në ekip/marrëdhënia e dobët në ekip. (Lubbadeh, 2020). Sipas hulumtimeve të fundit, kohëzgjatja e punësimit dhe pozicioni i mbajtur brenda një pune janë faktorë të

rëndësishëm në parashikimin e zhvillimit të bjerrjes profesionale. (Ramos et al, 2016) Ndërsa bjerrja profesionale është studiuar gjerësisht në mbarë botën, ajo ka marrë më pak vëmendje në Shqipëri. Megjithatë, kohët e fundit, ka pasur përpjekje në rritje për të studiuar bjerrjen profesionale në profesione të ndryshme. Gjetjet tregojnë se mjekët dhe mësuesit në Shqipëri janë të ndjeshëm ndaj simptomave të bjerrjes profesionale, veçanërisht në situata që përfshijnë paqartësi të roleve, përgjegjësi të lartë dhe ngarkesë të tepruar të punës. (Alikaj et al, 2021) (Kashahu et al, 2021). Sipas një studimi të kryer në vitin 2020, nivelet e bjerrjes profesionale në Shqipëri qëndrojnë nën kufijtë të vërejtur në vendet e Bashkimit Evropian, me një prevalencë prej 13% (popullsia e përgjithshme) krahasuar me vendet e tjera që arrijnë deri në 20.6%. (De Hert, 2020). Megjithatë, në terma botërorë, sipas Gallup, 76% e punonjësve përjetojnë bjerrje profesionale në vendin e punës të paktën njëherë. (Gallup, 2022). Ashtu si në vitin 2020, punëtorët amerikanë jashtë Amerikës raportuan nivele të larta të bjerrjes profesionale në vitin 2021. Anketa e Punës dhe Mirëqenies së APA-së zhvilloi një studim për të vlerësuar nivelin e bjerrjes profesionale dhe raportoi se 79% e punonjësve kishin përjetuar stres të lidhur me punën në muajin përpara anketës. Gati 3 në 5 punonjës raportuan ndikime negative të stresit të lidhur me punën, duke përfshirë mungesën e interesit, motivimit ose energjisë (26%) dhe mungesën e angazhimit në punë (19%). Ndërkohë, 36% raportuan lodhje mendore, 32% raportuan lodhje emocionale dhe 44% raportuan lodhje fizike—një rritje prej 38% që nga viti 2019. (American Psychological Association, 2021)

## **II. Metodologjia dhe materialet:**

### *2.1 Dizajni i studimit dhe pjesëmarrësit*

Një dizajn ndërseksional u përdor për të vlerësuar praninë e bjerrjes profesionale, faktorët e lidhur me të, skemat e hershme të keqpërshtatura dhe simptomat psikologjike. Bateria e testeve u administrua online dhe u plotësua nga një kampion prej 200 profesionistësh. Përpara aplikimit të pyetësorëve, pjesëmarrësve iu dha informacion i qartë në lidhje me qëllimin e studimit dhe iu kërkua të plotësonin një formular pëlqimi. Kriteret e përfshirjes për pjesëmarrje përfshinin moshën 18 vjeç e lart, zotërimi i rrjedhshëm i gjuhës shqipe dhe/ose angleze dhe aktualisht i punësuar.

### *2.2 Mbledhja e të dhënave*

‘The Burnout Assessment Tool’ (BAT) është një pyetësor me vetë-raportim me 23 pyetje që vlerëson rraskapitjen, distancën mendore, lodhjen konjitive dhe ezaurimin emocional. Të anketuarit vlerësojnë shpeshtësinë e përvojave të tyre duke përdorur një shkallë Likert nga 1 deri në 5. Rezultati i BAT është i qëndrueshëm midis gjinive, grupmoshave dhe vendeve. (Shaufeli et al, 2020)

The Perceived Stress Scale (PSS) është një pyetësor me vetë-raportim që përdoret për të matur stresin psikologjik. Ai vlerëson sesi individët i perceptojnë dhe vlerësojnë situatat stresuese në jetën e tyre. PSS-10 përcakton nivelet e paparashikueshmërisë së të anketuarve, mungesës së kontrollit dhe ndjenjës së mbingarkesës. Ai përfshin pyetje të drejtpërdrejta në lidhje me nivelet aktuale të stresit dhe është projektuar për individ që kanë të paktën një arsim të mesëm. Shkalla fokusohet në stresin e përgjithshëm dhe jo në ngjarje ose përvoja specifike. (Cohen et al, 1983).

Symptom Checklist- 90 (SCL-90-R) është një shkallë e përdorur gjerësisht në praktikën klinike. Shërben si një mjet diagnostikues, dhe monitorues për vlerësimin e shqetësimit psikologjik dhe aspekteve të ndryshme të shqetësimit fizik. Rezultati total i SCL-90 tregon për shqetësim të përgjithshëm psikologjik, ndërsa rezultatet e nënshkallës tregojnë simptoma primare specifike si ankthi, depresioni dhe somatizimi (Paap et al, 2011)

YSQ-SF (Young Schema Questionnaire-Short Form) u zhvillua nga Jeffrey Young si pjesë e terapisë së fokusuar në skema. Instrumenti përfshin 18 nënshkallë të grupuara në disa fusha: refuzimi psikologjik, pengesat në zhvillimin e autonomisë, dëmtimi i kufijëve, vigjilenca e tepërt dhe frenimi psikologjik. Nënshkallët mbulojnë tema të ndryshme si braktisja, mosbesimi, privimi emocional, turpi, izolimi social, varësia, vulnerabiliteti, dështimi, vetëkontrolli, nënshtrimi, sakrificat, kërkimi i miratimit, negativiteti, frenimi emocional, standardet e larta, dhe ndëshkimi. (Young & Brown, 2005)

### III. Rezultatet

#### 3.1 Karakteristikat e grupit

Një total prej 200 profesionistësh, duke përfshirë 105 gra (52.5%) dhe 95 (47.5%) burra morën pjesë në studim. Tabela 1 tregon të dhënat sociodemografike dhe psikometrike.

Variablat e matura	Grupi							
Faktorët demografik								
Moshë	18-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	
	21.3%	48.8%	22.5%	3.8%	1.3%	1.3%	1.3%	
Gjinia	Burrë				Gratë			
	47.5%				52.5%			
Statusi civil	Beqar/e		I/e martuar			Bashkëjetësë		
	68.8%		15%			11%		
Edukimi	Shkollë e mesme		Universitet		Master		Doktoraturë	
	1.3%		36.3%		61.3%		1.3%	
Orët e punës në javë	Mesatarja		Devijimi Standard					
	40.3		10					
Vitet e punës	Mesatarja		Devijimi Standard					
	6.1		4.9					
Të dhënat psikometrike	Pikët mesatare							
<i>The burnout assessment tool</i>								
	Burra				Gratë			
Rraskapitja nga puna	1.4				1.9			
Distanca mendore	0.7				0.9			
Dëmtimi mental	1.2				1.3			

Dëmtimi emocional	0.3	0.9
Bjerrja profesionale	1.0	1.3
<i>The Perceived Stress Scale</i>		
Pashpresëmëria e perceptuar	8.2	<b>11.1</b>
Stresi i perceptuar	<b>15.4</b>	<b>19.2</b>
Mungesa e vetë-efikasitetit	7.1	8.0
<i>The Symptom Checklist-90-Revised</i>		
Psikotizmi	0.5	0.8
Idetë paranoide	0.8	1.1
Ankthi fobik	0.3	0.5
Agresiviteti dhe armiqësia	0.4	0.6
Ankthi	0.4	0.8
Depresioni	0.8	1.3
Ndjeshmëria ndërpersonale	0.7	1.1
Simptomat obsesiv-kompulsive	1.0	1.3
Somatizimi	0.5	<b>0.9</b>
<i>Young Schema Questionnaire-Short Form</i>		
Deprivimi emocional	2.26	2.17
Braktisja	1.82	2.28
Abuzimi	2.19	2.20
Izolimi social	2.02	2.00
Turpi	1.55	1.5
Dështimi	1.53	1.8
Paafhtësia	1.43	1.52
Vulnerabiliteti	1.62	1.89
Mungesa e kufinjëve	1.64	1.92
Nënshtrimi	1.65	1.83
Vetë-sakrifica	<b>3.12</b>	<b>3.09</b>
Pengesa emocionale	2.52	2.37
Standarte të larta	<b>3.46</b>	<b>3.40</b>
Grandioziteti	2.23	2.46
Mungesa e vetëkontrollit	2.26	2.29

Tabela 1: Të dhëna demografike

### 3.2 Diferenca mes grupeve

Ndërsa në studim nuk u gjetën dallime domethënëse gjinore në nivelin e përgjithshëm të bjerrjes, vlen të përmendet se gratë shënuan më shumë pikë se burrat në dimensionin e rraskapitjes në punë ku  $F=10.625$ ,  $p=.002$  ( $\geq 1.75$ .); në dëmtimin emocional  $F=14.581$ ,  $p=.000$ ; në stresin e perceptuar  $F=8.939$ ,  $p=.004$ ; në somatizimin  $F=9.209$ ,  $p=.003$ ; dhe në pafuqinë e perceptuar  $F=8.262$ ,  $p=.005$ .

Të dhënat përshkruese tregojnë se të dyja gjinitë morën rezultate të larta në pyetësorin e skemave, ku specifikisht në dy skema: Standardeve jo realiste dhe Vetësakrificimi (shih: Tabelën 1). Nuk u evidentua asnjë ndryshim i rëndësishëm statistikisht midis gjinive në lidhje me këto skema dhe simptomat psikologjike.

### 3.3 Lidhja mes variablave

Gjetjet tregojnë se nuk ka një lidhje të rëndësishme midis bjerrjes profesionale dhe numrit të orëve të punës në javë për pjesëmarrësit, siç tregohet nga një koeficient korrelacioni prej  $r = 0,022$ ,  $p = ,850$ . Në mënyrë të ngjashme, nuk ka asnjë lidhje midis viteve të përvojës dhe bjerrjes profesionale, me një koeficient korrelacioni prej  $r = -.137$ ,  $p = .091$ .

	1	2	3
Rraskapitja nga puna	1		
Stresi i perceptuar	.742**	1	
Bjerrja profesionale	.899**	.809**	1

Shënim:  $p < .005$ , CI = 95% intervali i konfidencës

**Tabela 2: Korrelacionet**

Analiza e të dhënave tregon një lidhje të fortë midis rraskapitjes nga puna dhe bjerrjes profesionale, duke sugjeruar se nivelet më të larta të rraskapitjes shoqërohen me rritje të bjerrjes. Për më tepër, ekziston një lidhje e fortë midis stresit të perceptuar, bjerrjes profesionale dhe rraskapitjes nga puna, duke treguar se nivelet më të larta të perceptimit të stresit janë të lidhura me nivele të larta të bjerrjes profesionale dhe rraskapitjes në punë. Analiza nuk zbuloi asnjë korrelacion të rëndësishëm midis skemave të hershme të keqpërshtatura dhe stresit të perceptuar, bjerrjes profesionale dhe simptomave psikologjike. Prania e skemave të hershme të keqpërshtatura nuk tregoi një lidhje të fortë me këto variabla në studimin aktual.

### 3.4 Parashikuesit e bjerrjes profesionale

Tabela e korrelacionit tregon se bjerrja profesionale nuk parashikohet nga vitet e përvojës, orët e punës ose niveli i arsimimit. Megjithatë, analiza e regresionit zbulon se rraskapitja e lidhur me punën është një parashikues domethënës i bjerrjes, siç dëshmohet nga një  $R^2 = .806$ , një  $F = 330.15$  dhe një  $p = .000$ . Këto rezultate tregojnë se lodhja e lidhur me punën luan një rol vendimtar në parashikimin e zhvillimit të bjerrjes me kalimin e kohës.

## IV. Diskutimi

Studimi aktual synoi të hetojë lidhjen midis bjerrjes profesionale, dallimeve gjinore, ndikimit psikologjik dhe skemave të hershme që potencialisht kontribuojnë në zhvillimin e bjerrjes profesionale. Në këtë studim u vlerësuan dimensione të shumta për të përfituar një kuptim gjithëpërfshirës të kësaj marrëdhënieje. Gjetjet zbuluan se gratë, në krahasim me burrat, raportuan rezultate më të larta në aspekte të ndryshme, duke përfshirë rraskapitjen e lidhur me punën, dëmtimin emocional, stresin e perceptuar, pafuqinë e perceptuar dhe somatizimin.

Në përputhje me hulumtimet e mëparshme të kryera nga Schaufeli et al. (2006) dhe Artz & Kaya (2022), rezultatet e këtij studimi mbështesin ekzistencën e dallimeve gjinore. Këto dallime në mënyrë të arsyeshme mund t'i atribuohen faktorëve të tjerë përveç skemave të hershme, pasi nuk u gjet ndikim i rëndësishëm i skemave të hershme me bjerren profesionale. Veçanërisht, pjesëmarrësit në studim raportuan një nivel të konsiderueshëm të stresit të perceptuar që mund të çojë në zhvillimin e bjerres profesionale më vonë në kohë.

Gjetjet tregojnë për një ndryshim gjinor në nivelin e somatizimit. Gratë raportuan rezultate më të larta në simptomat somatike, gjë që mund të interpretohet si përgjigje ndaj rraskapitjes së lidhur me punën. Është e rëndësishme të theksohet se ky dallim gjinor mund t'i atribuohet edhe faktorëve të tjerë që përfshijnë një kombinim të faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe socio-kulturorë. (Leshi, 1994)

Ndryshe nga pritshmëritë, në këtë studim nuk u gjet një lidhje e rëndësishme midis orëve të zgjatura të punës dhe zhvillimit të simptomave të bjerres profesionale. Hulumtimet e mëparshme kanë lidhur vazhdimisht orët e gjata të punës me bjerren profesionale. Ndikimi i skemave të hershme të keqpërshtatura, veçanërisht skema e vetësakrificimit u konsiderua si një shpjegim i mundshëm, por nuk u zbulua asnjë lidhje e rëndësishme statistikore midis saj dhe bjerres emocionale në këtë studim. Pjesëmarrësit në studim kishin një mesatare prej 40 orë pune në javë, e cila konsiderohet e moderuar dhe mund të shpjegojë mungesën e një lidhjeje të fortë. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të eksploruar dinamikën komplekse midis orëve të punës, skemave të hershme dhe simptomave të bjerres profesionale në kontekste të ndryshme pune.

## V. Konkluzion

Në këtë studim, u shqyrtua marrëdhënia midis bjerres profesionale, dallimeve gjinore, ndikimit psikologjik dhe skemave të hershme. Gratë shënuan rezultate më të larta se burrat në dimensionin e rraskapitjes, dëmtimit emocional, stresit të perceptuar, pafuqisë së perceptuar dhe somatizimeve, gjetje që janë në përputhje me hulumtimet e mëparshme. Megjithatë, skemat e hershme nuk kontribuan ndjeshëm në bjerren profesionale. Pjesëmarrësit raportuan nivele të konsiderueshme të stresit të perceptuar, i cili mund të jetë një pararendës i bjerres profesionale. Gratë shfaqën simptoma somatike më të larta, ndoshta si një përgjigje përbaluese ndaj rraskapitjes. Nuk u gjet një lidhje e rëndësishme midis orëve të zgjatura të punës dhe simptomave të bjerres, në kundërshtim me studimet e mëparshme. Nevojiten kërkime të mëtejshme për të eksploruar ndërveprimin kompleks midis faktorëve që kontribuojnë në bjerren profesionale.

## VI. References

- World Health Organization, (2019) [www.who.int](http://www.who.int) Burn-out an "occupational phenomenon": International Classification of Diseases (who.int)
- Maslach, Christina & Leiter, Michael. (2007). Burnout. 10.1016/B978-0-12-800951-2.00044-3.

- Maslach C, Schaufeli WB, Leiter MP. Job burnout. *Annu Rev Psychol.* 2001;52(1):397–422. doi: 10.1146/annurev.psych.52.1.397
- Maslach C, Leiter MP. Understanding the burnout experience: recent research and its implications for psychiatry. *World Psychiatry.* 2016;15(2):103–11. doi: 10.1002/wps.20311
- Teija Honkonen; Kirsi Ahola; Marja Pertovaara; Erkki Isometsä; Raija Kalimo; Erkki Nykyri; Arpo Aromaa; Jouko Lönnqvist (2006). The association between burnout and physical illness in the general population—results from the Finnish Health 2000 Study. , 61(1), 0–66. doi:10.1016/j.jpsychores.2005.
- Lee J, Lim N, Yang E, Lee SM. Antecedents and consequences of three dimensions of burnout in psychotherapists: A meta-analysis. *Prof Psychol Res Pr.* 2011.
- Salvagioni DAJ, Melanda FN, Mesas AE, González AD, Gabani FL, Andrade SM. Physical, psychological and occupational consequences of job burnout: A systematic review of prospective studies. *PLoS One.* 2017 Oct 4;12(10):e0185781. doi: 10.1371/journal.pone.0185781. PMID: 28977041; PMCID: PMC5627926.
- Aghilinejad M, Zargham Sadeghi AA, Sarebanha S, Bahrami-Ahmadi A. Role of occupational stress and burnout in prevalence of musculoskeletal disorders among embassy personnel of foreign countries in Iran. *Iran Red Crescent Med J.* 2014;16(5): e9066 doi: 10.5812/ircmj.9066
- Brand S, Beck J, Hatzinger M, Harbaugh A, Ruch W, Holsboer-Trachsler E. Associations between satisfaction with life, burnout-related emotional and physical exhaustion, and sleep complaints. *World J Biol Psychiatry.* 2010;11(5):744–54. doi: 10.3109/15622971003624205
- Ahola K, Honkonen T, Pirkola S, Isometsä E, Kalimo R, Nykyri E, Aromaa A, Lönnqvist J. Alcohol dependence in relation to burnout among the Finnish working population. *Addiction.* 2006 Oct;101(10):1438–43. doi: 10.1111/j.1360-0443.2006.01539.x. PMID: 16968345.
- Searby A, Burr D, Redley B. The impact of COVID-19 on nurse alcohol consumption: A qualitative exploration. *J Clin Nurs.* 2022 Jul 24;10.1111/jocn.16467. doi: 10.1111/jocn.16467. Epub ahead of print. PMID: 35871283; PMCID: PMC9350011.
- Toppinen-Tanner S, Ojajarvi A, Väänänen A, Kalimo R, Jäppinen P. Burnout as a predictor of medically certified sick-leave absences and their diagnosed causes. *Behav Med.* 2005 Spring;31(1):18–27. doi: 10.3200/BMED.31.1.18–32. PMID: 16078523.
- Zippia. "40+ Worrisome Workplace Stress Statistics [2023]: Facts, Causes, And Trends" Zippia.com. Feb. 11, 2023, <https://www.zippia.com/advice/workplace-stress-statistics/>
- Pavlos Deligkaris, Efharis Panagopoulou, Anthony J. Montgomery & Elvira Masoura (2014) Job burnout and cognitive functioning: A systematic review, *Work & Stress*, 28:2, 107–123, DOI: 10.1080/02678373.2014.909545
- Koutsimani P, Montgomery A, Georganta K. The Relationship Between Burnout, Depression, and Anxiety: A Systematic Review and Meta-Analysis. *Front Psychol.* 2019 Mar 13;10:284. doi: 10.3389/fpsyg.2019.00284. PMID: 30918490; PMCID: PMC6424886.
- Bakusic J, Schaufeli W, Claes S, Godderis L. Stress, burnout and depression: A systematic review on DNA methylation mechanisms. *J Psychosom Res.* 2017 Jan;92:34–44. doi: 10.1016/j.jpsychores.2016.11.005. Epub 2016 Nov 23. PMID: 27998510.
- Demerouti E, Bakker AB, Nachreiner F, Schaufeli WB. The job demands—resources model of burnout. *J Appl Psychol* 2001;86:
- Kalimo R, Pahkin K, Mutanen P, Toppinen-Tanner S. Staying well or burning out at work: work characteristics and personal resources as long-term predictors. *Work Stress* 2003.
- Schaufeli WB, Bakker AB, Salanova M. The measurement of work engagement with a short questionnaire: a cross national study. *Educ Psychol Meas* 2006.

- Artz B, Kaya I, Kaya O. Gender role perspectives and job burnout. *Rev Econ Househ.* 2022;20(2):447-470. doi: 10.1007/s11150-021-09579-2. Epub 2021 Aug 19. PMID: 34429716; PMCID: PMC8375289
- Brewer EW, Shapard L. Employee Burnout: a meta-analysis of the relationship between age or years of experience. *Hum Resource Dev Rev.* 2004
- Deloitte 2018 Survey Report [www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/us/Documents/about-deloitte/us-about-deloitte-burnout-survey-infographic.pdf](http://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/us/Documents/about-deloitte/us-about-deloitte-burnout-survey-infographic.pdf)
- Indeed 2021 Employee Burnout Report: COVID-19's Impact and 3 Strategies to Curb It ([indeed.com](http://indeed.com))
- Tarcan M, Hikmet N, Schooley B, Top M, Tarcan GY. An analysis of the relationship between burnout, socio-demographic and workplace factors and job satisfaction among emergency department health professionals. *Appl Nurs Res.* 2017 Apr;34:40-47. doi: 10.1016/j.apnr.2017.02.011. Epub 2017 Feb 3. PMID: 28342622
- Leiter, Michael & Maslach, Christina. (1999). Six areas of worklife: A model of the organizational context of burnout. *Journal of health and human services administration.* 21. 472-89.
- Ramos R, Jenny G, Bauer G. Age-related effects of job characteristics on burnout and work engagement. *Occup Med (Lond).* 2016 Apr;66(3):230-7. doi: 10.1093/occmed/kqv172. Epub 2016 Jan 24. PMID: 26810576.
- Bianchi, R. (2018), Burnout is more strongly linked to neuroticism than to work-contextualized factors. *Psychiatry Research*, 270, 901-905
- Lubbadeh, T. (2020). Job Burnout: A General Literature Review. *International Review of Management and Marketing*, 10(3), 7–15. Retrieved from <https://econjournals.com/index.php/irmm/article/view/9398>
- Alikaj V, Skendi V, Metaj E, Dashi E. Burnout in medical residents - a prospective study in Albania. *Eur Psychiatry.* 2021 Aug 13;64(Suppl 1):S730. doi: 10.1192/j.eurpsy.2021.1934. PMCID: PMC9480449
- Kashahu, Ledia & Petani, Rozana & Ntalla, Marina. (2021). Relationship Between Teacher's Burnout, Occupational Stress, Coping, Gender and Age. *Journal of Educational and Social Research.* 11. 275. 10.36941/jesr-2021-0094.
- De Hert S. Burnout in Healthcare Workers: Prevalence, Impact and Preventative Strategies. *Local Reg Anesth.* 2020 Oct 28;13:171-183. doi: 10.2147/LRA.S240564. PMID: 33149664; PMCID: PMC7604257.
- Gallup 2022 Uncomfortable (but Necessary) Conversations About Burnout ([www.gallup.com](http://www.gallup.com))
- American Psychological Association (2021) Burnout and stress are everywhere ([www.apa.org](http://www.apa.org))
- Shaufeli WB, Desart S, De Witte H. Burnout Assessment Tool (BAT)-Development, Validity, and Reliability. *Int J Environ Res Public Health.* 2020 Dec 18;17(24):9495. doi: 10.3390/ijerph17249495. PMID: 33352940; PMCID: PMC7766078.
- Cohen, S., Kamarck, T., & Mermelstein, R. (1983). A global measure of perceived stress. *Journal of Health and Social Behavior*, 24, 385–396.
- Paap MC, Meijer RR, Van Bebber J, Pedersen G, Karterud S, Hellem FM, Haraldsen IR. A study of the dimensionality and measurement precision of the SCL-90-R using item response theory. *Int J Methods Psychiatr Res.* 2011 Sep;20(3):e39-55. doi: 10.1002/mpr.347. Epub 2011 Aug 3. PMID: 21812065; PMCID: PMC6878380.
- Wool, C. A., & Barsky, A. J. (1994). Do women somatize more than men? Gender differences in somatization. *Psychosomatics: Journal of Consultation and Liaison Psychiatry*, 35(5), 445–452. [https://doi.org/10.1016/S0033-3182\(94\)71738-2](https://doi.org/10.1016/S0033-3182(94)71738-2)



# A NDIKOJNË RAJONET NË TË ARDHURAT E SIGURUARA NGA TATIMI MBI VLERËN E SHUAR? RASTI I SHQIPËRISË, PARA EFEKTIT TË COVID-19

Dr. Matilda VELIU<sup>1</sup>

## Abstact

Valued Added Tax, VAT, is one of the indirect taxes that have the most significant specific value on state revenues. The fluctuation of VAT and its trend influence performance's state objectives. The aim of the article is to examine the trend of VAT in the country before Covid-19 and how the regions influence the revenues generated by this tax. For this purpose, the usage of secondary data gathered by official institutions is analyzed to see which of the regions contributes more to the VAT's revenues. Descriptive and analytic analysis results show that regions like Elbasan, Kuksi, and Lezha are those with the most specific value (weight) in VAT revenues. Focusing on the relationship between VAT's revenues and overall total regional revenues, it is released that the Pearson correlation is positive and 0.578. The correlation between VAT revenues and the variable Total Revenues is strong when the marginal rate of VAT revenues is approximately 10% and the marginal rate of Total Revenues is approximately 8%. Regional criteria, estimated statistically by regional population logarithm, and by average regional consumption seem to not have an influence on the VAT's revenues. It seems interesting the fact that the Fieri region comparing 2018-2019 has a decrease in total revenue, but VAT revenue increased. Small regions generate more revenues than big regions for the time period before the Covid-19 pandemic.

**Key Words:** Economic Growth, Tax Revenues, VAT.

**Jel Codes:** O40, H27, H25.

## I. HYRJE

Qëllimi i punimit është të shikojë ecurinë e të ardhurave të gjeneruara nga TVSH në ekonominë e vendit, por edhe për të parë se si këto të ardhura variojnë për rajone të ndryshme të Shqipërisë. Duke u fokusuar në trendin e këtij variabli, do të mund të shikohet performanca e politikës taksore në përgjithësi dhe të vihen re rajonet me potencial më të madh në rritjen ekonomike të vendit. Kjo sepse, TVSH konsiderohet nga shumë studiues, si një prej taksave me influencë më të lartë në GDP-n reale, rrjedhimisht në rritjen ekonomike. Të dhënat e siguruara nga burime sekondare do të përpunohen për të shqyrtuar korrelacionet e mundshme ndërmjet variablave.

Metodat e përdorura për të analizuar lidhjen do të insistojnë fillimisht në kërkimin eksplorues dhe përshkruar, me qëllim krijimin e një profili gjithëpërfshirës të faktorëve që ndikojnë në relacionin e variablave, por edhe në kërkimin shkaksor për të parë marrëdhëniet ndërmjet variablave.

Shtete të ndryshme aplikojnë norma të ndryshme TVSH-je. Në Shqipëri norma është 20%, e konsideruar e lartë krahasuar edhe me vendet fqinje, pavarësisht se ecuria ekonomike nuk është e njëjtë. Në 1999 Komisioni Europian urdhëroi uljen e normës së TVSH-s në vendet e Bashkimit Europian dhe kjo për të nxitur kërkesën në të mira specifike, si edhe për të stimuluar punësimin. Kategoritë që prekeshin nga kjo urdhëresë ishin kryesisht të fokusuar në mallra dhe shërbime të ofruara nga individë ose biznese të vogla si për shembull, kujdes dhe mirëmbajtje personale edhe

---

<sup>1</sup> Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, matildaveliu@feut.edu.al

ambjentesh. Kjo jo pa qëllim, pasi kategoritë e përmendura, rezultojnë të jenë kategori që influencojnë shumë në rritjen e ekonomisë informale, rrjedhimisht udhëzimi përveçse tenton të rrisë të ardhurat nga TVSH në vendet e Bashkimit Europian, gjithashtu përpiqet të reduktojë edhe ekonominë informale duke nxitur rritjen ekonomike. Kohët e fundit, aplikimi i gjerë i tregëtisë elektronike përbën një sfidë qeveritare për gjenerimin e të ardhurave të duhura edhe nga TVSH, përderisa shitjet bëhen on-line. Sipas Joumard (2002), një diskriminim i madh u vërejt në shitësit on-line të BE-së duke stimuluar iniciativa procedurale internacionale në lidhje me taksimin e tregëtisë elektronike. Në vitin 2002, Komisioni Europian udhëzoi vendet jo në BE për t'u rregjistruar në sistemin tregëtar elektronik në një ose më shumë vende të saj dhe të aplikonin normën e TVSH-s të vendit përkatës të BE-s me të cilin realizonin shkëmbimin tregëtar. Një problem u evidentua për vende që kishin norma të ndryshme taksimi, ndaj Suedia e unifikoi normën e TVSH-s për të dy vendet e përfshira në transaksionet tregëtare. Situata pandemike ndikoi shumë në ecurinë e TVSH-s në vende të ndryshme dhe lidhjet e të ardhurave nga TVSH me konsumin e ndërmjetëm sipas Popescu *et al.* (2019) treguan shtimin e prezencës së informalitetit në ekonomi. Në Shqipëri, ku norma e TVSH si në import ashtu dhe në eksport, për disa produkte jetike si drithrat, ngelet e njëjtë në nivelin 20%, nuk stimulon prodhimin vendas dhe sigurisht dëmton agjentët në treg, por gjithashtu nuk ndikon në rritjen ekonomike. Rimbursimi i TVSH, sipas paketës së re fiskale pas 2019, nga 20% bëhet 6% (Ministri e Financave, 2020). Rënia e eksporteve, pagesa e TVSH-s në vend dhe moskompensimi për blerjen e lëndës së parë, apo vonesat në të, keqësojnë situatën ekonomike. Për më tepër, nëse marrin në konsideratë edhe efektet e multiplikatorit fiskal dhe akseleratorit në ekonomi. Rrjedhimisht, aplikimi i normave korrekte, bazuar në situatën aktuale ekonomike të vendit, është domosdoshmëri permanente për politika efikase dhe eficiente.

## II. Rishikimi i Literaturës

Gjithnjë dhe më shumë TVSH po shikohet si një mjet fiskal nga ana e qeverive për të siguruar të ardhura më të larta në buxhetin e shtetit. Studime të ndryshme në lidhje me këtë çështje përforcojnë faktin e mësipërm, duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë si madhësia e vendit, densiteti i flukseve tregëtare, permutacionet e ndryshme të vendeve në flukset tregëtare (Bucovetsky, 1991; Wilson, 1991; Kanburi and Keen, 1993). Sipas studiuesve të mësipërm, vendet relativisht të vogla në madhësi përballen me vështirësi më të mëdha në uljen e taksave sesa vendet me madhësi relativisht të mëdha, pra shfaqnin konkurrencë taksore asimetrike, ndërkohë që vendet me të njëjtën madhësi shfaqnin konkurrencë taksore simetrike.

Krugman, P *et al* (1992) sygjeronin TVSH-n si mjetin më të mirë për të përmirësuar eficiencën e mbledhjes së taksave dhe rritjes ekonomike të vendit. Studimi i tyre tregoi një lidhje pozitive ndërmjet variablave. Një rezultat i tillë shfaqet edhe në studime të tjera nga Hassan (2015), and Inimino et al. (2018) apo Kalaš & Milenkovič (2017) të cilët treguan ekzistencën e një lidhje të fortë të ndikimit të TVSH-s mbi rritjen ekonomike. Zeraibi dhe Subhadeep (2019) duke përdorur teste ekonometrike të

ndryshme evidentuan marrëdhënien e fortë pozitive të Produktit të Brendshëm Bruto dhe TVSH-së, si në afatin e shkurtër ashtu edhe në afatin e gjatë.

Pavarësisht se pranohet ndikimi i TVSH-s në ekonomi, shumë studiues janë fokusuar në nën-ndarje të tjera të kategorisë Taksa në përgjithësi dhe të ndikimit tyre në ekonomi. Duke i klasifikuar taksat në dy kategori madhore: a) Taksa Direkte dhe b) Taksa Indirekte, ku TVSH bën pjesë në kategorinë e Taksave Indirekte, Ahmad et al. (2013) tregoi se taksat direkte duhet të rriten më tepër sesa taksat indirekte (edhe TVSH) për të patur një prosperitet ekonomik.

Një ndarje tjetër e të ardhurave të gjeneruara në arkën e shtetit nga Barro (1990) dhe Tanzi (1995), sygjerojnë kategorizimin e të ardhurave shtetërore në:

- ✓ Të Ardhura Fiskale Deformuese, ku përfshihen taksat nga të ardhurat personale, taksimi i korporatave dhe sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, si edhe taksa nga prona;
- ✓ Të Ardhura Fiskale Jo-Deformuese, e cila përfshin TVSH-n, Akcizën dhe Detyrimet Doganore.

Një ndarje e tillë mundëson trajtimin e problemit më në thellësi, duke treguar qartë orientimin e duhur të politikave reformuese për t'u ndërmarë.

Sipas Acheson *et al.* (2018), vendimet shtetërore duhen të merren bazuar në trajtimin analitik të elasticitetit të të ardhurave të gjeneruara nga TVSH, duke u fokusuar në të ardhurat dhe shpenzimet fiskale në vend. Në këtë mënyrë mund të priten vendime efikase dhe eficiente fiskale me qëllim rritjen ekonomike në vend. Ata treguan se, sa më e lartë të jetë norma e taksimit të të ardhurave aq më të ulta rezultojnë të ardhurat e disponueshme; gjithashtu, përpjekja për të lidhur TVSH-n me pabarazinë e të ardhurave tregoi një dyfishim të reduktimit të elasticitetit të TVSH-s.

Acheson et al. (2018), sugjeruan se elasticiteti i TVSH-s duhet të jetë më i ulët se elasticiteti i të ardhurave taksore në përgjithësi, në mënyrë që të kemi rritje ekonomike. Velu (2017) tregoi se të ardhurat fiskale Jo-Deformuese (duke u përfshirë këtu TVSH, si taksa me peshën specifike më të madhe në këtë kategori), rezultoi të ishte variabli i vetëm me ndikim në rritjen ekonomike të Shqipërisë, pozitivisht influencues. Faza ciklike që vendi përjeton është një varibël i cili ndikon në performancën e TVSH-s, për këtë arsye shumë studiues janë fokusuar në vendet në zhvillim.

Duke analizuar të dhënat për 19 vende, ku paneli i të dhënave u trajtua me metodën GMM, Kolahi dhe Noor (2015) ekzaminuan efektin e TVSH-s në rritjen ekonomike nëpërmjet kanaleve të kursimit në akumulimin e kapitalit dhe produktivitetin. Rezultatet treguan që TVSH ka një ndikim negativ në nivelin rritës të akumulimit të kapitalit dhe ndikim pozitiv në rritjen ekonomike si rezultat i kanaleve të tjera, jo e lidhur me rritjen e kursimit dhe efektin e tij në akumulimin e kapitalit.

TVSH mund të rezultojë në reduktim të sasisë së të mirave dhe shërbimeve të konsumuara edhe nëse shpenzimet qëndrojnë të pandryshuara, rrjedhimisht kjo çon në humbje neto që redukton konsumin e ardhshëm më shumë sesa shpenzimet korente (Martin S. Feldstein, 2008).

Një gjetje e tillë u përforcua edhe nga studimi i Atul *et al* (2020) duke sjellë në vëmendje se ndryshimet në TVSH shkaktuan disa efekte në ekonomi. Fillimisht, ndryshimi shkaktoi një rritje të inflacionit duke zvogëluar ndjeshëm konsumin dhe efekti zinxhir u reflektua edhe në reduktimin e prodhimit nga ana e bizneseve, rënien e të ardhurave marzhinale dhe rrjedhimisht u shfaq ndikimi negativ në ekonomi.

Studiuesit treguan gjithashtu impaktin e investimeve të huaja direkte të influencuara nga ndryshimi i normës së TVSH-s me një rol negativ në rritjen ekonomike të vendit, por nga ana tjetër theksuan ndikimin pozitiv të TVSH-s në fazën fillestare të ndryshimit të saj mbi reduktimin e borxhit publik. Lidhja e TVSH-s në afatin e gjatë mbi rritjen ekonomike reflektohet pozitive dhe me një normë prej 2% influence në GDP reale sipas Atul *et al.* (2020).

### III. Materialet dhe Metoda

3.1 *Ecuria e të ardhurave sipas rajoneve të vendit.* Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, llojet kryesore të të ardhurave të siguruara në buxhetin e shtetit janë si vijonë në Tabelën 1. Si edhe vihet re, TVSH neto ka një rënie në arketim me -4.058 për vitin 2018 dhe madje rënia vazhdon edhe për vitin 2019 krahasimisht me planifikimin për të, me një normë prej 171%. Një rënie e të ardhurave vihet re edhe nga Tatim Fitimi dhe Kazinotë, respektivisht me -455 mil lek dhe -181 mil lek. Aplikimi i rregullave strikte për të administruar më mirë tregun e Kazinove dhe sigurimi i një transparence më të lartë ka gjeneruar një efekt të tillë fillestar, por e parë në këndvështrim makro, përderisa edhe Tatim Fitimi ka pësuar rënie në 2018, marrja në konsideratë e një frenimi të rritjes së bizneseve ngelet një nga argumentat më bindës për rezultatin. Diferenca ndërmjet dy viteve do të reflektonte tendencën e 2018 për çdo të ardhur taksore për shkak të pragut të pandemisë globale Covid-19, por përsëri ndryshimi më i lartë në përqindje, rezulton për TVSH-në.


Tabela.1 Ecuria e të ardhurave nga lloje të ndryshme taksash për 2018 dhe 2019.

	Dhjetor'19 (%)	Fakt 2018 (mil lek)
<i>TR bruto</i>	2.8	589
<i>TR Tatimore Bruto</i>	0.4	62
<i>TVSH Bruto</i>	14	569
<i>TVSH Neto</i>	-170.9	-4.058
<i>Rimbursime TVSH</i>	271.2	4.627
<i>TF</i>	-10.6	-455
<i>TAP</i>	3.4	94
<i>Taksa Nacionale</i>	0.2	2
<i>Taksa Qarkullimi</i>	2.4	38
<i>Kazinote</i>	-71.1	-181
<i>TR Tatimore Neto</i>	-36.7	-4.565
<i>Sigurimet</i>	7.5	527
<i>TR Neto</i>	-20.8	-4.038

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), 2020

Nëse do të përqëndroheshim në ecurinë e të ardhurave nga TVSH bruto, referuar 2018-2019, sipas rajoneve të vendit (Figura 1) shohim se, rajoni i Durrësit i cili është një rajon me popullsi të konsiderueshme dhe pikë strategjike gjeografikisht për stimulimin e biznesit, ka gjeneruar një ulje në të ardhurat nga TVSH në vlerë absolute prej -21.777 mil lek, pasuar nga Vlora me -12.001 mil lek.

Figura 1: Arketimet e TVSH bruto sipas rajoneve në vitin 2018 dhe 2019.




**Burimi:** Paraqitja vizuale e autorit, 2023, bazuar në të dhënat e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve (DPT), 2020

Në këto rajone, ku fluksi tregëtar mendohet të ketë densitet të lartë për shkak të porteve detare, rënia e TVSH-së është e evidente, por ndryshimi relativ rezulton më i lartë në Vlorë me -17.6% se sa në Durrës me -11.2%. Rënia e TVSH-s reflektohet gjithashtu edhe në rajonet e Lezhës me një diferencë absolute negative prej 5.111 mil lek dhe Dibrës, me një diferencë prej 1.840 mil lek.

Rajonet e tjera kanë një diferencë absolute pozitive të ndryshimit të të ardhurave të gjeneruara nga TVSH, ku vlera më e lartë për 2019 arrihet nga rajoni i Tiranës me 153.729 mil lek, pasuar nga Fieri me 87.198 mil lek dhe Elbasani me 28.513 mil lek. Ndryshimin më të ulët e arrin Saranda me 272 mil lek.

Nëse i referohemi vlerave relative, norma më e lartë e ndryshimit të të ardhurave të TVSH-s në rajonet me tendencë pozitive për 2019, arrihet në Fier me 132.5%, ndjekur nga Berati me 60.3%. Duke iu referuar Figurës 2, shohim se norma relative më e ulët arrihet në Sarandë me vetëm 1.09%.


Figura 2: Ndryshimi relativ i TVSH-s bruto sipas rajoneve për vitet 2018-2019.



**Burimi:** Paraqitja vizuale e autorit, 2023, bazuar në të dhënat e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve (DPT), 2020

Skatërploti i normave relative (Figura 3), tregon vlera të përqëndruara kryesisht në segmentin [10%-40%], por edhe vlera negative.

Figura 3: Shpërndarja e vlerave të diferencës relative të TVSH-s ndërmjet rajoneve.




**Burimi:** Llogaritje dhe paraqitje vizuale të autorit, 2023. Baza e të dhënave DPT.

Rajonet si Dibra, Durrësi, Lezha dhe Vlora marrin vlera negative duke nënkuptuar një rënie të aktivitetit tregëtar në këto rajone, ku vlera më e lartë rënëse arrihet në Vlorë. Nëse do t'i referohemi të ardhurave në total të gjeneruara sipas rajoneve, vihet re se vlerën më të lartë për 2018 e siguron Saranda me 16.6%, ndjekur nga Berati me 10.8%, Elbasani me 10.6% dhe Lezha me 10.2%.

Vetëm rajoni i Fierit për 2018 shënon rënie të të ardhurave me -5.7% e cila do të vazhdojë edhe në planin e 2019 me -2.2%, ndryshe nga rajonet e tjera që për 2018 kanë norma pozitive, në plan të 2019 rezultojnë me norma negative si Berati, Gjirokastra, Korça, Kuksi, Lezha, Shkodra dhe Tirana.

Rajonet si Durrësi, Elbasani, Saranda dhe Vlora, rezultojnë më trend pozitiv nga njëri vit në tjetrin, pavarësisht luhatjes marxhinale të normave rritëse të tyre (Figura 4).

Figura 4: Ecuria e të ardhurave sipas rajoneve për vitin 2018 krahasuar me planin në vitin 2019.



**Burimi:** Paraqitja vizuale e autorit, 2023, bazuar në të dhënat e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve (DPT), 2020

Nga analiza e të dhënave, qartësisht është e dukshme se, pavarësisht vlerave pozitive të trendit të të ardhurave nga 2018 në 2019, rajonet me popullsi të vogël si Saranda apo Lezha prirën të reflektojnë këto vlera, ndërsa ecuria e rajoneve me popullsi relativisht të madhe si Tirana apo Korça reflektojnë të kundërtën, duke paraqitur influencë të një keqmanaxhimi të mbledhjes së të ardhurave dhe informalitetit në treg. Kjo vlen edhe për DTM, Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Vetëm rajonet e Durrësit dhe Elbasanit prirën të mbajnë norma brenda kuadrantit të sigurisë së mbledhjes së të ardhurave. Efekti pandemik pas 2019, i cili vazhdon edhe në ditët e sotme nuk ndryshon konkluzionin, kjo, në versionin më të mirë të mundshëm. Rajonet e Durrësit dhe Vlorës ngelen rajone të cilat, pavarësisht se kanë trend pozitiv të të ardhurave ndërmjet viteve, vihet re të kenë një trend negativ përsa i përket arkëtimeve të TVSH.

### 3.2 Korrelacioni i TVSH-s me rajonet.

Duke marrë në konsideratë rajonet si variabël të mundshëm në ndikimin e TVSH-s, është gjetur si indikator më i mirë për të gjykuar rreth ndikimit të tyre, numri i popullsisë apo dhe shpenzimet mujore mesatare për secilin rajon. Reflektimi i marrëdhënies eksport-import në TVSH, nxit shqyrtimin e shpenzimeve mesatare mujore në secilin rajon, rrjedhimisht edhe për lidhje të mundshme mes tyre.


Ndikimin e TVSH-s në të ardhurat e gjeneruara e tregon Figura 5, e cila pasqyron pikëzimet marxhinale të dy variablave duke reflektuar frekuencën për secilën vlerë.

Pikëzimi marxhinal i lidhjes ndërmjet dy variablave dhe shpërndarjes së tyre, tregon se lidhja bëhet me e fortë kur vlera e TVSH-s arrihet mesatarisht në nivelin 10% dhe të ardhurat mesatarisht në nivelin 8%.

Duke u fokusuar në rajonet me popullsi të lartë dhe nivel të lartë tregëtar, shohim se Tirana realizon një të ardhur totale prej 9.7% dhe të ardhura nga TVSH në masën 12.8%. Rajoni i Durrësit pasqyron të ardhura total në masën 7.3% dhe të ardhura nga

TVSH rënese në masën -4.4%. Rënia e të ardhurave dhe TVSH-s njëkohësisht, pasqyrohet vetëm për Dibrën, ekzakhtësisht me vlerat -5.5% dhe -22.5%. Pra, fortësia e rënies së të ardhurave të TVSH-s është më e madhe për këtë rajon.

Figura 5: Shpërndarja frekuenciale ndërmjet të ardhurave të rajoneve dhe TVSH –s në cecilin prej tyre.



**Burimi:** Llogaritje dhe paraqitje vizuale të autorit, 2023. Baza e të dhënave nga DPT.

Ndërkohë, nëse rajoni i Fierit tregon një rënie të të ardhurave me -5.7%, TVSH është rritëse me 13.9%. Kjo e bën këtë rajon tepër të dallueshëm nga të tjerët, pasuar nga Elbasani, Berati, Kukësi, Lezha dhe Tirana që reflektojnë norma pozitive të dy variablave.

Analiza Deskriptive, e paraqitur në Tabelën 2, tregon përveç statistiakve të tjera edhe koeficientët Kurtosis dhe Skewness, për të kuptuar shpërndarjen e të dhënave.

Tabela 2: Analiza Deskriptive e të Ardhurave Totale dhe atyre nga TVSH ndërmjet rajoneve.

	Të Ardhura Bruto sipas rajoneve	TVSH bruto sipas rajoneve
<i>N</i>	15	15
<i>Mesatarja</i>	6.32	6.13
<i>StDev</i>	5.98	12.83
<i>Varianca</i>	35.81	167.72
<i>CoefVar</i>	94.69	209.49
<i>Minimum</i>	-5.7	-22.5
<i>Maximum</i>	16.6	27.1
<i>Skewness</i>	-0.84	-0.73
<i>Kurtosis</i>	0.82	0.6

**Burimi:** Llogaritje të autorit, 2023. Baza e të dhënave nga DPT.

Vlera 0.6 e koeficientit Kurtosis për të ardhurat nga TVSH bruto tregon se grafikisht të dhënat janë më të harkuara sesa shpërndarja normale dhe me të pjerrëta nga ana e majtë përderisa koeficienti Skewness merr vlerën -0.73. Konkluzioni vlen edhe për variablin



tjetër, nëse i referohemi vlerave të po të njëjtëve koeficientë. Rrjedhimisht, për krijimin e relacioneve ekonometrike është i nevojshëm përafrimi me shpërndarjen normale, ndaj në shqyrtim janë marrë logaritmikët e vlerave të shpenzimeve mujore për secilin rajon, logaritmi i numrit të popullsisë për secilin rajon dhe variablat e TVSH bruto dhe të ardhurave totale bruto, të shprehura në përqindje. Kampionimi i vogël i të dhënave ekzistuese, pavarësisht modifikimit të tyre, rezultoi me një model ekonometrik jo fort të kënaqshëm statistikisht, referuar p-value dhe F-së, për  $\alpha=0.05$ .

Tabela 3: Korrelacionet ndërmjet variablave TVSH bruto sipas rajoneve, Log Popullsi sipas rajoneve dhe Të Ardhurat Bruto sipas rajanove.

<i>Term</i>	<i>TVSH Bruto sipas Rajoneve</i>	<i>Log Popullsia sipas rajoneve</i>	<i>Log Shpenz. Mujore sipas rajoneve</i>
<i>Log Popullsia sipas rajoneve</i>	-0.082		
<i>Log Shpenz. Mujore sipas rajoneve</i>	0.116	0.167	
<i>Të Ardhura Bruto sipas rajoneve</i>	0.707	0.586	
<i>Të Ardhura Bruto sipas rajoneve</i>	0.578	0.000	0.165
<i>Log Shpenz. Mujore sipas rajoneve</i>	0.039	0.999	0.590

**Burimi:** Llogaritje të autorit, 2023. Baza e të dhënave nga DPT, INSTAT.

Nga Tabela 3, duke iu referuar edhe koeficientit Pearson, i cili tregon mbi korelacionin ndërmjet variablave, shohim se lidhja e duhur statistikisht është ndërmjet Të Ardhurave Bruto dhe TVSH-s Bruto sipas rajoneve, në vlerën 0.578. Kjo pasi  $p=0.039$  dhe është më e vogël se 0.05. Ky fakt, tregon se TVSH është taksa e cila kontribuon më shumë në sigurimin e të ardhurave totale në vend, pra ngelet taksa më prioritare për gjenerimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Lidhjet ndërmjet TVSH-s Bruto dhe variablave të tjerë statistikisht rezultojnë jo të duhura.

#### IV. Konkluzione

Rezultatet e arritura nga analiza deskriptive e të dhënave të siguruara për rajonet e Shqipërisë, tregojnë se TVSH ngelet një nga llojet e taksimit me peshën specifike më të lartë në të ardhurat shtetërore. Rajoni i Elbasanit, Fierit, Beratit, Kuksit janë ato që kontribuojnë më shumë në TVSH-në bruto të siguruar para Covid-19, në kontrast të dukshëm me rajonet me popullsi të madhe si Tirana, Durrësi apo dhe Vlora. Pavarësisht se rajonet e fundit rezultojnë me të ardhura totale bruto në rritje, për periudhën para Covid-19, ato gjithashtu reflektojnë një rënie të të ardhurave nga TVSH, për po të njëjtën periudhë. Vetëm rajoni i Fierit tregon se ka një rënie të të ardhurave totale bruto me -5.7% para Covid-19, ndërkohë një rritje të të ardhurave nga TVSH me 13.9%. Kjo tregon se nuk ka një lidhje specifike ndërmjet rajonit dhe TVSH-s, matur ky në termat e numrit të popullsisë apo dhe të shpenzimeve mesatare mujore të tyre. Koeficienti Pearson me vlerë 0.578 statistikisht ( $p<0.05$ ) tregon lidhje të TVSH-s me të ardhurat totale përsa i përket rajoneve. Lidhja bëhet më e fortë kur

TVSH rezulton në nivelin e normës marxhinale 10% dhe variabli e ardhur totale bruto marxhinalisht në nivelin 8%. TVSH duket se nuk influencohet nga kriteri rajon. Rajone të vogla gjenerojnë më tepër të ardhura se rajonet e mëdha, para pandemisë Covid-19. Për këtë periudhë vihet re se edhe të ardhurat nga TVSH për tatimpaguesit e mëdhenj (DTM) janë ulur me 13.4%, fakt i cili përforcon idenë që konsumi mesatar rajonal të mos ketë përparësi në të ardhurat e TVSH-s kundrejt idesë së përqëndrimit të industrisë së rëndë në rajonet e përmendura për të ardhura të larta të kësaj takse.

### Referencat

- Ahmad, N., Ahmad, A., and Yasmeen, K. (2013). The Impact of Tax on Economic Growth of Pakistan: An ARDL Approach. *Journal of Basic and Applied Scientific Research*, 3(11), 392-398.
- Acheson, J., Deli, Y., Morgenroth, E.L., Lambert, D., & Murphy, M. (2018). VAT revenue elasticities: An analytical approach, *ESRI Working Paper*, No. 596, Source: <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/193933/1/WP596.pdf>.
- Atul, B., Ahmed, A., Alfardan, A. (2020). Role of Value Added Tax in the Economic Development of Kingdom of Bahrain, *Journal of Critical Reviews*, Vol 7(3), ISSN: 2394-5125, <http://dx.doi.org/10.31838/jcr.07.03.03>
- Barro, R (1990) "Government Spending in a Simple Model of Endogenous Growth", *Journal of Political Economy*, pp-103-125.
- Bucovetsky, S. (1991). Asymmetric Tax Competition. *Journal of Urban Economics*, 30, 167-181.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, <https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>.
- Feldstein, M. (2008). Effects of Taxes on Economic Behavior. *National Tax Journal*, 61:1, pp131-139, <http://dx.doi.org/10.17310/ntj.2008.1.06>.
- Hassan, B. (2015). The Role of Value Added Tax in the Economic Growth of Pakistan. *Journal of Economics and Sustainable Development*, 6(13), pp. 174-183.
- Inimino, E.E., Otubu, O.P., and Akpan, J.E. (2018). Value Added Tax and Economic Growth in Nigeria. *International Journal of Research and Innovation in Social Sciences*, 2(10), pp.211-219.
- Jourmard, I. (2002). Tax Systems in European Union Countries. *OECD Economic Studies*, 34, pp.91-151, [http://dx.doi.org/10.1718/eco\\_studies-v2002-art4-en](http://dx.doi.org/10.1718/eco_studies-v2002-art4-en).
- Krugman, P., Alm, J., Collins, S and Remolina, F. (1992). Transforming the Philippine Economy. *Quezon City: APO Production Unit, Inc.*
- Kanguri, R. and Keen, M. (1993). Jeux Sans Frontieres: Tax Competitions and Tax Coordinations When Countries Differ in Size. *American Economic Review*, 83, pp.877-892.
- Kalas and Milenković (2017). The Role of Value Added Tax in the Economy of Serbia, *Ekonomika 63 (2)*, 2017, Central and Eastern European Online Library.
- Ministri e Financave, [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Strategjia-Sektoriale-per-Menaxhimin-e-Financave-Publike\\_-Permbledhje-2019-2022\\_ALB.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Strategjia-Sektoriale-per-Menaxhimin-e-Financave-Publike_-Permbledhje-2019-2022_ALB.pdf).
- Popescu, M.O., Stancu, S., Ognerov, V., (2019). Relationship between VAT Revenue and Intermediate Consumption-A VAR Approach. *Proceeding of the International Conference on Applied Statistics*, Vol 1, [doi.org/10.2478/icas-2019-0031](http://doi.org/10.2478/icas-2019-0031).
- Veliu, M. (2017). Flat Tax versus Progressive Tax, which performs better in Economic Growth of Albania?, *Proceeding of International Conference on Socio-Economic Perspectives in the Age of XXI Century Globalization*, Faculty of Economy, FEUT, University of Tirana, ISBN: 978-9928-149-43-5, pg10.
- Tanzi, V. (1995). *Taxation in an Integrating World*. Washington, DC, Brookings Institution.
- Wilson, J. (1991). Theories of Tax Competition. *National Tax Journal*, 52, pp 269-304.
- Zeraibi, A., & Subhadeep, M. (2019). Value Added Tax and Economic Growth: An Empirical Study of China Perspective. *Jurnal Ilmu Ekonomi*, Volume 8(2), 2019: 235-242, P-ISSN: 2087-2046, E-ISSN: 2476-9223

# NJË ANALIZË DESKRIPTIVE DHE REGRESIVE PËR VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR PËR INDEKSIN E ÇERTIFIKATAVE ISO Enriko CEKO<sup>1</sup>

## Abstract

The purpose of this study was to examine the situation regarding the ISO standardized certification until 2021 and to carry out a comparative and descriptive analysis of the Balkan countries. In fact, the countries so far regarding ISO certificates are listed in alphabetical order and according to the number of issued and active ISO certificates and these two listings/rankings do not reflect reality. On the other hand, in relation to the countries of the Balkans, where most of them still aim for integration in the European Union, where certification and standardization are important elements of the political, economic, social, legal, cultural, etc. system, it is important to realize a comparative analysis to see the situation and give recommendations and suggestions for the future. The methodology used in this research is the collection of data on the number of all issued and active ISO certificates in the world, the collection of data on the number of active businesses in these countries, dividing the number of expired and active ISO certificates by year 2021 with the number of businesses in each country to calculate the specific weight of each country in order to create a new listing/ranking of countries according to the ISO standards index and further highlighting the position of each Balkan country in this listing/ranking based on the ISO certification index.

The methods used in this research are the statistical methods of regression analysis and descriptive analysis for ISO certificates in the Balkan countries. The main conclusion of this research is that the most suitable index for listing/ranking countries in relation to ISO certificates is that of the ISO certificates index, compared to the two previous listings in alphabetical order and according to the total number of issued and active ISO certificates, because this new listing creates a better perception for doing business in general and for quality management in particular, mainly when it comes to making appropriate comparisons between countries and in relation to the Balkan countries, it is necessary that the certification and the standardization of processes, procedures, documentation and the way of keeping data in both the public and private sectors to be improved.

**Key words:** ISO Index, Quality management, ISO Certificates, Standard, Quality culture, Economic advantages.

## Hyrje

Aktualisht ka një interes në rritje për cilësinë, kulturën e cilësisë dhe standardet ISO, pasi cilësia lidhet në mënyrë eksplicite dhe të drejtpërdrejtë me karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve. Kultura e cilësisë shërben si një udhërrëfyes për përmirësim të vazhdueshëm, si një karakteristikë që u përket të gjithë anëtarëve të organizatës(ve), duke sjellë dhe formuar edhe një lidhje më të fortë midis organizatës dhe klientëve e furnitorëve të saj të brendshëm dhe të jashtëm. Vlera thelbësore e kulturës së cilësisë është mishëruar në standardet ISO, për të cilat ka një interes në rritje në mbarë botën, pasi standadizimi dhe çertifikimi janë disa nga rrugët dhe mjetet për arritjen dhe mirëmbajtjen e avantazheve ekonomike. Cilësia, kultura e cilësisë, menaxhimi i kulturës së cilësisë dhe standardet ISO po bëhen një pjesë thelbësore e modeleve të biznesit nën realitetin e ri dhe normalitetin e ri të krijuar pas pandemisë COVID-19.

## 1. Rishikim literatur

### 1.1 Cilësia dhe kultura e cilësisë

Përkufizimi thelbësor i cilësisë, si një grup vlerash që ndihmon se si bëhet përmirësimi në praktikën e përditshme i proceseve, procedurave dhe produkteve, si një grup aplikimesh të

---

<sup>1</sup> Instituti Kanadez I Teknologjisë, Rruga Xhanfize Keko. Nr 12. Tiranë, Shqipëri, enriko.ceko@cit.edu.al, ORCID: 0000-0002-3372-2785

marra si të mirëqena që formojnë filozofinë e organizatave ose grupeve të punës, është identifikuar nga disa autorë, të cilët e kanë përcaktuar kulturën e cilësisë si “ndërveprim aktiv social që mbështet njerëzit në organizatë për të qëndruar së bashku” (Vlăsceanu, Grünberg, Pârlea. 2007). Kjo kulturë duket në: (1) përmirësimin individual, (2) tolerimin dhe respektimin e të tjerëve, (3) sipërmarrje, (4) posedimin e kapaciteteve në mënyrë të dëshmuar, etj.

Kultura e cilësisë është një grup qasjesh të përbashkëta, të respektuara dhe të formuara në mënyrë integrale ndaj veçorive të produkteve dhe shërbimeve, të identifikuar në kulturën e organizatave dhe sistemeve të menaxhimit. Rëndësia e kulturës së cilësisë lidhet në mënyrë shumë të fortë me kulturën e menaxhimit të cilësisë në të bërit biznes, arritjen e avantazheve ekonomike, lidhjen e saj me përgjegjësinë sociale të korporatës, biznesin e qëndrueshëm, etikën e biznesit, çështjet e diversitetit, menaxhimin ndërkombëtar, ndërkulturor, kulturën kombëtare/ndërkombëtare organizative, kulturën e një vendi në përgjithësi dhe me sektorët e ekonomisë së atij vendi. Kultura e cilësisë është pjesë e rëndësishme e historisë së mendimit ekonomik (lidhur me kulturën e menaxhimit të biznesit) (Ceko. 2021).

## 2.1 Standarded ISO

Standarded ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë edhe standarded ISO, janë standarde teknike të zhvilluara nga një ose më shumë organizata ndërkombëtare të standardeve. Standardet ndërkombëtare mund të përdoren ose me aplikim të drejtpërdrejtë ose me një proces modifikimi të një standardi ndërkombëtar për t'iu përshtatur kushteve lokale. Miratimi i standardeve ndërkombëtare rezulton në krijimin e standardeve kombëtare që janë ekuivalente, ose në thelb të njëjta me standardet ndërkombëtare në përmbajtjen teknike dhe shërbejnë për të kapërcyer barrierat teknike në tregtinë ndërkombëtare, shkaktuar nga ndryshimet midis rregulloreve teknike dhe standardeve të zhvilluara në mënyrë të pavarur dhe veçmas nga çdo shtet, organizatë kombëtare standardesh ose biznes individual. Standardet ndërkombëtare janë të disponueshme për shqyrtim dhe përdorim në mbarë botën. Organizata më e njohur për standardet është Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), që ka filluar zyrtarisht funksionimin në shkurt 1947 (ISO. 1997). ISO është një organizatë ndërkombëtare e zhvillimit të standardeve e përbërë nga përfaqësues nga organizatat kombëtare të standardeve të vendeve anëtare (ISO. 2015), që tashmë ka 167 anëtarë që përfaqësojnë institucionet e standardeve në këto vende, ku secili vend ka një votë (ISO. 2023).

Organizata ndërkombëtare e standardeve (ISO), ka publikuar deri në nëntor 2022 më shumë se 24,500 standarde ndërkombëtare, që mbulojnë pothuajse të gjitha aspektet e teknologjisë dhe prodhimit, siguria ushqimore, bujqësia, kujdesi shëndetësor, etj (Green & Hale. 2021). ISO publikon edhe raporte teknike, specifikime teknike, specifikime të disponueshme publikisht, korrigjime teknike dhe udhëzues (ISO. 2008). Këto standarde aplikohen pasi në tregun e sotëm global, shumica e bizneseve duan të njihen për respektimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë. Çertifikimi me standardet ISO ndihmon për të siguruar që një organizatë plotëson standardet ndërkombëtare për tregtinë dhe rëndësia e tyre dhe aplikimi i këtyre standardeve në praktikë është përshkruar në shumë publikime (Harrington & Mathers, 1997).

Pothuajse çdo biznes mund të përfitojë nga çertifikimi me standardet ISO, dhe më shumë se 1 milion organizata publike dhe private në më shumë se 165 vende po e vërtetojnë këtë. Është gjithashtu e sigurt të thuhet se çertifikimi me standardet ISO është i dobishëm për industri të ndryshme, jo vetëm për prodhimin, prandaj, çelësi i suksesit është kuptueshmëria e qëllimeve të organizatës dhe zgjedhja e standardeve të duhura ISO që përmirësojnë operacionet e organizatës, ulin kostot e saj dhe, më e rëndësishmja, sjellin edhe më shumë klientë të rinj (Advisera. 2019).

## **2.2 Përfitimet e aplikimit të standardeve ISO**

Sipas Organizatës Ndërkombëtare së Standardeve, ekzistojnë tre lloje kryesore të përfitimeve nga përdorimi i standardeve (ISO, 2014, ANSI 2014):

### Përfitimi kryesor 1: Orientimi i operacioneve të brendshme

Një gjetje kryesore është se standardet mund të përdoren për të përmirësuar proceset e brendshme të një kompanie, për shembull duke reduktuar kohën e nevojshme për të kryer aktivitete specifike në funksione të ndryshme të biznesit, duke ulur humbjet, duke reduktuar kostot e prokurimit dhe duke rritur produktivitetin (ANSI. 2014) . Rastet studimore raportojnë vazhdimisht se kontributi i standardeve në fitimin bruto të kompanive varion ndërmjet 0,15 % dhe 5 % të të ardhurave vjetore nga shitjet.

### Përfitimi kryesor 2: Inovimi dhe përshkallëzimi i operacioneve

Disa raste studimore ofrojnë shembuj ku standardet shërbyen si bazë për inovacionin e proceseve të biznesit, duke i lejuar kompanitë të zgjerojnë rrjetin e furnitorëve të tyre ose të prezantojnë dhe menaxhojnë linjat e reja të produkteve në mënyrë efektive (Musa. 2014). Në raste të tjera, standardet ndihmuan në zbutjen e rrezikut për kompanitë për të futur produkte të reja në tregjet kombëtare (ANSI. 2014).

### Përfitimi kryesor 3: Krijimi ose hyrja në tregje të reja (ANSI. 2014)

Standardet janë përdorur si bazë për zhvillimin e produkteve të reja, depërtimin në tregje të reja (si vendas ashtu edhe eksportues), duke mbështetur marrjen e produkteve nga tregu, madje edhe krijimin e tregjeve. Në raste të jashtëzakonshme, ndikimi i standardeve tejkaloi shumë shifrën e përmendur më sipër, me kompanitë që arritën një kontribut fitimi bruto deri në 33% të të ardhurave të tyre vjetore, gjë që i ndihmoi ata të pozicionoheshin si liderë në fushën e tyre, të paktën gjatë një periudhe të caktuar ( ISO 2014).

## **2.3 Standardet ISO më të rëndësishme**

Standardet ISO më të rëndësishme për vitet e fundit (Horielikova. 2019 dhe Best Practice. 2022), kanë qenë

ISO 9000: SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË (QMS) - Standardi ISO 9000 është seria më e rëndësishme e standardeve që përfshin 14 standarde të menaxhimit të cilësisë. Versioni më i fundit i këtij standardi, ISO 9001:2015, përshkruan se si krijohet një SMC efektive për të ndihmuar organizatën të ofrojë produkte dhe shërbime me cilësi të lartë. Ky standard fokusohet kryesisht në menaxhimin e nivelit të lartë dhe përmirësimin e vazhdueshëm për të siguruar që një organizatë plotëson nevojat e klientëve dhe palëve të interesuara.

ISO 27001: SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË TË INFORMACIONIT (ISMS) - ISO 27001 është një tjetër certifikim ISO që i jep kompanisë një kornizë për të ruajtur asetet e informacionit për të siguruar që biznesi të jetë i sigurt nga kërcënimet e sigurisë së informacionit. Duke zbatuar ISO 27001, organizatat janë në gjendje të mbrojnë integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit të tyre duke vendosur procese të menaxhimit të rrezikut për të menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive.

ISO 14001: SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR (EMS) - Ky standard lidhet me ndikimin e një organizate në mjedis. Është zhvilluar për të optimizuar performancën mjedisore të kompanisë dhe për të zvogëluar ndikimin mjedisor. ISO 14001 përfshin një sërë standardesh që udhëzojnë subjektet e biznesit se si të menaxhojnë përgjegjësitë e tyre mjedisore duke vendosur objektiva të reja dhe inovative mjedisore. Roli i një sistemi të menaxhimit mjedisor

është të kontrollojë se si proceset ndikojnë në mjedis. Ai gjithashtu përcakton aftësitë e nevojshme për një individ për të kryer një detyrë duke zbutur shanset e efekteve mjedisore.

**ISO 22000: MENAXHIMI I SIGURISË USHQIMORE** - ISO 22000 përfshin zhvillimin dhe zbatimin e praktikave të menaxhimit të sigurisë ushqimore të dobishme për kompanitë që punojnë në industrinë ushqimore. Ai ofron udhëzime për organizatat për të krijuar, zbatuar dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të menaxhimit të sigurisë ushqimore. Ky standard mund të funksionojë më vete ose të inkorporohet me ISO 9001.

**ISO 45001: SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË** - ISO 45001 është krijuar për të ndihmuar kompanitë të përsosin sistemet e tyre të shëndetit dhe sigurisë në punë. Për të marrë këtë certifikatë, subjektet duhet të hetojnë dhe adresojnë rreziqet shëndetësore në mjedisin e tyre të punës dhe të zbatojnë një politikë të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë që shtrihet në të gjitha nivelet e operacioneve. Ky standard synon të reduktojë lëndimet, dëmtimet, plagosjet, sëmundjet dhe vdekjet në punë.

## 2.4 Literatura për listimin / rankimin me standarde ISO

Aktualisht, literatura mbi listën e standardeve ISO nuk është zhvilluar dhe ekziston vetëm një raport mbarëbotëror i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve, ISO, i quajtur: Vrojtimi ISO i certifikatave standarde të sistemit të menaxhimit (ISO. 2022). Certifikimi me standartet ISO është një sistem sipas të cilit, në fund të fundit, nëse një subjekt e meriton, certifikata, dokumenti i lëshuar nga një organizëm certifikues, është dorëzuar pasi klienti të ketë demonstruar konformitetin me standardin. Sipas ISO, të dhënat e mbledhura për sondazhin e fundit të publikuar të vitit 2022 ishin:

- Numri i certifikatave të vlefshme për shtet deri më 31 dhjetor 2020. (Një certifikatë është e vlefshme nëse është lëshuar nga një organ certifikues i akredituar nga anëtarët e IAF MLA gjatë vitit të anketimit ose në dy vitet para tij që është ende e vlefshme më 31 dhjetor të vitit të studimit).
- Numri i sektorëve për shtet mbulohet nga certifikatat sipas klasifikimit të sektorëve 39 EA.
- Numri i siteve zyrtare të bizneseve për shtet mbulohet nga certifikatat e tyre (Një sit zyrtar është një vend i përhershëm ku një organizatë realizon produkte dhe / ose shërbime).

### Ky raport përmban

- Një tabelë përmbledhëse që tregon numrin total të certifikatave të vlefshme dhe numrin total të siteve zyrtare për çdo standard (një "site" është një vend i përhershëm ku një organizatë realizon produkte dhe / ose shërbime).
- Rezultatet e detajuara për secilin standard të mbuluar nga sondazhi me të dhënat sipas vendeve për numrin e certifikatave dhe numrin e siteve dhe numrin total të sektorëve. Numri i sektorëve për shtet është në një skedar i veçantë i quajtur "Sektorët sipas vendit". Sondazhi ISO i Certifikimit është një studim vjetor i numrit të certifikatave të vlefshme sipas standardeve të sistemit të menaxhimit ISO në mbarë botën. Ofruesit e të dhënave janë organet e certifikimit të akredituar nga Anëtarët e MLA të IAF (ISO. 2021).

Raporti paraqet gjetjet në tabela:

- Numri total i certifikatave të vlefshme dhe numri i përgjithshëm i siteve për secilin standard të mbuluar nga anketa.
- Për secilin prej standardeve, numri i certifikatave dhe numri i siteve.

Siç deklarohet edhe në publikimin e ISO, Sondazhi ISO nuk është një bazë të dhënash. Ofruesit e të dhënave janë organizmat certifikuese të akredituar nga anëtarët e IAF dhe marrin pjesë vullnetarisht. Niveli i pjesëmarrjes luhet nga një botim i anketës në tjetrin dhe mund të ndikojë në rezultatet e anketës, veçanërisht në nivel vendi. Interpretimet e rezultateve dhe çdo

përfundim mbi tendencat duhet të bëhen duke pasur parasysh këto konsiderata. Duke thënë se nuk ka një listë të vendeve të bazuara në ndonjë logjikë, parametra apo indeks.

## 2. Metodologjia

Në mënyrë të veçantë, ndërsa pranojnë rëndësinë e certifikatave ISO të lëshuara në mbarë botën dhe për çdo rajon dhe vend, publikimet e mëparshme dhe aktuale për këtë çështje thjesht rendisin vendet sipas rendit alfabetik dhe nuk shpjegojnë se si të listohen vendet për certifikatat e standardeve ISO bazuar në një perspektivë logjike, për shembull, bazuar në një parametër, ose bazuar në një indeks, sepse nëse parametri ose indeksi ekziston, atëherë është më e lehtë të renditen vendet për këtë çështje bazuar në logjikë. Kjo vlen edhe për indeksin e standardeve ISO, ose shkurtimisht Indeksin ISO, që realizohet me anë të këtij kërkimi dhe që e bën më të lehtë listimin / renditjen e vendeve në lidhje me standardet ISO dhe kështu sjell edhe një qasje më cilësore në lidhje me gjendjen e cilësisë, menaxhimin e cilësisë dhe kulturën e cilësisë në botë, rajone dhe vende të ndryshme, duke sjellë edhe më shumë lehtësi në bërjen e krahasimeve dhe të të kuptuarit të klimës së biznesit si dhe duke ndihmuar për një hulumtim dhe raporte akademike më të plota cilësore dhe sasore mbi këtë çështje, duke ofruar një qasje eksploruese, të përshtatshme për ndërtimin e një kuptimi të thellë të kësaj dukurie dhe duke lejuar një hetim më të afërt të konstrukteve teorike dhe praktike për këto çështje.

### 2.1 Përzgjedhja e rastit

Rasti u zgjodh në bazë të tre kriterëve kryesore: një qasje teorike, përshtatshmëria e marrëdhënieve dhe ndikimet praktike pozitive në marrëdhëniet ndërmjet certifikatave të standardeve ISO të lëshuara në një vend dhe numrit të bizneseve në një vend.

#### 2.1.1 Mbledhja e të dhënave

- Të dhënat për certifikimin me standardet ISO 9001 të lëshuara dhe aktive të mbledhura nga Raporti ISO 2022.
- Të dhënat për numrin e bizneseve për shtet të mbledhura nga HitHorizons (vizituar gjatë qershorit 2023).

#### 2.1.2 Analiza e të dhënave

Të dhënat për certifikimin me standardet ISO të lëshuara dhe aktive, të mbledhura nga Raporti ISO 2022, u pjestuan me numrin e bizneseve për shtet, të mbledhura nga HitHorizons (vizituar gjatë qershorit 2023). Numrat që rezultuan nga kjo procedurë formuan listën e vendeve bazuar në indeksin ISO.

Në tabelën e mëposhtme në kolonën e parë e cila është ndarë në tre pjesë (1) jepet një listë e vendeve për lëshimin e certifikatave ISO deri në vitin 2021 bazuar në renditjen alfabetike, marrë nga ISO, (2) në numrin e kompanive aktive të rreshtit sipas rendit alfabetik, jepet numri i bizneseve për shtet, marrë nga HitHorizon, dhe (3) në indeksin ISO, vendet renditen nën një renditje alfabetike për indeksin e krijuar duke pjesëtuar numrin e certifikatave ISO të lëshuara me numrin e bizneseve aktive për vend (i cili është indeksi i ri që paraqet ky punim), në kolonën e dytë vendet listohen sipas numrit të certifikatave ISO të lëshuara dhe aktive, në kolonën e tretë vendet listohen sipas indeksit ISO të fituar nga pjestimi midis numrit të certifikatave ISO me numrin e bizneseve nga vlera më e madhe në vlerën më të vogël dhe pas kryerjes së analizës descriptive në kolonën e fundit jepet kuartilja për çdo vend.





**Tabela 1. Lista e vendeve, certifikatat totale ISO (deri në vitin 2021), numri i bizneseve për shtet, indeksi i certifikatave ISO dhe kuartiljet.**

Lista sipas alfabetit				Lista sipas numrit të certifikatave ISO		Lista sipas indeksit ISO		Kuartiljet për ISO index
Shteti	TOTALI	No B	ISO INDEX	Shteti	TOTALI	Shteti	ISO INDEX	
Albania	4578	166.086	0.00027564	China	4682049	Tajikistan	8.56	I
Algeria	9098	2.200.000	4.13545E-05	Italy	1935248	Qatar	5.1228	II
Angola	1227	55	0.223090909	Japan	1171833	Morocco	4.355595238	II
Argentina	117445	856000	0.001372021	France	1051212	Iran	4.144555556	III
Armenia	855	74.709	0.000114444	Spain	889427	Kuwait	3.080666667	III
Australia	201771	2.402.254	0.000839924	Germany	679856	Maldives	2.7975	III
Austria	60617	358.4	0.169132254	UK	624427	Sudan	2.2092	III
Azerbaijan	3565	2.963	0.012031725	India	535119	Guatemala	2.201111111	III
Bahrain	6561	92	0.713152174	USA	512990	Israel	2.193777403	III
Bangladesh	6456	650	0.099323077	Korea Rep	296490	Singapore	1.736125	IV
Barbados	294	18	0.163333333	Brazil	283024	Serbia	1.443042169	IV
Belarus	35898	162.788	0.002205199	Romania	235141	Lithuania	0.963820225	IV
Belgium	54290	1.032.984	0.000525565	Czech Rep	227326	Bahrain	0.713152174	IV
Belize	1364	7.975	0.001710345	Colombia	210921	Panama	0.6316	IV
Benin	417	4.5	0.092666667	Australia	201771	Ghana	0.456195652	IV
Bhutan	58	28	0.020714286	Poland	175103	Costa Rica	0.439076923	IV
B&H	14650	82.5	0.177575758	Malaysia	174511	Trnd & Tbg	0.3944	IV
Botswana	8375	26.256	0.003189747	Russia	174177	Lebanon	0.382711111	IV
Brazil	283024	6.400.000	0.000442225	Canada	159779	Jordan	0.354710744	IV
Brunei	5128	6.047	0.008480238	Hungary	140479	Namibia	0.33375	IV
Bulgaria	85299	803.29	0.010618706	Thailand	138543	Mauritius	0.245645161	IV

Burkina Faso	1293	80	0.161625	Sweden	137261	Angola	0.223090909	IV
Cambodia	914	513.759	1.77904E-05	Turkey	134278	Malawi	0.205	IV
Cameroon	1119	209.872	5.33182E-05	Israel	130091	B&H	0.177575758	IV
Canada	159779	1.230.000	0.001299016	Switzerland	128606	Austria	0.169132254	IV
Chad	83	1.2	0.069166667	Mexico	121897	Barbados	0.163333333	IV
Chile	67507	158.583	0.004256888	Netherlands	121007	Burkina Faso	0.161625	IV
China	4682049	150.000.000	0.000312137	Argentina	117445	Honduras	0.1591875	IV
Colombia	210921	2.700.000	0.000781189	Greece	114029	Uruguay	0.128412863	IV
Costa Rica	5708	130	0.439076923	Indonesia	105335	Ethiopia	0.124181818	IV
Croatia	43293	307.413	0.001408301	Bulgaria	85299	Turkey	0.123032802	IV
Cuba	4585	9.477	0.004838029	Finland	81940	Vietnam	0.117340003	IV
Cyprus	11100	248.416	0.000446831	S Africa	80082	UAE	0.101531365	IV
Czech Rep	227326	807.981	0.002813507	Slovak Rep	74149	Bangladesh	0.099323077	IV
Denmark	49309	513.934	0.000959442	Vietnam	73889	Benin	0.092666667	IV
Djibouti	92	548	0.001678832	Portugal	72158	Chad	0.069166667	IV
Egypt	40501	3.900.000	0.000103849	Singapore	69445	Liberia	0.041176471	IV
El Salvador	5314	161.934	0.000328158	Chile	67507	Senegal	0.04065625	IV
Estonia	20732	240.147	0.000863305	UAE	66036	Rwanda	0.039583333	IV
Ethiopia	683	55	0.124181818	Austria	60617	Bhutan	0.020714286	IV
Finland	81940	644.433	0.001271505	Belgium	54290	Turkmenistan	0.020664452	IV
France	1051212	6.084.269	0.001727754	Denmark	49309	Azerbaijan	0.012031725	IV
Gambia	82	115	0.007130435	Ireland	49271	Bulgaria	0.010618706	IV
Georgia	2203	23.162	0.000951127	Philippines	48147	Haiti	0.010166667	IV

Germany	679856	3.470.000	0.001959239	Serbia	47909	Kyrgyz Rep	0.009583333	IV
Ghana	4197	92	0.456195652	Croatia	43293	Niger	0.009162791	IV
Greece	114029	356.082	0.003202324	Egypt	40501	Brunei	0.008480238	IV
Guatemala	3962	18	2.201111111	Pakistan	37954	Gambia	0.007130435	IV
Guinea	248	3192	0.000776942	Iran	37301	Yemen Rep	0.00685	IV
Haiti	61	60	0.010166667	Morocco	36587	Jamaica	0.005906784	IV
Honduras	2547	160	0.1591875	Belarus	35898	Norway	0.005150266	IV
Hungary	140479	1.300.000	0.001080608	Norway	34617	Philippines	0.005027777	IV
Iceland	3521	114.636	0.000307146	S Arabia	34175	Cuba	0.004838029	IV
India	535119	63.000.000	8.49395E-05	Peru	27958	Chile	0.004256888	IV
Indonesia	105335	64.000.000	1.64586E-05	Lithuania	25734	Italy	0.003225413	IV
Iran	37301	90	4.144555556	Uruguay	24758	Greece	0.003202324	IV
Iraq	1177	27.747	0.00042419	Slovenia	24400	Botswana	0.003189747	IV
Ireland	49271	291.365	0.00169104	Ukraine	21397	New Zealand	0.003101958	IV
Israel	130091	593	2.193777403	Estonia	20732	Czech Rep	0.002813507	IV
Italy	1935248	6.000.000	0.003225413	Sri Lanka	20412	Spain	0.002644588	IV
Jamaica	7566	12.809	0.005906784	Latvia	17652	Mozambique	0.002568632	IV
Japan	1171833	5.300.000	0.002211006	New Zealand	17299	Pakistan	0.0025672	IV
Jordan	12876	363	0.354710744	Nepal	15930	Switzerland	0.002374737	IV
Kazakhstan	12592	470559	0.000267597	Tunisia	15225	Japan	0.002211006	IV
Kenya	8936	3.400.000	2.62824E-05	B&H	14650	Belarus	0.002205199	IV
Korea Rep	296490	6.013.000	0.000493082	Jordan	12876	Germany	0.001959239	IV

Kuwait	9242	30	3.080666667	Qatar	12807	Togo	0.00179496	IV
Kyrgyz Rep	253	2.64	0.009583333	Kazakhstan	12592	Romania	0.001789372	IV
Laos	521	133997	3.88815E-05	Cyprus	11100	France	0.001727754	IV
Latvia	17652	141.812	0.001244747	Uzbekistan	9513	Slovak Rep	0.001724203	IV
Lebanon	8611	225	0.382711111	Kuwait	9242	Belize	0.001710345	IV
Lesotho	97	109.268	8.87726E-06	Algeria	9098	Ireland	0.00169104	IV
Liberia	70	1.7	0.041176471	Kenya	8936	Djibouti	0.001678832	IV
Lithuania	25734	267	0.963820225	Lebanon	8611	Malaysia	0.001422844	IV
Luxembourg	4164	135.245	0.000307886	Oman	8422	Croatia	0.001408301	IV
Malawi	410	20	0.205	Botswana	8375	Argentina	0.001372021	IV
Malaysia	174511	1.226.494	0.001422844	NR Macedonia	7874	Oman	0.001351087	IV
Maldives	2238	8	2.7975	Jamaica	7566	Canada	0.001299016	IV
Malta	3626	53.348	0.000679688	Bahrain	6561	Portugal	0.001296202	IV
Mauritius	3046	124	0.245645161	Bangladesh	6456	Finland	0.001271505	IV
Mexico	121897	5.000.000	0.000243794	Costa Rica	5708	Latvia	0.001244747	IV
Moldova	1806	123.246	0.000146536	Sudan	5523	Slovenia	0.001166276	IV
Montenegro	3699	35.281	0.00104844	El Salvador	5314	Sweden	0.001143594	IV
Morocco	36587	84	4.355595238	Brunei	5128	UK	0.001115048	IV
Mozambique	1207	4.699	0.002568632	Cuba	4585	Hungary	0.001080608	IV
Myanmar	1666	59.297	0.000280959	Albania	4578	NR Macedonia	0.001079784	IV
Namibia	1335	40	0.33375	Nigeria	4209	Montenegro	0.00104844	IV
Nepal	15930	922.445	0.000172693	Ghana	4197	Denmark	0.000959442	IV
Netherlands	121007	1.900.000	0.000636879	Luxembourg	4164	Georgia	0.000951127	IV

New Zealand	17299	557.68	0.003101958	Guatemala	3962	Estonia	0.000863305	IV
Niger	197	2.15	0.009162791	Montenegro	3699	Australia	0.000839924	IV
Nigeria	4209	46.000.000	0.000000915	Malta	3626	Colombia	0.000781189	IV
NR Macedonia	7874	72.922	0.001079784	Azerbaijan	3565	Guinea	0.000776942	IV
Norway	34617	672.14	0.005150266	Iceland	3521	Poland	0.000729565	IV
Oman	8422	62.335	0.001351087	Panama	3158	Malta	0.000679688	IV
Pakistan	37954	147.842	0.0025672	Mauritius	3046	Netherlands	0.000636879	IV
Panama	3158	50	0.6316	Tanzania	2906	Belgium	0.000525565	IV
PN Guinea	836	72536	0.000115253	Honduras	2547	Russia	0.000512285	IV
Peru	27958	2.330.000	0.000119991	Uganda	2395	Korea Rep	0.000493082	IV
Philippines	48147	957.62	0.005027777	Maldives	2238	Thailand	0.00046181	IV
Poland	175103	2.400.100	0.000729565	Georgia	2203	Cyprus	0.000446831	IV
Portugal	72158	556.688	0.001296202	Togo	2080	Brazil	0.000442225	IV
Qatar	12807	25	5.1228	Moldova	1806	Iraq	0.00042419	IV
Romania	235141	1.314.098	0.001789372	Myanmar	1666	Sierra Leone	0.00039596	IV
Russia	174177	3.400.000	0.000512285	Yemen Rep	1370	S Arabia	0.00034175	IV
Rwanda	285	72	0.039583333	Belize	1364	El Salvador	0.000328158	IV
S T & Prncp	9	2.334	3.85604E-05	Namibia	1335	China	0.000312137	IV
S Arabia	34175	1.000.000	0.00034175	Senegal	1301	Luxembourg	0.000307886	IV
Senegal	1301	320	0.04065625	Burkina Faso	1293	Iceland	0.000307146	IV
Serbia	47909	332	1.443042169	Angola	1227	S Africa	0.000302196	IV
Sierra Leone	494	12.476	0.00039596	Mozambique	1207	Myanmar	0.000280959	IV

Singapore	69445	400	1.736125	Iraq	1177	Albania	0.00027564	IV
Slovak Rep	74149	430.048	0.001724203	Cameroon	1119	Kazakhstan	0.000267597	IV
Slovenia	24400	209.213	0.001166276	Trnd & Tbg	986	Mexico	0.000243794	IV
S Africa	80082	2.650.000	0.000302196	Cambodia	914	Uzbekistan	0.000240288	IV
Spain	889427	3.363.197	0.002644588	Tajikistan	856	Tunisia	0.000190075	IV
Sri Lanka	20412	1.200.000	0.0001701	Zambia	856	Nepal	0.000172693	IV
Sudan	5523	2.5	2.2092	Armenia	855	Sri Lanka	0.0001701	IV
Sweden	137261	1.200.260	0.001143594	PN Guinea	836	USA	0.000160309	IV
Switzerland	128606	541.559	0.002374737	Ethiopia	683	Moldova	0.000146536	IV
Tajikistan	856	1	8.56	Turkmenistan	622	Peru	0.000119991	IV
Tanzania	2906	3.000.000	9.68667E-06	Laos	521	PN Guinea	0.000115253	IV
Thailand	138543	3.000.000	0.00046181	Sierra Leone	494	Armenia	0.000114444	IV
Togo	2080	115.88	0.00179496	Benin	417	Ukraine	0.000108614	IV
Trnd & Tbg	986	25	0.3944	Malawi	410	Egypt	0.000103849	IV
Tunisia	15225	801000	0.000190075	Barbados	294	India	8.49E-05	IV
Turkey	134278	10914	0.123032802	Rwanda	285	Cameroon	5.33E-05	IV
Turkmenistan	622	301	0.020664452	Kyrgyz Rep	253	Algeria	4.14E-05	IV
Uganda	2395	1.500.000	1.59667E-05	Guinea	248	Laos	3.89E-05	IV
UK	624427	5.600.000	0.001115048	Niger	197	S T & Prncp	3.86E-05	IV
Ukraine	21397	1.970.000	0.000108614	Lesotho	97	Kenya	2.63E-05	IV
UAE	66036	650.4	0.101531365	Djibouti	92	Cambodia	1.78E-05	IV
USA	512990	32.000.000	0.000160309	Chad	83	Indonesia	1.65E-05	IV
Uruguay	24758	192.8	0.128412863	Gambia	82	Uganda	1.60E-05	IV

Uzbekistan	9513	395900	0.000240288	Liberia	70	Tanzania	9.69E-06	<b>IV</b>
Vietnam	73889	629.7	0.117340003	Haiti	61	Lesotho	8.88E-06	<b>IV</b>
Yemen Rep	1370	2000	0.00685	Bhutan	58	Zambia	7.13E-06	<b>IV</b>
Zambia	856	1.200.000	7.13333E-06	S T & Prncp	9	Nigeria	0.000000915	<b>IV</b>

Burimi: Numri i çertifikatave ISO deri në vitin 2021 nga ISO Survey 2022, Numri i bizneseve për çdo vend nga Horizon.com, dhe indeksi I çertifikatave ISO gjetur nga autori I këtij studimi, duke pjestuar numrin e çertifikatave ISO me numrin e bizneseve për çdo vend.





## 2.1.4 Analiza deskriptive për Indeksin ISO.

Tabela 2. Tabela e analizës descriptive për Indeksin ISO

ISO INDEX	
Mean	0.327633353
Standard Error	0.092272876
Median	0.001725979
Mode	#N/A
Standard Deviation	1.083960862
Sample Variance	1.17497115
Kurtosis	28.61657882
Skewness	4.918314816
Range	8.559999085
Minimum	0.000000915
Maximum	8.56
Sum	45.2134027
Count	138
Largest(1)	8.56
Smallest(1)	0.000000915
Confidence Level(95.0%)	0.182463266

Table 3. Lista e shteteve të Ballkanit krahasuar me analizën descriptive.

Shteti	ISO INDEX	No B
MAXIMUM (Tajikistan)	8.56	
Serbia	1.443042169	332.000
Mean	0.327633353	
B&H	0.177575758	82.500
Turkey	0.123032802	10,914.000
Bulgaria	0.010618706	803.290
Greece	0.003202324	356.082
Romania	0.001789372	1.314.098
Median	0.001725979	
Croatia	0.001408301	307.413
Slovenia	0.001166276	209.2013
NR Macedonia	0.001079784	72.922
Montenegro	0.00104844	35.281
Albania	0.00027564	166.086
MINIMUM (Nigeria)	0.000000915	

Siç shikohet edhe nga tabela e analizës deskriptive për Indeksin ISO, vetëm Serbia në Ballkan është mbi mesataren, Bosnje & Herzegovina, Turqia, Bulgaria, Greqia dhe Rumania janë

midis Mean dhe Mediana, dhe Kroacia, Sllovenia, Maqednoa e Veriut, Mali I Zi dhe Shqipëria janë nën Medianë.

### 2.1.5 Analiza regressive

Analiza regressive në rastin konkret shërben për të parë nëse ekziston lidhja midis numrit të bizneseve në vendet e Ballkanit me indeksin ISO. Për këtë ndërtojmë hipotezat që janë:

H0 – Ka një lidhje të fortë midis indeksit ISO dhe numrit të bizneseve në vendet e Ballkanit


H1 – Nuk ka një lidhje të fortë midis indeksit ISO dhe numrit të bizneseve në vendet e Ballkanit

SUMMARY OUTPUT	
Regression Statistics	
Multiple R	0.241572
R Square	0.058357
Adjusted R Square	-0.04627
Standard Error	0.439504
Observations	11

ANOVA					
	df	SS	MS	F	Significance F
Regression	1	0.10774	0.10774	0.557764	0.47422
Residual	9	1.738475	0.193164		
Total	10	1.846215			

	Coefficients	Standard Error	t Stat	P-value	Lower 95%	Upper 95%	Lower 95.0%	Upper 95.0%
Intercept	0.222267	0.156288	1.422165	0.188696	-0.13128	0.575815	-0.13128	0.575815
No B	-1.5E-07	2.05E-07	-0.74684	0.47422	-6.2E-07	3.11E-07	-6.2E-07	3.11E-07

Grafiku 1. Korrelacioni midis indeksit ISO dhe numrit të bizneseve për vendet e Ballkanit



Mbështetur në të dhënat që rezultojnë nga kryerja e analizës regressive dhe nga ndërtimi i tabelës së korrelacionit del se meqënëse  $R^2$  është 0.058, nuk ka ndonjë lidhje midis Indeksit ISO dhe numrit të bizneseve në vendet e Ballkanit, që tregon se këto vende kanë një rrugë të

gjatë për të bërë në lidhje me standardet dhe çertifikimin, aq më tepër vendet që janë në rrugën e integritit në BE.

#### **4. Implikimet për teorinë dhe praktikën**

Në lidhje me teorinë, bazuar në rezultatet përfundimtare të këtij hulumtimi, është hapur një dritare e re për kërkime të mëtejshme në fushën e indekseve të standardeve ISO, duke i konsideruar ato si një mënyrë për të krahasuar vendet, ekonomitë dhe rajonet bazuar në qasjet e menaxhimit të cilësisë.

Artikulli kontribuon jo vetëm në çështjen e përgatitjes së indekseve të certifikatave ISO, por edhe në mënyrën se si të krahasohen vendet, ekonomitë dhe rajonet në lidhje me këtë aspekt. Artikulli shqyrton qasjet që promovojnë përgatitjen dhe përdorimin e indekseve të certifikatave ISO.

Ky nuk është vetëm një artikull teorik, i bazuar në një studim empirik, duke përdorur metoda sasiore, por një punim i orientuar drejt praktikës, që shpreh ndryshimet aktuale në ekonominë, shoqërinë dhe shkencën globale për çështjen e standardizimeve me standardet ISO dhe hap një debat. për perspektivën afatgjatë të emetimit të indekseve të standardeve ISO.

#### **5. Kufizimet dhe kërkimet e mëtejshme**

Ky hulumtim është ndërmarrë duke përdorur të dhëna të besueshme nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve për të gjitha çertifikatat ISO të lëshuara, dhe aktive deri në vitin 2021 dhe duke përdorur të dhëna për numrin e bizneseve për shtet nga HitHorizon për vitin 2021.

Hulumtime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar një indeks vjetor ISO. Kërkime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar indekse vjetore për të gjitha standardet kryesore ISO si ISO 9001, ISO 14001, ISO 20000, ISO 22000, ISO 27000, ISO 45000, dhe ISO 50000, etj, dhe kjo është dera që ky kërkim hap për kontribues të tjerë në këtë lëmi.

#### **6. Konkluzione dhe rekomandime**

1. ka një interer në rritje në lidhje me cilësinë, kulturën e cilësisë, standardet ISO, procesin e standardizimit dhe çertifikimit të subjekteve publike dhe private në mbarë botën dhe në vendet e Ballkanit gjithashtu.

2. Kultura e cilësisë tashmë shërben si një udhërrëfyes i mirë dhe i gjithëpranuar për përmirësimin e vazhdueshëm, një process që u përket të gjithë anëtarëve të organizatës(ve), duke formuar gjithashtu një lidhje midis organizatës, klientëve dhe furnitorëve të brendshëm e të jashtëm.

3. Vlera thelbësore e kulturës së cilësisë është e mishëruar në standardet ISO, për të cilat ka një interes në rritje në mbarë botën, duke synuar arritjen e avantazhit ekonomike. Cilësia, kultura e cilësisë, menaxhimi i kulturës së cilësisë dhe standardet ISO, po bëhen pjesë thelbësore e modeleve të biznesit për arritjen e avantazheve konkurruese, nën realitetin e ri dhe normalitetin e ri.

4. Aktualisht, literatura mbi listimin dhe indekset e standardeve ISO nuk është zhvilluar dhe ekziston vetëm një raport mbarëbotëror i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve, ISO, i quajtur: Anketa ISO e çertifikatave standarde të sistemit të menaxhimit (ISO. 2021), raport që paraqet numrin total të çertifikatave të vlefshme dhe numrin e përgjithshëm të siteve për sejcilin standard të mbuluar nga sondazhi dhe për sejcilin prej

standardeve jepet numri i çertifikatave dhe numri i siteve, duke deklaruar se Sondazhi ISO nuk është një bazë të dhënash, duke pranuar se nuk ka listë të vendeve të bazuara në një logjikë, parametër ose indeks, përveç listimit mbi bazë renditjen alfabetike dhe sipas numrit të çertifikatave ISO të lëshuara.

5. Indeksi ISO, i zhvilluar me këtë punim, është një tregues më i përshtatshëm për renditjen e vendeve në lidhje me numrin e çertifikatave ISO të lëshuara dhe kjo u shërben të gjithë të interesuarve në fushën akademike, në administratën publike dhe në raportet dhe studimet e në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të organizatave, për të krijuar një perceptim më të mirë të të bërit biznes në përgjithësi dhe mbi aspektet e menaxhimit të cilësisë në veçanti, veçanërisht kur bëhet fjalë për të bërë krahasimet më të përshtatshme midis vendeve për këto çështje.

6. Indeksi i çertifikatave ISO paraqet motivimin që ka komuniteti i biznesit për t'u çertifikuar me standardet ISO dhe kulturën e cilësisë që ekziston në këto vende.

7. Kërkime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar një indeks vjetor ISO.

8. Kërkime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar indekse vjetore për të gjitha standardet kryesore ISO si ISO 9001, ISO 14001, ISO 20000, ISO 22000, ISO 27000, ISO 45000, dhe ISO 50000, etj.

9. Vendet e Ballkanit kanë ende shumë punë për të bërë përpara në lidhje me standardet, cilësinë dhe çertifikimin me standardet ISO, sidomos vendet që aspirojnë integrimin në BE.

#### **Bibliografia:**

1. Advisera. 2019. What to expect at the ISO certification audit: What the auditor can and cannot do. [advisera.com/articles/which-iso-standards-are-the-most-popular-analysis-of-iso-2019-survey/#:~:text=The%20most%20popular%20certificates%20are,\(medical%20device%20quality%20management.Vizituar mw 7 gusht 2023](https://advisera.com/articles/which-iso-standards-are-the-most-popular-analysis-of-iso-2019-survey/#:~:text=The%20most%20popular%20certificates%20are,(medical%20device%20quality%20management.Vizituar%20mw%207%20gusht%202023)
2. ANSI. 2014. ISO 10244:2010 - Business process baselining and analysis. <https://webstore.ansi.org/standards/iso/iso102442010>. Vizituar mw 7 gusht 2023
3. Benjamin Musa. 2014. Benefits of standards. <https://www.scribd.com/document/313699450/Benefits-of-Standards>. www.scribd.com › document › 313699450Benefits of Standards | Quality Management | Value Chain. Vizituar mw 7 gusht 2023.
4. BEST PRACTICE. 1<sup>ST</sup> DECEMBER 2022. What ISO Certification Is Most Important In 2022. <https://bestpractice.biz/what-iso-certification-is-most-important-in-2022/>. Vizituar mw 7 gusht 2023
5. Ceko Enriko. 2021. On relations between creativity and quality management culture. Vol 14. No 1. 2021 Creativity studies. <https://journals.vilniustech.lt/index.php/CS/article/view/12154>. Vizituar mw 7 gusht 2023
6. Harrington, H. J.; Mathers, D. D. (1997). ISO 9000 and Beyond: From Compliance to Performance Improvement. New York: McGraw-Hill.
7. HitHorizon. 2022. <https://www.hithorizons.com/eu/analyses/country-statistics/>.
8. ISO. 1997. Miqësia midis të barabartëve: Kujtimet nga pesëdhjetë vitet e para të ISO. Organizata Ndërkombëtare për Standardizim. 1997. fq. 15–18. ISBN 92-67-10260-5.
9. ISO. 16 maj 2008. "Direktivat ISO/IEC dhe shtesat"
10. ISO Central Secretariat. 2014. Economic benefits of standards. ISBN 978-92-67-10620-5
11. ISO. 2015. Manuali i anëtarësimit në ISO. ISBN 978-92-67-10611-3)
12. ISO. 2022. The ISO survey of management system standard certifications.
13. ISO, 2023. Anëtarët e ISO. <https://www.iso.org/members.html><https://www.iso.org/anetarët.html>. Vizituar mw 7 gusht 2023
14. Jessica F. Green & Thomas Hale, 4 tetor 2021. Standardet e reja 'zero neto' mund të transformojnë klima - nëse nuk dalin nga shinat. Pak njerëz shikojnë organet ndërkombëtare që vendosin standarde, por 'Deklarata e Londrës' e ISO mund të jetë një punë e madhe. Washington Post
15. Liza Horielikova. 2019. Which ISO standards are the most popular – Analysis of ISO 2019 survey
16. Vlăsceanu, L.; Grünberg, L.; Pârlea, D. (2007). Quality Assurance and Accreditation: A Glossary of Basic Terms and Definitions. Seto, M.; Wells, P. J. (Eds.). Bucharest: UNESCO-CEPES.

# TENDENCAT E FUNDIT NË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE (IHD)”. RAST STUDIMI: BALLKANI PERENDIMOR

Armira LAZAJ<sup>1</sup>, Valma PRIFTI<sup>2</sup>, Dea SINOIMERI<sup>3</sup>

## Abstract

Foreign direct investments help countries to secure financing for their economic growth. In developing countries, FDI have played a very important role in capital formation, knowledge transfer, promotion of new technologies, capacity building, and unemployment reuction.

In our paper, we will deal with FDI in the Western Balkan region for the period 2000-2022. For this period FDI inflows, global and by a group of economies, plummeted in developed and transition economies. For the realization of this paper, we will rely on theoretical approaches by coordinating two main tools for study: theoretical models of FDI in economic growth, such as: Borenstein, De Gregorio & Lee model, analysis with secondary data obtained from sources such as; Worldbank, UNCTAD EUROSTAT

**Keywords:** Foreign direct investment (FDI), Economic growth, Western Balkans

## I . Hyrje

Në vendet në zhvillim, IHD-të kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në formimin e kapitalit, transferimin e njohurive, promovimin e teknologjive të reja, ndërtimin e kapaciteteve dhe uljen e papunësisë. Termi IHD përdoret për të përshkruar një kategori investimesh ndërkufitare në të cilën një investitor rezident në një ekonomi krijon një interes të qëndrueshëm dhe një shkallë të konsiderueshme ndikimi mbi një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër, (OECD) .

Investimi i huaj direkt mund të përkufizohet si një investim afatgjatë i bërë nga një firmë ose një individ në një vend, në interesa biznesi të vendosura në një vend tjetër, me të gjitha rreziqet dhe mundësitë e fitimit ( Emre Koluman , 2020 )

Ky punim mbështetet në një literaturë të bollshme për të mbështetur përfundimet e tij. Në fushën e gjerë të trajtimit të IHD-ve gjejmë si mbështetës ashtu edhe kundërshtarë të ndikimit që këto investime sjellin në ekonominë e vendeve pritëse.

Për të thithur sa më shumë IHD Ballkani Perëndimor ka përmirësuar kuadrin ligjor, ka siguruar stabilitet ekonomik, ka përmirësuar infrastrukturën, ka përmirësuar klimën e të bërit biznes, ka siguruar stabilitet politik, ka siguruar akses në tregje, ka ndikuar në politikën tatimore, etj.

## II. Rishikimi i literaturës

Në ditët e sotme, kapitali i brendshëm nuk mjafton për të patur një zhvillim të shpejtë ekonomik dhe konkurrencë në tregun e huaj. Historia na ka treguar se vendet kanë

---

<sup>1</sup> Phd Candidate at Aristotle University Thessaloniki, School of Economics; Greecealazaj@fim.edu.al; Department of Production and Management; Faculty of Mechanical Engineering; Polytechnic University of Tirana; Tirana Albania \*

<sup>2</sup> Department of Production and Management; Faculty of Mechanical Engineering; Polytechnic University of Tirana; Tirana Albania vprifti@fim.edu.al

<sup>3</sup> Department of Production and Management; Faculty of Mechanical Engineering; Polytechnic University of Tirana; Tirana Albania dsinoimeri@fim.edu.al

nevojë për financim të huaj për të siguruar rritje të qëndrueshme afatgjatë dhe ekonomike. Vendet kanë nevojë për IHD si një mjet për financimin e ndërtimit të infrastrukturës së re dhe krijimin e vendeve të punës. Nga ana tjetër, kompanitë shumëkombëshe përfitojnë nga IHD-të duke zgjeruar gjurmët e tyre në tregjet ndërkombëtare. Disa studiues i shohin IHD-të si zgjidhje të problemeve të ndryshme globale nga ana tjetër, disa studiues të tjerë mendojnë se IHD-të janë vetë instrumenti përmes të cilit shkaktohen këto fatkeqësi globale. Në këtë kontekst, Investimet e Huaja Direkte mund të jenë një alternativë shumë e rëndësishme për një rritje ekonomike më të shpejtë dhe më konkurruese. Në këtë kuptim, ekonomitë në zhvillim të vendeve të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut kanë shumë për të përfituar nga investimet e huaja direkte. IHD-të shpesh janë të ndjeshme ndaj goditjeve ekonomike dhe llojeve të tjera të ndryshme. Studimet e kaluara kanë vënë në dukje efektet negative të krizave financiare (Dornean, Işan dhe Oanea 2012; Dornean dhe Oanea 2015; Poulsen dhe Hufbauer 2011; Stoddard dhe Noy 2015).

Në punimin tim do të merrem me IHD në rajonin e Ballkanit për periudhën 2000-2022. Ballkani Perëndimor i ka kushtuar shumë vëmendje investimeve të huaja direkte, sepse këto vende presin prej tyre një rritje të nivelit të punësimit, transferimin e teknologjive të reja, rritjen e kapitalit, nxitjen e konkurrencës në vendet e tyre dhe në fund rritje ekonomike. Në ditët e sotme, kapitali i brendshëm nuk mjafton për të patur një zhvillim të shpejtë ekonomik dhe konkurrencë në tregun e huaj. Termi Investime të Huaja Direkte (IHD) përdoret për të përshkruar një kategori investimesh ndërkufitare në të cilën një investitor rezident në një ekonomi krijon një interes të qëndrueshëm dhe një shkallë të konsiderueshme ndikimi mbi një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër, (OECD).

Termet "investitor direkt" dhe "ndërmarrje investimi direkt" përkufizohen nga FMN dhe OECD si më poshtë: Investitori i drejtpërdrejtë mund të jetë një individ, një person juridik ose fizik, një ndërmarrje publike, një qeveri, një grup individësh, ose persona juridikë dhe/ose individë, të cilët zotërojnë një sipërmarrje investimi direkt me veprimtari në një vend jashtë vendit të banimit të investitorit të drejtpërdrejtë. Një ndërmarrje investimi direkt është një person juridik ose fizik në të cilin një investitor i huaj zotëron 10% ose më shumë të aksioneve ose fuqisë votuese të një shoqërie tregtare ose ekuivalenti i një partneri (FDI) është një aksion pronësor në një kompani të huaj ose projekt të bërë nga një investitor, kompani ose qeveri e huaj Saul Estrin dhe Milica Uvaliq eksploron ndikimin e investimeve të drejtpërdrejta të huaja në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor gjatë kalimit të tyre në një sistem tregu. Ata kanë argumentuar mbi bazën e treguesve të shumtë se veçoritë institucionale, ekonomike dhe politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor ndoshta kanë kufizuar përhapjet e mundshme nga IHD-të. Për më tepër, efektet e përhapjes mund të kenë qenë të kufizuara sepse ky rajon ka tërhequr sasi relativisht të vogla të IHD-ve dhe për shkak se relativisht pak IHD kanë shkuar në prodhim si sektori kryesor përgjegjës për eksportet e këtyre vendeve. Bilal Sucubasi, Borce Trenovski, Berkan Imeri dhe Gunter Merdzan (2021) në punimin e tyre ata konfirmuan se investimet e huaja direkte nga brenda në Ballkanin

Perëndimor, si dhe rritja reale ekonomike ndikojnë ndjeshëm dhe pozitivisht në investimet e brendshme.

### III. Metodologjia

Në këtë studim marrim në konsideratë të dhënat e panelit nga disa vende si: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut, për një periudhë 12 vjeçare nga 2000-2022. Në qendër të trajtimit teorik janë modelet e rritjes ekonomike në fushën e shkencave ekonomike, madje edhe në atë teorik. Nga analiza empirike në këtë punim presim që opinionet apo konkluzionet e përgjithshme rreth IHD-ve të jenë në përputhje me teorinë ekonomike. Për realizimin e këtij punimi do të mbështetemi në qasjet teorike duke bashkërenduar dy mjete kryesore për studim: modelet teorike të IHD-ve në rritjen ekonomike, dhe analizën ekonometrike me të dhëna dytësore të marra nga burime si: Banka Botërore, UNCTAD; EUROSTAT.

**Pyetje kërkimore** - Për trajtimin e situatës reale të IHD-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor shtrohen pyetjet e mëposhtme:

- Cili është ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor?
- Cilët faktorë ndikojnë në flukset e IHD-ve?
- Cilët janë investitorët kryesorë në këto vende?
- Cili është efekti i interesit real në investimet e huaja direkte?
- Cili është efekti i PBB-së në investimet e huaja direkte?
- Si janë të strukturuar investimet e huaja direkte në vendet e Ballkanit?

**Objektivat e studimit.** - **Objektivi** i parë i këtij studimi janë zhvillimet teorike të modeleve që shpjegojnë IHD-të dhe ndikimin e tyre në ekonomi. Gjithashtu, ky studim do të rishikojë punimet empirike të modeleve të aplikuara për të identifikuar boshllëqet e kërkimit. ; **Objektivi** i dytë i këtij studimi është të paraqesë një përshkrim gjithëpërfshirës të IHD-ve për Ballkanin Perëndimor.; **Objektivi** i tretë i këtij studimi është të hetojë marrëdhënien ndërmjet IHD-ve dhe rolit që mund të luajë në nxitjen e rritjes ekonomike.

**Të dhënat** - : Punimi fillon me një trajtim teorik të IHD-ve për të vazhduar me një analizë empirike të efektit të IHD-ve në rritjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor.. Të dhënat e përdorura në studim vijnë nga burime dytësore. Në testimin e modeleve janë mbledhur të dhëna nga Banka Botërore, EUROSTAT, The H.Foundation, Fondi Monetar Ndërkombëtar, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. Në vlerësimin e investimeve të huaja direkte, të dhënat e përdorura janë marrë nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare për vlerësimin e ecurisë së IHD-ve.

### IV. Analizat dhe gjetjet

Të thithin aq IHD sa kanë këto vende; përmirësimin e kuadrit ligjor të tyre, sigurimin e stabilitetit ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e klimës së të bërit biznes, sigurimin e stabilitetit politik, sigurimin e aksesit në tregje, ndikuar në politikën tatimore, etj. Tranzicioni i gjatë ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor rezultoi në disa ngjarje politike: Shpërbërja e Jugosllavisë; Konfliktet në Slloveni në

vitin 1991; Konfliktet në Kroaci në 1991-1995; Konfliktet në Bosnjë dhe Hercegovinë në 1992-1995; Firmat piramidale në Shqipëri në 1997 ; Konfliktet në Kosovë në vitet 1998-1999; Konfliktet në Maqedoni në vitin 2001

Duke njohur avantazhet e mundshme ekonomike të IHD-ve, qeveritë e Ballkanit Perëndimor pas viteve 2000 ndërmorën një sërë masash politikash, duke përfshirë fushën e biznesit, reformat fiskale dhe legjislative, për të vendosur të drejtat e investitorëve që nxisin flukse më të mëdha kapitali.

Pas vitit 2001, vendet e Ballkanit Perëndimor filluan të zbatojnë politika makroekonomike stabilizuese duke ndërmarrë reforma në shumë sektorë të ekonomive të tyre. Në këtë kohë filloi privatizimi i pronave shtetërore dhe bankave për të përmirësuar klimën ekonomike dhe vendet për të pasur më shumë tregti të jashtme dhe përthithjen e investimeve të huaja direkte. Deri në vitin 2008, para krizës globale, këto vende performuan mirë në aspektin ekonomik, por gjatë krizës ekonomike, vendet e Ballkanit Perëndimor kishin probleme të dukshme strukturore dhe ekonomike (Bartlett dhe Prica, 2012). Vite më vonë, këto vende kthehen në vende të konsumit (konsumi tejkalon prodhimin), kanë rritje të deficitit të llogarisë korente, papunësi të lartë, politika të papërshtatshme zhvillimi dhe kalimin e këtyre ekonomive në një ekonomi shërbimi dhe humbasin konkurrencën me tregun global. Politikat e hapjes pas vitit 2001 nuk ishin aq të suksesshme në këto vende në krahasim me vendet e tjera evropiane. (Uvalic, 2013 )

Pas vitit 2008, vendet u goditën nga kriza duke ndikuar kështu në rritjen ekonomike. Rritja ekonomike afatgjatë tregon se shumica e vendeve të Ballkanit kanë përjetuar stagnim. Duhet të veçohen tre karakteristika specifike që lidhen me privatizimin, deindustrializimin dhe shpërndarjen sektoriale të IHD-ve.

- 1) *Privatizimi në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor u vonua nga rrethanat veçanërisht të pafavorshme politike të viteve 1990, duke kontribuar në IHD shumë të kufizuara në vitet e para të tranzicionit.*
- 2) *Vendet e Ballkanit kanë kaluar një proces të rëndësishëm deindustrializimi. Në fillim ekonomitë e Ballkanit bazoheshin në industri dhe shumë pak në shërbime, por pas viteve 2000 industria në këto vende u shkatërrua dhe këto vende u kthyen në një ekonomi shërbimi. (Damiani 2014 )*
- 3) *Shpërndarja sektoriale e IHD-ve në Ballkanin Perëndimor ka kontribuar ndoshta në rënien relative të prodhimit*

**Tabela 1 >>>. Vlera e shtuar e prodhimit (% e PBB-së)**

<b>vendet e Ballkanit Perëndimor</b>	<b>(% e PBB-së) vit</b>	<b>vendet e Ballkanit Perëndimor</b>	<b>(% e PBB-së) vi</b>
Shqipëria	6	Shqipëria	4
Maqedonia e Veriut	13	Maqedonia e Veriut	9
Mali i Zi	4	Mali i Zi	9

Burimi: Banka Botërore

Deri në vitin 2010, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë tërhequr sasi të konsiderueshme të IHD-ve në prodhim, por kanë tërhequr më shumë në shërbime.



Prandaj edhe investimet e huaja janë të fokusuar në këtë sektor. Por ajo që është shqetësuese është se këto vende po kthehen në vende shërbimi, duke bërë që investimet e huaja direkte të fokusohen në shërbimet e patregtueshme, duke bërë që këto vende të kenë mangësi të mëdha në integrimin përmes rrjeteve të biznesit dhe zinxhirëve globalë të vlerës në ekonominë botërore.

**Tabela 2 >>>. Vlera e shtuar e shërbimit (% e PBB-së)**

vendet e Ballkanit Perëndimor	(% e PBB-së) vit	vendet e Ballkanit Perëndimor	(% e PBB-së) vit
Shqipëria	47.7	Shqipëria	44.3
Maqedonia e Veriut	56.9	Maqedonia e Veriut	52.8
Mali i Zi	59.9	Mali i Zi	58.2

Burimi: Banka Botërore

Sipas Saul Estrin ilica Uvalic (2016) struktura e shërbimeve të eksportuara nga Ballkani Perëndimor në vitin 2012 zbulon se 50-80 për qind e udhëtimeve dhe transportit janë sektorë të lidhur kryesisht me turizmin. Turizmi është padyshim i rëndësishëm për Kroacinë dhe Malin e Zi, por edhe në këto raste duke qenë një sektor shumë i ndjeshëm ndaj sezonit, ai kontribuon në eksporte vetëm gjatë muajve të caktuar në vit. Investimet e huaja direkte në prodhim, duke marrë parasysh përvojën e kompanive investuese, mund të gjenerojnë rritje të lartë ekonomike për vendet e BB Firmat në prodhim janë më të motivuara për të inovuar, duke ndikuar kështu në rritjen e produktivitetit.

**IHD-të në Shqipëri** - Investimet e huaja direkte në Shqipëri kanë qenë një shtytës i rëndësishëm i rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Që nga fillimi i viteve 1990, kur Shqipëria kaloi nga një ekonomi e planifikuar nga qendra në një ekonomi të orientuar drejt tregut, IHD-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në tërheqjen e kapitalit, teknologjisë dhe ekspertizës në vend për tërheqjen e investitorëve të huaj. Këto reforma përfshijnë liberalizimin e tregtisë, thjeshtimin e rregulloreve të biznesit, privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe përmirësimin e infrastrukturës. Qeveria ka marrë gjithashtu hapa për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, për të mbrojtur të drejtat e pronës dhe për të luftuar korrupsionin. Gjatë viteve, flukset hyrëse të IHD-ve në Shqipëri kanë shfaqur luhatje, të ndikuar si nga tendencat ekonomike botërore ashtu edhe nga faktorët e brendshëm.

Këtu janë disa pika kyçe në lidhje me IHD-të në Shqipëri:

Sektorët: IHD-të janë përqendruar kryesisht në sektorë të tillë si energjia, telekomunikacioni, bankat dhe financat, turizmi dhe prodhimi. Projektet energjetike, duke përfshirë hidroenergjinë dhe kërkimin e naftës, kanë tërhequr investime të konsiderueshme të huaja.

Vendet e origjinës: Historikisht, IHD-të në Shqipëri kanë ardhur nga një sërë vendesh, duke përfshirë Italinë, Greqinë, Turqinë, Austrinë, Holandën dhe Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, ka pasur një rritje të dukshme të investimeve nga vende të tjera, si Kina dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, në vitet e fundit.

Integrimi në BE: Aspirata e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE) ka ndikuar gjithashtu në flukset hyrëse të IHD-ve. Procesi i integritit në BE ka inkurajuar reformat dhe ka tërhequr investime nga vendet anëtare të BE-së, si dhe ka rritur aksesin në tregjet e BE-së.

Stimujt për investime: Qeveria shqiptare ka futur stimujt për investime për të tërhequr investitorë të huaj. Këto stimujt përfshijnë lehtësime tatimore, përjashtime dhe subvencione në sektorë dhe rajone të veçanta. Gjithashtu janë krijuar Zonat e Lira Ekonomike për të ofruar një mjedis të favorshëm për kompanitë e huaja. Energjia, turizmi, pronat e paluajtshme, prodhimi dhe shërbimet janë vetëm disa nga industritë e rëndësishme në Shqipëri që kanë tërhequr investime të huaja direkte.

- Vlera e IHD-ve shqiptare në miliardë nga viti 2007 deri në vitin 2021 është si më poshtë: 0.7 në 2007, 1.25 në 2008, 1.35 në 2009, 1.09 në 2010, 1.05 në 2011, 0.9 në 20251,201, 0.9 në 2012, 2012, 1.25, 2012. 2015 , në 2016, 1.02 në 2017, 1.2 në 2018, 1.2 në 2019, 1.07 në 2020 dhe 1.22 në

Shqipëria ka shumë potencial për hidrocentrale dhe burime të rinovueshme të energjisë. Qeveria ka inkurajuar investimet në sektorin e energjisë për të rritur kapacitetin dhe për të reduktuar varësinë nga energjia e importuar. Bukuritë natyrore të Shqipërisë, zonat bregdetare dhe historia kulturore tërheqin turistët. Kjo ka bërë që të bëhen më shumë investime në hotele, resorte dhe në zhvillimin e infrastrukturës për t'i shërbyer industrisë së turizmit në rritje. Industria e pasurive të paluajtshme në Shqipëri ka parë një rritje të investimeve të huaja, veçanërisht në Tiranë dhe zona të tjera urbane dhe bregdetare. Investitorët janë të interesuar për zhvillimet komerciale dhe rezidenciale si qendrat tregtare, ndërtesat e zyrave dhe komplekset e apartamenteve. Për bizneset që kërkojnë të ngrenë zyra rajonale apo ambiente prodhimi, Shqipëria ofron një pozicion strategjik. Në sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve, IHD-të janë tërhequr për shkak të disponueshmërisë së një fuqie punëtore kompetente dhe kostove relativisht të lira të punës. Pavarësisht progresit, Shqipëria përballlet me sfida në tërheqjen dhe mbajtjen e IHD-ve. Këto sfida përfshijnë nevojën për përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë, mjedisin e biznesit, sundimin e ligjit dhe edukimin dhe zhvillimin e aftësive. Stabiliteti politik dhe një kornizë e qëndrueshme e politikave janë gjithashtu vendimtare për ruajtjen e flukseve hyrëse të IHD

**IHD-të në Kosovë** - Ekonomia e Kosovës është formësuar në mënyrë të konsiderueshme nga investimet e huaja direkte (IHD), të cilat gjithashtu kanë nxitur zgjerimin ekonomik. Gjatë dhjetë viteve të mëparshme (2012-2022), PBB-ja e Kosovës është rritur pozitivisht me një normë mesatare vjetore të rritjes prej rreth 4%. Për të joshur investimet dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik, Kosova ka miratuar një sërë reformash të orientuara drejt tregut dhe skemave të privatizimit. Sektori i shërbimeve, i cili përfshin tregtinë, transportin dhe turizmin, është ajo që fuqizon më së shumti ekonominë e Kosovës. Kosova ka bërë shpenzime të mëdha në zhvillimin e telekomunikacionit, infrastrukturës së transportit dhe energjisë

Figura 1. Shembull ndërvëprimi me chatbot-in e krijuar. Burimi:Autorët

#### IV. KONKLUZIONE

Përmes përdorimit të teknologjive të AI, chatbot-ët janë në gjendje të ofrojnë këshillim dhe asistencë në kohë reale, të automatizojnë proceset e detyrave të thjeshta dhe të sigurojnë një shërbim me shpejtësi dhe saktësi të lartë. Implementimi i chatbot-ëve ka efekte të rëndësishme për produktivitetin, efikasitetin dhe përvojën e përdoruesit, duke i lejuar organizatat të optimizojnë proceset e tyre dhe të ofrojnë një shërbim më të mirë nëpërmjet kanaleve digjitale. Megjithatë implementimi i chatbot-ëve sjell avantazhe dhe mundësi është e rëndësishme të kuptohet se ato nuk janë një e zgjidhje e përsosur për të gjitha situatat. Në rastet kur kërkohet perceptimi i ndjeshmërisë dhe kuptimi i thellë i situatave komplekse, ende lind nevoja për ndërveprimin e drejtpërdrejtë me një person real.

Chatbot-i ynë i krijuar për efekte didaktike dhe studimi përmban disa tokena dhe etiketa në gjuhën shqipe, por ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të përdoret gjerësisht sipas kushteve të performancës dhe sigurisë të spjeguar në këtë punim.

Chatbot-ët kanë sjellë një revolucion në mënyrën se si ne komunikojmë dhe operojmë në botën digjitale. Në të ardhmen, pritet një rritje në numër dhe shumëllojshmëri në përdorimin e chatbot-ëve, duke sjellë përfitime zgjidhje të tjera inovative.

#### V. REFERENCA

- [1]. Sumit Raj, 2019, 'Building Chatbots with Python Using Natural Language Processing and Machine Learning', Appress, ISBN-13 (electronic): 978-1-4842-4096-0, <https://doi.org/10.1007/978-1-4842-4096-0>
- [2].Emma Strubell, Ananya Ganesh, Andrew McCallum, Energy and Policy Considerations for Deep Learning in NLP, Qershor 2019.
- [3].A M Rahman, Abdullah Al Mamun, Alma Islam, Programming challenges of chatbot: Current and future prospective, 2017.
- [4].Tarun Lalwani, Shashank Bhalotia, Ashish Pal, Vasundhara Rathod, Shreya Bisen, Implementation of a Chatbot System using AI and NLP, Maj 2018.
- [5].Hasal M, Nowaková J, Ahmed Saghair K, Abdulla H, Snášel V, Ogiela L. Chatbots: Security, privacy, data protection, and social aspects. *Concurrency Computat Pract Exper*. 2021.
- [6].Elupula. V, "How do chatbots work? An overview of the architecture of chatbots" Gusht 2018.
- [7].Bray, Tim. The javascript object notation (json) data interchange format, 2017.
- [8].Sofian Hamad, Taoufik Yeferny, A Chatbot for Information Security, 2020.
- [9].Winson Ye, Qun Li, Chatbot Security and Privacy in the Age of Personal Assistants, 2020.
- [10].Chetan Bulla, Chinmay Parushetti, Akshata Teli, Samiksha Aski, Sachin Koppad, 2020, A Review of AI Based Medical Assistant Chatbot, <http://dx.doi.org/10.5281/zenodo.3902215>
- [11].Nuria Haristiani, Artificial Intelligence (AI) Chatbot as Language Learning Medium: An inquiry, Mars 2019.
- [13].Chaoguo, C., Rui, L. Chatbot is the new entrance without only apps , 2016.
- [14].Eleni Adamopoulou, Lefteris Moussiades, Chatbots: History, technology, and applications, *Machine Learning with Applications*, Volume 2, 2020, 100006, ISSN 2666-8270, <https://doi.org/10.1016/j.mlwa.2020.100006>.
- [15].Christopher D. Manning; Human Language Understanding & Reasoning. *Daedalus* 2022; 151 (2): 127–138. doi: [https://doi.org/10.1162/daed\\_a\\_01905](https://doi.org/10.1162/daed_a_01905)
- [16]. FAN JiaHao, Li Yuan, SONG Huancheng, TANG Huimin, YANG Rongfeng, NLP Final Project: A Dialogue System, 2020.
- [17].Ye, Lu, Jiaqiang Gao, Volker Tresp, and Hongyuan Zhang. "Chatbots and Artificial Intelligence - Artificial Intelligence Synthesis." In *Web-based*, Stanford, 2019.
- [19].Dušek, Ondřej, Verena Rieser, and Oliver Lemon. "Automated Writing of Dialogue in Artificial Intelligence: A Systematic Review." *AI & Society* 34, no. 1 (2019): 1-26.
- [20].Serban, Iulian Vlad, Alessandro Sordani, Yoshua Bengio, Aaron Courville, and Joelle Pineau. "Building End-To-End Dialogue Systems Using Generative Hierarchical Neural Network Models." *Journal of Artificial Intelligence Research* 55 (2016): 1-98.
- [22][1].Sumit Raj, 2019, 'Building Chatbots with Python Using Natural Language Processing and Machine Learning', Appress, ISBN-13 (electronic): 978-1-4842-4096-0, <https://doi.org/10.1007/978-1-4842-4096-0>
- [23].Khurana, D., Koli, A., Khatter, K. et al. Natural language processing: state of the art, current trends and challenges. *Multimed Tools Appl* 82, 3713–3744 (2023). <https://doi.org/10.1007/s11042-022-13428-4>
- [24].Umamaheswari S., Valarmathi A., M. Raja lakshmi, 2023, Role Of Artificial Intelligence in The Banking Sector, <https://doi.org/10.17762/sfs.v10i4S.1722>
- [26].Olena Trofymenko, Yuliia Prokop, Natalia Loginova and Alexander Zadereyko, 2021, Taxonomy of Chatbots, ISIT 2021: II International Scientific and Practical Conference «Intellectual Systems and Information Technologies», September 13–19, 2021, Odesa, Ukraine.



# VËSHTRIM HISTORIK I DORËZANISË SI MJET PËR TË SIGURUAR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE

Klei KAÇUPI

Jurist

## Abstract

The basic purpose of this paper is to create a clear overview of the institution of surrender as a main tool for the execution of obligations in the Albanian parastatal formations.

In order to enrich the Albanian legal opinion, the document represents an attempt to shed light on the genesis of this institute of law in our country.

The author has taken care to pay due attention and answer the questions: Was the handover a widely known institution of our unwritten law? What was meant by bail according to traditional Albanian norms? What was their purpose on bail?

I hope that the topic chosen to be covered will serve as a starting point and a proper scientific debate in this field of law and will deserve the proper attention from the professionals of the justice system.

**Keywords:** surrender, obligation, habit

## 1. Dorëzania në kuptim të së drejtës zakonore shqiptare

Në të drejtën tonë zakonore, dorëzania ishte një ndër mjetet juridike të njohura për të siguruar përmbushjen e detyrimeve. Me dorëzani duhej kuptuar fjala e dhënë<sup>1</sup> apo zotimi nga ana e një personi mes dy a më shumë palëve për të kryer ose jo një punë apo detyrim të caktuar kryesisht në fushën e marrëdhënieve juridike –civile por jo vetëm.

Kanuni i Krahinës së Lumës paraqet veçanti në dallim nga të gjithë kanunet e tjera shqiptare lidhur me dorëzani. Ai potretizon dorëzani në shtatë lloje kryesore. Dhe, për më tepër, ekpozon një tablo më të plotë të asaj se çfarë duhet të kuptojmë me dorëzani. Krahas kuptimit klasik të dorëzani, normat kanunore të Krahinës së Lumës e dallonin dorëzani si një marrëveshje mes palëve në konflikt për të gjetur një garantues për të forcuar dhe mbrojtur marrëdhëniet juridike familjare të cenuara.

Në këtë kuptim, dorëzania shtjellohet edhe si marrëveshja për të përzgjedhur përfaqësuesin e duhur që do të siguronte mbrojtjen e rregullave shoqërore të vendosura në fushën e sigurisë publike. Sipas normave kanunore të Krahinës së Lumës, në raste të caktuara, dorëzania mund të dublonte edhe pengun si një tjetër mjet për të garantuar ekzekutimin e detyrimit.

Dorëzania sipas normave të Kanunit të Skënderbeut nënkuptonte marrjen përsipër të realizimit të detyrimit të një personi tjetër, kur ky i fundit nuk ishte në gjendje që t'a plotësonte.<sup>2</sup>

Në dallim nga Kanuni i Skënderbeut, dorëzania sipas normave kanunore të Krahinës së Labërisë nënkuptonte edhe ekzekutimin e detyrimit për një pjesë të caktuar të tij. Pra, sipas këtyre normave dorëzania ishte një veprim juridik që shërbente jo vetëm për

---

<sup>1</sup> Fjala e dhënë zinte një vend të rëndësishëm në hapsirën shoqërore të formacioneve parashitetore shqiptare që rregulloheshin nga kanunet si traktate paraprake juridike të ngritura mbi disa parime etike dhe morale. Për më shumë shih: Valentini, Z., *Studime dhe tekste juridike*, shtëpia botuese “Plejad”, botim i parë, Tiranë, 2009, f. 285-330.

<sup>2</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

ekzekutimin e plotë të detyrimit por edhe për ekzekutimin e pjesëshëm të tij.<sup>3</sup> Dorëzanësi i përgjigjej kreditorit në përpjestim me pjesën e detyruar që kishte marrë përsipër të plotësuar apo kryer.<sup>4</sup> Ndaj, ndër të tjera, në Kanunin e Labërisë ishte sanksionuar: “*Dorëzanësi merr përsipër që t’i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë – borxhliut plotësisht ose pjesërisht, ose për punë që do të bëhen, ose nuk do të bëhen*”.<sup>5</sup> Pra, dorëzania ishte një sipërmarrje<sup>6</sup> vullnetare.<sup>7</sup> Sipas profesorit të shquar shqiptar z. Elezi, dorëzania mbetej instituti juridik i përhapur për ekzekutimin e detyrimeve në trevat ku shtrinin ndikimin e tyre normat e Kanunit të Labërisë.<sup>8</sup>

Dorëzania ishte një veprim juridik pa kundërshpërblim.<sup>9</sup> Më së shumti të herës, ajo kryhej për nder<sup>10</sup>. Kanuni i Lekë Dukagjinit shprehej qartë: “*Dorzanë e bestar nuk hin kush me të holla*”.<sup>11</sup> Sipas Kanunit të Skënderbeut shpërblimi ishte i lejuar vetëm për dorëzanësit e gjakut.<sup>12</sup> Gjithashtu, normat kanunore të vendit tonë e konsideronin dorëzaninë si një garanci morale dhe investim pasuror më shumë për kreditorin.<sup>13</sup> E parë në këtë drejtim, normat dibrane sanksiononin : “*Sa më i pasun të jetë qefili, aq ma i besueshëm asht, mbasi ai ve si garanci jo vetëm nderin e dinjitetin e vetë, por ene paret që ka*”.<sup>14</sup>

Kanuni i Lekë Dukagjinit e dallonte ndër normat e tjera kanunore dorëzaninë si një akt ligjor të parevokueshëm.<sup>15</sup> Personi që ishte caktuar me vullnetin e tij të lirë si dorëzanës nuk mund të dorëhiqej nga përmbushja e detyrimit.<sup>16</sup> Në kanun theksohej që: “*Dorzani nuk hin për me u mbajtë në mend, por për me la*”.<sup>17</sup>

Aftësia pagueuse ishte parakushti kryesor për të qenë dorëzanës.<sup>18</sup> Në Kanunin e Krahinës së Bendës thuhej shprehimisht: “*Pyet njiher xhepin, mandej hyj dorzanë*”.<sup>19</sup>

<sup>3</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.

<sup>4</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.

<sup>5</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.

<sup>6</sup> Valentini, Z., *Studime dhe tekste juridike*, shtëpia botuese “Plejad”, botim i parë, Tiranë, 2009, f. 286-330.

<sup>7</sup> Goci, Haxhi, *Kanuni i Krahinës së Bendës*, shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë, 2010, f. 104.

<sup>8</sup> Elezi, I., *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 132-133.

<sup>9</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>10</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>11</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>12</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>13</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509-510.

<sup>14</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509-510.

<sup>15</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>16</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>17</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>18</sup> Goci, Haxhi, *Kanuni i Krahinës së Bendës*, shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë, 2010, f. 104.

<sup>19</sup> Goci, Haxhi, *Kanuni i Krahinës së Bendës*, shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë, 2010, f. 104.

Dorëzania që të ishte e vlefshme kërkonte, së pari, që dorëzanësi të ishte i besueshëm<sup>20</sup>. Në këtë aspekt në Kanunin e Krahinës së Dibrës thuhej: “*Të drejtën me hy qefil<sup>21</sup> e ka kushdo, por pranohen vetëm ata burra që janë të njoftun për besë e burrni*”. Së dyti, normat juridike specifikonin si element të vlefshmërisë së dorëzarisë faktin që, dorëzanësi duhej të ishte i pranueshëm nga të gjitha palët e përfshira në një marrëdhënie detyrimi.<sup>22</sup> Në të kundërt, dorëzania nuk kishte asnjë vlerë dhe efekt ligjorë.<sup>23</sup> Në dallim nga normat e sotme, e drejta për të propozuar dorëzanësin në çdo rast i përkiste debitorit.

Instituti i dorëzarisë gjente një rregullim më të plotë nga normat juridike të Skënderbeut sesa ato të Krahinës së Labërisë. Sipas këtyre të fundit, në cilësinë e dorëzanësit nuk mund të ishin vetëm gratë e fëmijët.<sup>24</sup> Ndërsa sipas Kanunit të Skënderbeut në cilësinë e dorëzanësit mund të ishin vetëm meshkujt e rritur dhe që gëzonin shëndet të plotë mendor.<sup>25</sup> Si rregull, dorëzanës mund të ishte vetëm kryfamiljari - *pater familias* apo një person me pëgjegjësi të deleguara prej tij.<sup>26</sup> Madje, si dorëzanës nuk mund të ishin gratë, fëmijët si dhe personat që nuk kishin shëndetin mendor.<sup>27</sup> Pra, sikurse shihet, rrethi i personave që nuk mund të gëzonin statutin e dorëzanësit ishte më i gjerë në Kanunin e Skënderbeut.

Kanuni i Dibrës nuk i kushtonte rëndësi formës sesi instituti i dorëzarisë merrte jetë.<sup>28</sup> Megjithatë, nga leximi i normave juridike të së drejtës sonë dokësore del se dorëzania kryhej vetëm në formë verbale.<sup>29</sup>

Kanuni i Labërisë nuk i kushtonte rëndësi procedurës së ndjekur për bërë dorëzanimë si një zotim të bërë nga një palë e tretë për të siguruar përmbushjen e një detyrimi apo kryejen e një pune. Ndërsa një tjetër qëndrim mbajnë normat e tjera kanunore të vendit tonë. Kështu, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit<sup>30</sup> dhe atij të Skënderbeut, një tjetër kriter për vlefshmërinë e dorëzarisë ishte pikërisht respektimi i solemnitetit të procedurës së caktuar kanunore.<sup>31</sup> Kështu, deklarata publike e bërë nga dorëzanësi për marrjen përsipër të përmbushjes së detyrimit të palëve ishte kriteri i dytë që duhej të respektohej nga normat ligjore për efekt të vlefshmërisë së dorëzarisë.<sup>32</sup> Pikërisht,

<sup>20</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509.

<sup>21</sup> Dorëzania njihej si një ndër mjetet për ekzekutimin e detyrimeve në njësitë territoriale ku shtrinin efektin e tyre normat e Kanunit të Dibrës. Dorëzanësi njihej me emërtimin Qefili. Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509-510.

<sup>22</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>23</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>24</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.

<sup>25</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>26</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>27</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>28</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509-510.

<sup>29</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>30</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>31</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>32</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

lindja e përgjegjësish për përmbushjen e detyrimit nga ana e dorëzanësit do të linte në momentin e respektimit të procedurës kanunore.<sup>33</sup>

Sipas Kanunit të Skënderbeut, dorëzania si mjet i ekzekutimit të detyrimit merre jetë kur dorëzanësi deklaronte me vullnetin e tij të lirë dhe me përgjegjësi të plotë se: “*Jam unë dorëzanë. Në mos pagofte filani deri në filan ditë të paguej unë*”.<sup>34</sup>

Në dallim nga Kanuni i Labërisë, në trevat ku vepronin normat juridike të Lekë Dukagjinit dhe Skënderbeut dorëzanësi luante një rol të gjallë dhe shumë aktiv në marrëdhëniet e detyrimit.<sup>35</sup> Dorëzanësi luante rolin e nxitësit dhe ndihmësit në përmbushjen e detyrimit.<sup>36</sup> Kështu, së pari, ai duhej të nxiste debitorin për të përmbushur detyrimin. Dhe, së dyti, kur debitori nuk realizonte detyrimin edhe pas shtytjeve të tij, dorëzanësi ishte i detyruar të paguante apo shlyente atë sipas parimit të sanksionuar: “*Dorëxani dordhani*”.<sup>37</sup>

Mungesa e paqëllimtë e aftësisë paguese të debitorit shërbente si shkak për garantimin e ekzekutimit të detyrimit nga ana e dorëzanësit. Kanuni i Lekë Dukagjinit në mënyrë simbolike shprehej: “*...dora e thatë s'ka uratë*”.<sup>38</sup>

Dorëzanësi gëzonte të drejtën për të patur një afat kohor të caktuar për përmbushjen e detyrimit.<sup>39</sup> Afati kohor përcaktohej me marrëveshje të palëve.<sup>40</sup> Afati për përmbushjen e detyrimit sipas Kanunit të Skënderbeut ishte i vogël, pa e përcaktuar sesa konkretisht.<sup>41</sup> Kanuni i Dibrës parashikonte të drejtën për të zgjatur afatin e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, por kurrësesi shkurtimin e tij.<sup>42</sup> Ky ishte një element më shumë në aspekt të mbrojtjes së të drejtave të debitorit.

Kanuni i Labërisë, dhe jo vetëm, theksonte përgjegjësinë e lindur të debitorit ndaj dorëzanësit me rastin e realizimit të detyrimit ndaj kreditorëve të tij nga ana e dorëzanësit.<sup>43</sup>

Sipas normave kanunore të Skënderbeut dorëzania zbatohet në prani të kreditorit dhe dy miqve të debitorit.<sup>44</sup> Ajo shoqërohet gjithnjë me një deklaratë publike të bërë në prani të tyre.<sup>45</sup> Sipas Kanunit të Skënderbeut thuhej: “*Jam tue pague për filanin*”.<sup>46</sup>

<sup>33</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>34</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>35</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>36</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>37</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>38</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 70.

<sup>39</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>40</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 510.

<sup>41</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>42</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 510.

<sup>43</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 166.

<sup>44</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>45</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>46</sup> Ilia, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

Të drejta dhe detyrimet që lindin nga dorëzania ishin të transferueshme dhe kalonin te trashëgimtarët kur ndërronte jetë dorëzanësi apo njëra nga palët në marrëdhënien e detyrimit.<sup>47</sup> Ndaj jo pa qëllim, në Kanunin e Lekës ishte sanksionuar se: “*N’dekët detyrsi, rrsnofët dorëzanësi*”.<sup>48</sup> Nga ana tjetër, përmbushja e detyrimit së pari i kërkohej palës debitore dhe më pas dorëzanësit. Pra, sikurse vihet re, dorëzanësi luante rolin e një debitori solidar.<sup>49</sup> Mosmarrëveshjet e lindura midis dorëzanësit dhe kreditorit zgjidheshin në rrugë gjyqësore.<sup>50</sup> Gjithashtu, shoqëria tradicionale shqiptare, sikurse, ndodh rëndomtë edhe sot, ishte e edukuar me idenë e farkëtuar prej vitesh të mendimit se: “*U ep me dorë e duhet me i kërkuë me kambë*”.<sup>51</sup> Shuarja e dorëzani së realizohej me përmbushjen e detyrimit.<sup>52</sup> Sipas normave kanunore të Krahinës së Labërisë por jo vetëm, debitori pasi ekzekutonte të plotë detyrimin e tij ndaj kreditorit kishte detyrimin që të njoftonte dorëzanësin e tij me qëllim që dorëzania të konsiderohej e shuar.<sup>53</sup>

## 2. Dorëzania dhe përmbushja e detyrimit sipas Statuteve të Shkodrës

Në qytetet mesjetare të bregdetit shqiptar si Durrës, Shkodër, Tivar, Ulqin, etj. sikurse edhe në komuna të tjera mesjetare të Europës të qytetëruar legjislativoni i kodifikuar ishte tregues i organizimit të lartë shoqëror.<sup>54</sup> Padyshim, sikurse me të drejtë profesor Xhufi thekson, ai mishërohej në Statutet e qyteteve.<sup>55</sup>

Nga hulumtimi i ynë rezulton se, në Statutet e Shkodrës nuk gjendej një dispozitë e shprehur mbi dorëzaninë. Ajo nuk ishte një institut i mirë rregulluar nga normat statutorë që shërbente për ekzekutimin e detyrimeve civile.

Megjithatë, mosekzekutimi i detyrimeve civile në të holla të parashikuara në marrëveshje noteriale të lidhura mes palëve përbënte shkak të arsyeshëm për ndjekjen e një procedure të caktuar ligjore.<sup>56</sup>

Noteri ishte autoriteti publik që do të duhej t’i jepte jetë kësaj procedure. Ai, në cilësinë e personit përgjegjës që kishte përpiluar aktin e detyrimit, duhej të shprehte pëlqimin

<sup>47</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>48</sup> Gjeçovi, Shtjefën, *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë, 1999, f. 69.

<sup>49</sup> Elezi, I., *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 132.

<sup>50</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>51</sup> Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 510.

<sup>52</sup> Ilija, Frano, *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993, f. 145.

<sup>53</sup> Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.

<sup>54</sup> Xhufi, P., “Statutet dhe kanuni në mesjetëm shqiptare”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, document me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë, p. 29-30.

<sup>55</sup> Xhufi, P., “Statutet dhe kanuni në mesjetëm shqiptare”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, document me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë, p. 29-30.

<sup>56</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 341.

e tij dhe të pranonte vërtetësinë e aktit në fjalë.<sup>57</sup> Betimi mbi ungjill nga ana e noterit kurorëzonte solemnitetin e procedurës stututore për aktin e detyrimit në të holla.<sup>58</sup>

Në të vërtetë, për të mos ndjekur procedurën si më lart, Statutet parashikonin ekzistencën e dy kushteve kumulative: objekt i detyrimit duhej të ishin prona apo kafshë shtëpiake (bagëti) dhe të paturit e një vendimi gjyqësor.<sup>59</sup>

Zotëruesi i një akti, dokumenti apo letre noteriale kishte të drejtën për të kërkuar përmbushjen e detyrimit pavarësisht vendndodhjes së tij.<sup>60</sup>

Statutet parashikonin si element të nevojshëm të vlefshmërisë së aktit noterial për kontraktimin e borxhit nëshkrimin nga dy ose tre dëshmitarë të palëve përkatëse.<sup>61</sup>

Prania e palëve gjatë momentit të përplimit të aktit nga noteri ishte një kusht i domosdoshëm për vërtetësinë e këtij veprimi juridik.<sup>62</sup>

Gjykatësit si përfaqësues të pushtetit gjyqësor ishin personat e normuar nga Statutet të cilët gëzonin tagrin për të kërkuar përmbushjen e detyrimeve (borxheve) që palët kishin ndaj njësisë administrative territoriale – Qytetit të Shkodrës.<sup>63</sup> Megjithë larmishmërinë e madhe të tyre, tatimet dhe shitjet mbeteshin dy format kryesore të realizimit të përmbushjes së detyrimit.<sup>64</sup> Ajo që dallohet qartë, është fakti se pushteti gjyqësor gjatë mesjetës krahas ushtrimit të dhënies së drejtësisë ngarkohej edhe me përgjegjësi të caktuara në kuadër të administrimit publik.<sup>65</sup>

### 3. Përfundime

Studimi i instituteve të veçanta, siç është ai i dorëzarisë, dhe mënyrës se si është zbatuar ndër vite, paraqet rëndësi për të kuptuar edhe më mirë traditën juridike shqiptare. Sot, mjaftohemi në kuptimin që ka një institut i caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ndërkohë që është detyrë e juristëve të mirë, të hulumtojnë të shkuarën, traditën, për të kuptuar origjinën e rendit tonë të brendshëm juridik.

Ndaj, mjafton të kthehemi pas në kohë, falë punës së kodifikuesve të kanuneve shqiptare, për të kuptuar jo vetëm mënyrën e organizimit shoqëror në atë periudhë, por

<sup>57</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 341.

<sup>58</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 341.

<sup>59</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 341.

<sup>60</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 334.

<sup>61</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 339-340.

<sup>62</sup> Nano, I., “Noteri publik: Funkzioni dhe roli i tij në Arbërinë mesjetare sipas Statuteve të Drishtit dhe Shkodrës”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, dokument me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë, p. 45.

<sup>63</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 339.

<sup>64</sup> Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010, f. 339.

<sup>65</sup> Kalia, A., “Organizmi i pushtetit gjyqësor sipas statuteve të Shkodrës”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, dokument me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë, p. 109.

dhe të rendit juridik dhe mënyrës së rregullimit në veçanti të marrëdhënieve juridiko-civile.

Studimi i institutit të dorëzarisë dhe trajtimi i këtij instituti sipas kanuneve të zonave të ndryshme, jo vetëm tregon për një rend juridik të mirëorganizuar, dhe për marrëdhënie juridiko-civile që kërkonin dhe parashikonin garanci për përmbushjen e detyrimeve, por mbi të gjitha na tregon se si në zona të ndryshme të trevave shqiptare, sipas karakteristikave të zonës dhe të popullsisë që jetonte në to, secili institut ishte përshtatur me rregulla të caktuara, për t'u respektuar sa më mirë.

### **Bibliografia**

- Frano I., *Kanuni i Skënderbeut*, shtëpia botuese “Editrice La Rosa”, Milot, 1993
- Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006
- Valentini, Z., *Studime dhe tekste juridike*, shtëpia botuese “Plejad”, botim i parë, Tiranë, 2009
- Goci, H., *Kanuni i Krahinës së Bendës*, shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë, 2010
- Elezi, I., *E drejta zakonore e Labërisë*, Botimet Toena, Tiranë, 2002
- Gjeçovi, Sh., *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, shtypshkronja “Geer”, Tiranë
- Martini, Xh., *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007
- Martini, Xhafer, *Kanuni i Dibrës*, shtëpia botuese “Emal”, botimi i dytë, Tiranë, 2007, f. 509-510.
- Elezi, I., *Kanuni i Labërisë*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2006, f. 165.
- Xhufi, P., “Statutet dhe kanuni në mesjetëm shqiptare”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, document me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë, p. 29-30.
- Nadin, L., “Statutet e Shkodrës”, “Onufri”, Botim i dytë, Universiteti “Wisdom”, Tiranë, 2010
- Nano, I., “Noteri publik: Funkzioni dhe roli i tij në Arbërinë mesjetare sipas Statuteve të Drishtit dhe Shkodrës”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, document me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë,
- Kalia, A., “Organizmi i pushtetit gjyqësor sipas statuteve të Shkodrës”, konferencë kombëtare shkencore “Statuti i Drishtit, dokument me vlera unike i trashëgimisë sonë për të drejtën, kristianizmin dhe historinë e Shqipërisë”, organizuar nga SHLUJ “Luarasi”, botuar në revistën shkencore “Mendimi”, Nr. 4, Janar, 2016, Tiranë





# LARGIMI I TRURIT DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË

Prof. Asoc. Dr. Ines DIKA

## Abstract

This article deals with the phenomenon of brain drain, focusing on the intensity of the phenomenon during the transition period in Albania and the ups and downs of this intensity. In the following, the directions of this movement towards more developed countries such as the USA, Canada and Western Europe are discussed and the reason why these countries were chosen. The article also deals with the causes of brain drain in Albania and provides empirical evidence of their impact on this phenomenon.

## Hyrje

Pas vitit 1900, Shqipëria u përball me një proces migrimi masiv. Ky proces kishte të bënte me migrimin masiv të popullsisë jashtë vendit, veçanërisht të të rinjve, të moshës së mesme dhe migrimin e shumë familjeve nga zonat rurale drejt zonave urbane, veçanërisht nga pjesa veriore e Shqipërisë në pjesën qendrore të saj.

Ky proces i migrimit masiv mori dy forma themelore:

- Emigrimi dhe migrimi i brendshëm i popullsisë që kërkon një standard më të mirë jetese jashtë vendit ose në zonat urbane të vendit (veçanërisht në kryeqytet). Ky fenomen, shumë i zakonshëm në fillim të viteve 1990, po ndodh edhe sot.
- Migrimi i intelektualëve elitë drejt Evropës Perëndimore, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë etj. Emigracioni i elitave filloi në fillim të viteve 1990, por u rrit ndjeshëm pas vitit 1995. Ky fenomen është ende i pranishëm edhe sot dhe vlerësohet se do të vazhdojë.
- Emigrimi ose migrimi i brendshëm i biznesmenëve. Në një situatë kur drejtimi i një biznesi ishte shumë i vështirë, shumë biznesmenë zgjedhën të mbyllnin ose të shisnin bizneset e tyre dhe të largoheshin nga vendi ose të zhvendoseshin në zonat e zhvilluara urbane për të hapur një biznes të ri ose për të kërkuar një punë tërheqëse.

Secila prej formave të sipërpërmendura të migrimit ka pasur një ndikim të thellë në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka ndikuar në një zhvillim jo të ekuilibrar midis rajoneve të Shqipërisë. Duhet theksuar se migrimi i elitës intelektuale dhe komunitetit të biznesit ka pasur ndikimin më të thellë në problemet e sipërpërmendura. Emigrimi masiv nga Shqipëria, me përmasat dhe intensitetin e tij në kohë dhe hapësirë, ka nxitur fenomenin e “largimi i trurit”. Kjo formë emigrimi përfshinte migrimin e specialistëve të kualifikuar nga të gjitha fushat e veprimtarisë intelektuale. Të tillë intelektualë ishin produkt i formimit disa dekadash në universitetet, institucionet shkencore e artistike shqiptare. Disa, veçanërisht gjatë viteve 1980 dhe 1990, u trajnuan në institucione në Evropën Perëndimore.

Sot, ikja e trurit po nxjerr në pah një kontradiktë midis të drejtës së shoqërisë shqiptare për t'u zhvilluar bazuar në kapacitetin intelektual të intelektualëve shqiptarë dhe të drejtës së individit për t'u larguar nga vendi për një jetë më të mirë. Kjo kontradiktë ekziston sepse migrimi i elitës intelektuale po ndikon negativisht në potencialin zhvillimor të vendit.

## **Dëshmi empirike e pranisë dhe dimensioneve të ikjes së trurit**

Situata e rëndë social-ekonomike e vendit dhe hapja e menjëhershme e tij me botën me fillimin e tranzicionit, janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në emigrimin real ose potencial të specialistëve. Migrimi intelektualëve ndodh në këto forma:

1. *Migrimi direkt.* Ka dy lloje migrimi, në këtë drejtim, emigrimi i elitës intelektuale drejt Evropës Perëndimore, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe madje edhe drejt vendeve të largëta si Australia. Duhet theksuar gjithashtu se nuk janë të pakta rastet kur intelektualët shqiptarë kanë emigruar në Evropën Lindore, madje edhe në Izrael. Gjatë viteve 1950, shumë shqiptarë, të cilët shkuan jashtë vendit për qëllime studimi, u martuan me vendas dhe si rrjedhojë fëmijët e tyre kanë të afërmit e tyre atje. Po kështu, për një kohë të gjatë në Shqipëri kishte një grup të vogël izraelitësh. Pas vitit 1990, thuajse të gjithë izraelitët u larguan nga Shqipëria për në Izrael, mes tyre ishin edhe shumë intelektualë të njohur të fushave të ndryshme.

2. *Intelektualët që nuk u kthyen pas një periudhe të shkurtër dhe të mesme specializimi.* Pas vitit 1990, shumë intelektualë që punonin në institucione shkencore dhe profesorë universitarë u dërguan jashtë vendit për trajnime. Në shumë raste ata vendosën të qëndrojnë në vendet përkatëse. Fatkeqësisht, në shumë raste ata punonin në punë që nuk kishin lidhje me specializimin apo kualifikimin e tyre. Megjithatë, ka edhe raste kur ata kanë gjetur punë më të mira dhe në raste të rralla kanë gjetur punë të përputhshme me specializimet dhe kualifikimet e tyre.

3. *Ata që nuk u kthyen pas diplomimit në një vend të caktuar.* Këta ishin kryesisht të diplomuar dhe specialistë të tjerë të rinj, që punonin si studiues në institucione shkencore ose si asistent profesorë në universitete. Ata kishin marrë bursa për master ose doktoraturë në Evropën Perëndimore ose në SHBA dhe që nuk u kthyen në Shqipëri pas diplomimit. Ata mund të jenë vendosur në vendin ku kanë studiuar ose janë zhvendosur në një vend tjetër. Në përgjithësi ata kanë gjetur punë që plotësojnë specializimet dhe kualifikimet e tyre. Një pjesë e këtij grupi janë studentë të regjistruar në universitete të huaja jashtë vendit, të cilët pas diplomimit kanë preferuar të qëndrojnë jashtë vendit sesa të kthehen në Shqipëri.

4. *Migrimi i mkekëve dhe infermjerëve sidomos në drejtim të Gjermanisë.* Mbushja e boshllëkut për specialistë sidomos të mjeksisë në vendet e zhvilluara (kryesisht Gjermani por jo vetëm) është bërë përmes migrimit të mjekëve dhe infermjerëve shqiptarë jo vetëm të sapodiplomuar por edhe të aryre me përvojë.

5. *Punësimi nga organizatat ndërkombëtare sidomos në vendet afrikane dhe aziatike.* Specialistët që kanë punuar si staf vendor me organizata apo institucione ndërkombëtare përbëjnë një grup tjetër. Numri i këtyre specialistëve ishte mjaft i madh gjatë krizave të vitit 1997. Duke qenë se disa prej tyre kishin fituar një reputacion të mirë, vazhduan të punojnë me organizatat ndërkombëtare edhe gjatë krizës në Kosovë dhe aktualisht janë të angazhuar si staf ndërkombëtar që punojnë me këto institucione dhe punojnë në vende të ndryshme sipas nevojave të institucionit.

Fenomeni i emigrimit të elitës intelektuale shqiptare tregon karakteristikat e saj relativisht të mirëpërcaktuara që e dallojnë atë nga emigracioni masiv. Edhe pse shifra

e përgjithshme duket e vështirë për t'u përcaktuar saktë, ajo është e konsiderueshme dhe asaj duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

Motivet e largimit bazohen qartë në tërheqjen e vendeve të zhvilluara, veçanërisht në pagat më të larta, kushtet më të mira të punës, stabilitetin politik, si dhe mundësitë për një arsimim më të mirë për fëmijët e tyre. Në rastin shqiptar faktori i fundit (arsimimi më i mirë i fëmijëve) është shumë i fortë ndër motivet e emigrimit.

Një faktor tjetër është zgjerimi i shpejtë i kërkimit dhe zhvillimit (R&D), sepse mundësitë për punësim shkencor janë shumë më të mira në vendet e zhvilluara sesa në Shqipëri. Në këtë aspekt, problem nuk është vetëm nevoja për paga më të larta, por edhe nevoja për kushte më të mira pune, mundësi më të mëdha për akses në literaturën moderne dhe takime me specialistë të huaj në fusha të ndryshme.

Kështu, Shqipëria që ka financuar arsimimin e specialistëve dhe në disa raste ka financuar trajnime në vendet perëndimore, nuk ka kthim nga dështimi i investimit të tyre nga pikëpamja e shpenzimeve për arsimin. Nuk kemi parasysh këtu faktin që disa shqiptarë jashtë vendit promovojnë një imazh shumë të mirë për Shqipërinë si dhe bëjnë përpjekje për të rritur numrin e kompanive të huaja që investojnë në Shqipëri ose po bëjnë kërkime për vetë Shqipërinë.

Një problem serioz në rastin e migrimit të intelektualëve është se mes tyre janë disa nga mjekët më të mirë në vend, disa nga profesorët universitarë dhe studiuesit më të mirë të institucioneve tona shkencore. Këto institucione kanë vështirësi në përgatitjen e kadrove të reja që mund të zëvendësojnë stafin e vjetër të mirëkualifikuar, sepse stafi i ri shpeshherë është i ri dhe i pakualifikuar.

Duhet të përmendim edhe një fakt që e përkeqëson këtë situatë është se pas diplomimit studentët më të mirë preferojnë të migrojnë, të punojnë në institucione ndërkombëtare, institucione financiare apo institucione të tjera të ngjashme sesa të punojnë në universitete si profesorë, ku arsyet kryesore janë pagat e ulëta dhe kushtet e këqija të punës.

Në këto kushte, universiteteve dhe institucioneve shkencore u mungojnë specialistët e rinj më të mirë që mund të zëvendësojnë specialistët që migrojnë jashtë vendit, ose që largohen për të punuar në vende të tjera brenda vendit (institucione ndërkombëtare, administratë publike apo në sektorin privat) ose që dalin në pension. Ndikimi i largimit të trurit është më i thellë në mjekësi, në institucionet shkencore dhe në universitetet e rretheve.

Si pasojë e migrimit të trurit, shkenca shqiptare pëson humbje të mëdha. Në shumë raste personeli i rekrutuar nuk janë të diplomuarit më të mirë, pasi preferojnë të punojnë në institucionet ndërkombëtare, sektorin financiar dhe administratën publike, ku pagat janë më të larta.

Prandaj, sektori privat dhe publik (administrata publike dhe institucionet financiare) janë në pozitë të privilegjuar, ndërsa pjesa e mbetur e sektorit publik, përfshirë arsimin, shkencën dhe kujdesin shëndetësor, po diskriminohen pasi mund të ofrojnë vetëm paga të ulëta. Kjo situatë shpjegon përmasat e migrimit të brendshëm të trurit nga shkenca dhe arsimi i lartë. Sistemi aktual i financimit të kërkimit shkencor në fakt nuk e

zvogëlon migrimin e stafit kërkimor, pasi të ardhurat shtesë që mund të merren janë dukshëm më të ulëta se pagat jashtë vendit.

Gjetjet dhe analizat e bëra nga studiuesit shqiptarë në lidhje me ikjen e trurit (elita intelektuale apo shtresat më të kualifikuara të inteligjencës shqiptare) treguan se numri i pedagogëve dhe studiuesve që emigruan nga universitetet dhe institucionet shkencore shqiptare është i konsiderueshëm.

Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria ka disa karakteristika kryesore:

1. *Ata janë kryesisht studiues të rinj dhe staf universiteti.* Kjo karakteristikë bazohet në faktin se studiuesit e vjetër jo vetëm ndihen më të stabilizuar por edhe sepse e kanë të vështirë të integroheshin në stilin e jetës së vendit pritës. Procesi i integritimit për ta është i vështirë për shkak të moshës dhe statusit social. Nga ana tjetër, studiuesit e rinj dhe profesorët e rinj të universitetit janë energjikë dhe plot vitalitet për shkak të moshës së tyre, gjë që e bënë shumë më të lehtë integrimin në komunitetin pritës.

2. *Shumica janë meshkuj* (vlerësohet të jenë më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm). Mendojmë se ky fakt është si rrjedhojë e psikologjisë patriarkale mbizotëruese në shoqërinë shqiptare. Në përgjithësi supozohet se meshkujt shqiptarë mund të përshtaten me më pak probleme me kushtet e një vendi tjetër.

3. *Shumica e tyre janë të pamartuar.* Gjatë viteve të para të periudhës së tranzicionit numri i specialistëve të pamartuar ishte i vogël. Supozojmë se kjo ka ardhur si pasojë e faktit se në vitet e para të tranzicionit kurset e specializimit dhe formimit iu janë dhënë specialistëve të moshës së mesme, pasi kontributi i tyre gjatë këtyre viteve ka qenë më i madh dhe gjithashtu kanë qenë të etur për të parë Evropën Perëndimore. Por me kalimin e viteve është shtuar shumë numri i rasteve të largimit të specialistëve të rinj dhe të pamartuar.

4. *Shumica kanë emigruar me familjet e tyre* (vlerësohet të jenë 2/3 e numrit të përgjithshëm). Familja shqiptare edhe në ditët e sotme bazohet në lidhje të forta tradicionale. Këto lidhje janë të forta jo vetëm me familjen e ngushtë, por edhe me të afërmit e tjerë të gjakut.

Rritja e intensitetit të emigrimit të elitës intelektuale nga Shqipëria përkon me uljen e prodhimit dhe standardit të jetesës. Duke filluar nga viti 1993, numri i intelektualëve dhe intensiteti i emigrimit të elitës intelektuale u ngadalësua. Kjo ishte kryesisht për shkak të politikave shtrënguese të emigracionit të adoptuara nga vendet e Evropës Perëndimore, në kushtet e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe rritjes së papunësisë, si dhe përmirësimit relativ të disa treguesve makroekonomikë në Shqipëri, deri në fund të vitit 1996.

Edhe një herë duhet theksuar se numri i emigrantëve intelektualë vlerësohet të jetë ulur pas vitit 1998, por sipas disa hulumtimeve vlerësohet të jetë ende i lartë dhe vitet e fundit ky intensitet vazhdon të rritet.

Varfërimi masiv i elitës shkencore dhe intelektualëve ka pasur ndikime të rëndësishme social-ekonomike. Ajo shoqërohet me një zhvlerësim drastik të "kapitalit intelektual", i cili përfiton veprimtari spekulative dhe korruptive dhe pengon formimin e ardhshëm të inteligjencës teknike dhe shkencore për të cilën vendi ka shumë nevojë. Ndërkohë, pabarazia e theksuar në shpërndarjen e të ardhurave është një tjetër faktor kontribues

në demoralizimin social-ekonomik dhe ka sjellë një krizë të thellë të motivimit ekonomik dhe moral. Ndihton përgjithësimin e sjelljeve të përqendruara në afat të shkurtër që pengon formimin e elitës dhe ka ndikim të madh në emigrimin e intelektualëve brenda dhe jashtë vendit.

Sipas anketave të mëparshme të kryera disa vite më parë nga OJQ-të shqiptare, SHBA-të, ku janë vendosur 23% e emigrantëve dhe Greqia dhe Italia me përkatësisht 15% dhe 18%, janë vendet e destinacionit më të njohura. Vende të tjera të Evropës Perëndimore si Franca (13%) dhe Gjermania (rreth 19%) renditen gjithashtu lart në listë. Duhet përmendur gjithashtu se disa nga intelektualët e vendosur në Itali kishin kaluar nga një deri në tre vjet në vend për qëllime specializimi pasuniversitar përpara emigrimit. Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria, i ndryshëm nga disa ekonomi të tjera në tranzicion (Poloni, Slloveni, Bullgari, Rumani, etj.), është i përqendruar kryesisht në vendet fqinje (Greqi, Itali) dhe gjithnjë e më shumë në Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja dhe së fundmi intensitet të lartë ka emigrimi drejt Gjermanisë. Faktorë të tjerë për zgjedhjen e vendeve të destinacionit kushtëzohen nga faktorë të tillë si afiniteti kulturor, njohja e mëparshme me rrethe të caktuara shoqërore, shanset më të mira për të përballuar lejet e jetesës dhe punës, aftësia gjuhësore, shanset më të mira për t'u integruar në shoqëri dhe niveli i zhvillimit në fushën shkencore. kërkime etj.

Shumë shpesh, intelektualët që përbëjnë grupin më të kualifikuar dhe më të specializuar të elitës intelektuale, emigrojnë kryesisht në vendet ku kishin ndjekur më parë studimet pasuniversitare dhe pasuniversitare. Grupi i mbetur i intelektualëve emigrojnë në vendet fqinje, duke kontribuar kështu në një emigrim masiv.

Nëse veçojmë nga sondazhet tona të intelektualëve të emigruar, emigrimi i tyre do të kishte këto karakteristika:

- Në këtë grup, intelektualët meshkuj janë më shumë se femrat;
- Për më tepër, intelektualët që emigruan së bashku me familjet e tyre janë në masë të madhe më të madhe se ata që emigruan pa familjet e tyre;
- Një numër dërrmues kanë titullin Doktor i Shkencave;
- 5 vendet kryesore të destinacionit janë Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Gjermania, Franca, dhe Italia;
- Së fundi, nga pikëpamja kohore, emigracioni arriti kulmin në vitet 1992-1993 dhe ra pas vitit 1994. Ky trend u përsërit në vitet 1997-1998 dhe më pas ra përsëri pas vitit 1999 për të marr një intensitet të lartë përsërim pas vitit 2010/

### **Faktorët që ndikojnë në fenomenin e largimit të trurit**

*a. Faktorët Ekonomik* Krahasuar me disa ekonomi të tjera të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, emigracioni real i intelektualëve shqiptarë është më i lartë se në këto vende dhe studiuesit shqiptarë e vlerësojnë rreth një të tretën. Rezultatet e arritura në studimet e emigracionit të elitës intelektuale tregojnë se në këtë rast përballemi me një fenomen të përcaktuar kryesisht nga faktorët ekonomikë.

Siç është përmendur tashmë, në sektorin privat dhe publik (institucionet financiare dhe administrata publike) janë në pozitë privilegji, ndërsa pjesët e mbetura të sektorit

publik, duke përfshirë arsimin, shkencën dhe kujdesin shëndetësor, janë duke u diskriminuar pasi ofrojnë të ulëta. pagat. Kjo situatë shpjegon përmasat e emigrimit dhe ikjen e brendshme të trurit nga shkenca dhe arsimi i lartë.

Mbështetja e pamjaftueshme nga qeveria dhe institucionet ndërkombëtare me mjete financiare për kërkimin shkencor është një tjetër faktor që ka ndikuar në tendencën e lartë të specialistëve për t'u larguar nga puna në institucionet shkencore dhe universitetet. Ky supozim bazohet në dialogët me kolegët dhe nga vëzhgimet personale.

*b. Paqëndrueshmëria socio-politike e vendit* Faktori i paqëndrueshmërisë social-politike ka pasur një ndikim të thellë në Shqipëri. Duhet të theksoj se pas ndryshimeve rrënjësore politike në dhjetor 1990, vendi u përfshi në trazira sociale dhe anarki totale. Në vitin 1991 u shkatërruan shumë prona shtetërore, në veçanti ndërmarrje shtetërore. Ka disa dëshmi se pas këtij shkatërrimi, në disa raste, zjarret janë ndezur qëllimisht për të fshehur shkatërrimin e organizuar.

Korrupsioni dhe shumë probleme të tjera janë pikat kryesore të luftimeve mes forcave politike sot. Për intelektualët këto luftime janë më shumë se përballje pikëpamjesh dhe platformash, por lufta për pushtet. Parë në këtë këndvështrim, situata social-politike e vendit që nga viti 1991 ka kaluar nëpër kriza dhe përballje të forta të forcave politike, dhe si rrjedhojë ka bërë të nevojshme praninë e forcave të huaja ushtarake për rivendosjen e rendit. Kjo situatë ka ndikuar keq tek intelektualët në pikëpamjen e tyre për të ardhmen e vendit. Të detyruar nga këto kushte, shumë intelektualë shqiptarë arritën në përfundimin se e ardhmja e tyre ishte jashtë vendit. Edhe pse nuk ka të dhëna të plota, studimet e pjesshme të kryera në këtë drejtim nga studiues shqiptarë apo të huaj, tregojnë se emigracioni intelektual ka qenë i lartë gjatë periudhave të ndryshme të krizave në Shqipëri.

Shumë intelektualë shqiptarë janë shumë skeptikë për një përmirësim të gjendjes së tyre ekonomike dhe kushteve të punës në një periudhë afatshkurtër, të karakterizuar nga komente të tilla si "nuk shoh dritë në fund të tunelit". Errësira totale në fund të tunelit është një nxitje e fortë për të emigruar jashtë vendit.

*c. Faktorët Psikologjikë* Faktorët psikologjikë kanë qenë gjithmonë një nxitje e fortë për emigracionin intelektual. Në këtë situatë të paqartë me shumë lëkundje të situatës sociale dhe ekonomike dhe me nivele të larta korrupsioni, është logjike që është shtuar dëshira e intelektualëve për t'u larguar nga vendi. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, Shqipëria është në vended shymë të larta dhe bile më keq se vendet e tjera të Ballkanit. Niveli i lartë i korrupsionit ka sjellë ndikim psikologjik tek intelektualët. Shumë e kanë kuptuar se mundësia kryesore për një jetë normale apo më të mirë është korrupsioni.

Të gjithë këta faktorë shtuan ndikimin e faktorëve psikologjikë në prirjen e elitës intelektuale shqiptare për të emigruar. Nisur nga fakti se disa nga intelektualët që emigruan gjetën një mënyrë jetese më të mirë financiare në krahasim me ish-kolegët e tyre në Shqipëri, tek intelektualët shqiptarë ekziston bindja se "shqiptarët janë më mirë jashtë vendit të tyre". Pra, psikologjikisht, shumë intelektualë shqiptarë e konsideruan emigracionin një nga mundësitë kryesore për një jetë më të mirë.

Një faktor tjetër që mbështet psikologjinë e të jetuarit jashtë vendit është fakti se shumica e politikanëve shqiptarë i kanë dërguar fëmijët e tyre për t'u shkolluar jashtë vendit dhe, në përgjithësi, kanë vendosur përfundimisht të vendosen jashtë. Politikanët në një farë mënyre i kanë motivuar njerëzit, veçanërisht elitën intelektuale, të largohen nga vendi.

### **Shkaqet e zakonshme mbizotëruese të largimit të trurit**

Një analizë e aktiviteteve të intelektualëve të emigruar në vendet pritëse nxjerr në pah rezultate interesante. Bazuar në sondazhet personale dhe të kolegëve të tjerë për emigrimin e elitës intelektuale nga Shqipëria, në lidhje me aktivitetet, është e qartë se ekzistojnë dy grupe intelektualësh të emigruar.

*Grupi i parë* janë ata intelektualë që nuk punojnë në fushën e specializimit të tyre. Kjo padyshim përcaktohet nga shumë faktorë. Midis tyre janë: politikat e emigracionit të ndjekura nga këto vende, korrelacioni ndërmjet emigracionit dhe specializimit, zhvillimi i sektorit shkencor, cilësia e flukseve të emigracionit intelektual, etj. Të dhënat e disponueshme për Shtetet e Bashkuara, për shembull, tregojnë se politikat e emigracionit të ndjekura nga ky vend nuk synojnë domosdoshmërisht të vlerësojnë njohuritë dhe përvojën e atyre që vijnë në Shtetet e Bashkuara, por më tepër të ruajnë nivelin e arritur tashmë të kualifikimit të popullsisë.

Zhvillimi i sektorit shkencor dhe ngopja e sektorëve në vende të tjera e bëri të vështirë që specialistët e emëruar të gjenin një mënyrë për të ushtruar specializimin e tyre në vendet ku emigruan.

Cilësia e flukseve të emigracionit intelektual është një faktor shumë i rëndësishëm, sepse konsiston në nivele të larta konkurrence për të gjetur punësim në profesionet e “white collar”. Prandaj, intelektualët e emigruar shpesh e kanë të vështirë të gjejnë punë në profesionin e tyre.

*Grupi i dytë*, janë intelektualët që janë të integruar me universitete, laboratorë, institucione shkencore ose me sistemin e prodhimit ose të shërbimeve të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara. Emigrimi i këtij seksioni të elitës intelektuale, padyshim më i kualifikuari dhe më i specializuari, nga një këndvështrim është një humbje e pazëvendësueshme për shoqërinë shqiptare, e cila ka një ndikim negativ ekonomik, social dhe politik sot dhe do të vazhdojë të ketë edhe në e ardhmja.

Sigurisht, këta intelektualë ishin më të kualifikuarit dhe shumica e tyre kanë pasur mundësinë të specializohen në universitetet dhe institucionet shkencore perëndimore për periudha të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Nga pikëpamja cilësore, si pasojë e ikjes së trurit, ka pasur humbje të shumë muajve të specializimit jashtë vendit.

Tani është koha për të theksuar se shumë intelektualë të larguar (ata të integruar me universitete, laboratorë dhe institucione shkencore apo me sistemin e prodhimit apo të shërbimeve) kanë filluar t'i kthejnë sytë drejt Shqipërisë, duke inkurajuar në këtë mënyrë shumë kompani të huaja për t'u vendosur në vend dhe gjithashtu organizimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe institucioneve shkencore veçanërisht përmes projekteve të ndryshme.



Sipas fushave shkencore, emigrantët e elitës intelektuale renditen si më poshtë: kryesisht janë nga mjeksia dhe shkencat shoqërore dhe më tej nga shkencat natyrore dhe inxhinieritn. Nga pikëpamja e nivelit shkencor, mendohet se rreth gjysma e tyre posedojnë tituj dhe grada shkencore. Shumica e tyre, duke filluar nga fundi i viteve 1980, dhe veçanërisht, nga fillimi i tranzicionit postsocialist, kanë shkuar jashtë vendit, kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara, për specializime afatshkurtra dhe afatmesme si dhe për qëllimet e konferencës shkencore. Për rrjedhojë, elita intelektuale u kualifikua, u specializua në universitete dhe institucione shkencore jashtë vendit, veçanërisht në vitet e para të tranzicionit duke pasur përvojë të mirë pune dhe njohje të disa gjuhëve të huaja.

Më të prirur për emigracion janë brezat e rinj të specialistëve si dhe studiuesve në universitete dhe institucione kërkimore. Një prirje më e madhe për të emigruar në grupmoshat më të reja dhe duke pasur parasysh mundësitë që emigracioni i mundshëm të kthehet në emigracion aktual, mund të sjellë humbjen e dinamizmit dhe plakjen e institucioneve shkencore dhe universiteteve të vendit.

### Literatura

Andreff, W. “S&T and the Future of Economies in Transition: An Economic Perspective”, in, Meske, W. et al. *Transforming Science and Technology Systems-the Endless Transition?* IOS Press, 1998.

Cipusheva, H., Havolli, S., Memaj, F., Mughal, A. G., Sejdini, A., Shehaj, E., & Sadiku, L. (2013). *Brain Circulation and the Role of the Diaspora in the Balkans-Albania, Kosova and Macedonia. (May 16, 2013).*

Civil Code of the Republic of Albania.

Dishnica, T. *Agriculture Research in Albania: A Monograph.* Tirana, 2002

DOCQUIER F., *The brain drain produces many more losers than winners in developing countries,* <https://wol.iza.org/uploads/articles/31/pdfs/brain-drain-from-developing-countries.pdf>, 2023

Gëdeshi, I., Mara H., Dhimitri R., and Krisafi K. *Aspects of Emigration of the Intellectual Élite from Albania during the Transition Period in Albania.* Tirana: Centre for Economic and Social Studies, 1999

Instat. *Education: Statistics and Indicators 1991-2021* Tirana: December 2023

Instat. *Labour Market 2022.* Tirana, 2023.

Instat. *Statistical Yearbook 1992-2001.* Tirana, 2001

Jalowiecki, B., Hryniewicz, J., and Mync, A., *Brain Drain from Science and Universities in Poland 1992-1993.* Warsaw: University of Warsaw, European Institute for Regional and Local Development, 1994.

Kosta, B., & Memaj, F. (2019, September). *Business models for the circular economy—case of Albania.* In *iai academic conference proceedings.*

Malaj, A., Mema, F., & Hida, S. (2005). *Albania, financial management in the education system: Higher education* (No. 54). BERG Working Paper Series on Government and Growth.

Mema, F., & Preçi, Z. (1998). *Informal Economy—A Barrier to a Sustainable Development. Special number of magazine: Transition and Economy, Tirana, Albania.*

Memaj, F. “Albania: Vortices of imbalance Immigration and Urbanization”, *Higher education in Europe* Publisher Routledge Tailor and Francis Group, Volume XXIX No 3 2004.



- Memaj, F. "Some Features of Albanian Emigration in Italy", *Economy and Transition Magazine* 1 23 (2000).
- Memaj, F. "Urbanization or Ruralization for the Industrial Towns", *Study of Population Magazine* 1 (1998).
- Memaj, F. etj "Fuga dei Cervelli: il caso dell Albania" pjesë në monografinë "Gli Albaniesi in Italia. Conseguenze economiche e sociali dell'immigrazione" Edizioni IDOS (2008).
- Memaj, F., Dollani, P. (2010). Brain Drain: The Albanian Case. *Brain Drain*, 1000-1006.
- Memaj, F., Koxhaj, A. (2008, May). The challenges of brain drain in South East Europe: Albania's Case. In *International Conference on Applied Economics. ICOAE*.
- Morabety, A., dhe Morabety M., "The Impact of Brain Drain on Development: A Case Study of Morocco" *Revista, Contemporary Arab Affairs* (June 2022) 15 (2)
- Redek, T., Memaj, F., Prašnikar, J., & Trobec, D. (2012). Albania: Two decades of economic development at a glance. *Albania: The Role of Intangible Capital in Future Growth*, 4-59.



## KOMITETI SHKENCOR



**Dr. Zef PREÇI** - ka një eksperiencë prej mbi 30 vite pune si studiues në fushën e kërkimeve social-ekonomike, ideimin dhe drejtimin e kryerjes së studimeve, prezantimeve publike, hartimit të vrojtimeve kombëtare, interpretimeve dhe analizave, etj. Ai ka kryer një sërë detyrash publike si: Ministër i Ekonomisë dhe Privatizimit (1999); Këshilltar Ekonomik i Presidentit të Republikës (2002-2004); Kryetar i parë i Autoritetit të Konkurrencës (2004-2005); gjithashtu ka kryer detyra të përfaqësimit në nivele të ndryshme brenda komunitetit të biznesit dhe të shoqërisë civile. Dr. Preçi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm për institucione të ndryshme financiare, sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe komunitetin e biznesit, duke ofruar ekspertizë në ndërtimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e shërbimeve të ndryshme, me njohuri të gjerë në rajon dhe veçanërisht në Kosovë. Ai ka një serë kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit. Ai është autor shumë artikujsh dhe studimesh dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktualisht, Dr. Preçi është kryeredaktor i Revistës Shqiptare Social-Ekonomike, përfaqësues i shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për barazinë gjinore si dhe Drejtor Ekzekutiv i QShKE ([www.acer.org.al](http://www.acer.org.al)). E-mail: [zef.preçi@gmail.com](mailto:zef.preçi@gmail.com)



**Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES** - Ph.D. në matematikë. Eshtë profesoreshë në Institutin e Kontabilitetit dhe Administratës së Politikave të Porto (ISCAP/P.PORTO) që nga viti 2000. Eshtë autor dhe bashkëautor i shumë botimeve. Ka qenë koordinatore e projekteve që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe inovacionin pedagogjik në arsimin në distancë. Në vitin 2015, mori Çmimin për Inovacion Pedagogjik në Arsimin në Distancë. Ka qenë anëtare e Komitetit Shkencor të disa Konferencave Ndërkombëtare dhe është anëtare e Bordit Shkencor të Hyperion Economic Journal (HEJ). Ajo është recensues dhe anëtare e komitetit të programit për disa Konferenca Ndërkombëtare. Kërkuese në Qendrën e Kërkimit për Komunikim dhe Edukim (CEOS.PP) dhe studiues në Qendrën Kërkimore për Studimin e Popullsisë, Ekonomisë dhe Shoqërisë (CEPESE). Fokusi kryesor i saj në fushën e kërkimit është LMS përkrah platformat, teknologjitë informative në arsim, mësimin elektronik, paradigmen e mësimdhënies, Analizën e të mësuarit, vendimmarrjen me shumë kriterë. E-mail: [aplopes@iscap.ipp.pt](mailto:aplopes@iscap.ipp.pt)



**Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO** ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ai ka marrë PhD nga universiteti i Trier (Gjermani) në vitin 1992. Në vitin 2005 ai merr titullin profesor në ISCTE-IUL Institutin Universitar të Lisbonës. Ai ka qenë dekan për Marrëdhënie Ndërkombëtare në shkollën e Biznesit në ISCTE, ku ka dhënë mësim në fushën e metodave sasiore dhe menaxhimit. Aktualisht fusha e tij kryesore e hulumtimit është menaxhimi ndërkulturor dhe krahasues. Ai është autor dhe bashkautor i shumë artikujve kërkimore, kumtesave në konferenca dhe studimeve. Prof. Robalo ka një eksperiencë të konsiderueshme ndërkombëtare, duke dhënë mësim në shumë vende të ndryshme, duke përfshirë Mozambik dhe Cape Verde (në portugalisht), Austria (në gjermanisht), Francë, Kinë, Makau, Japonia, Koreja, Poloni, Rep. Çeke, Rusia, Gjeorgjia (në anglisht). E-mail: [Antonio.robalo@iscte.pt](mailto:Antonio.robalo@iscte.pt)



**Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA** - Departamenti Finances dhe Menaxhimit Strategjik Universiteti i Lodzit, Poloni. Ka marrë titullin Doktor në vitin 1985 në Universitetin e Lodzit. Prof. Ëitkoëska ka kryer kërkimet e saj shkencore në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë, Politeknikën e Lodzit, gjithashtu në Princeton University, Pennsylvania University dhe Georg August University në Göttingen (Gjermani). Kryen kërkimet mbi Tregun Financiar, Ekonometri Financiar, Studime Krahasuese, Analiza Multidimensionale Statistike, Studimet Gender të cilat financohen nga qeveria polake dhe nga grantet e BE-se. Prof. Ëitkoëska është autore dhe bashkautore e mbi 200 artikujve shkencorë të publikuar në polonisht, anglisht dhe rusisht si dhe e 6 monografive dhe 9 teksteve universitare. Prof. Ëitkoëska është pjestare e disa organizatave shkencore ndërkombëtare në Poloni dhe në Botë. Prof. Ëitkoëska ka pasur funksionin e Zv/dekanit për peshtjet shkencore në Fakultetin e Informatikës së Aplikuar e Matematikës në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë dhe pjestare e bordit ekzekutiv të International Atlantic Economic Society. E-mail: [dorota.witkowska@uni.lodz.pl](mailto:dorota.witkowska@uni.lodz.pl)



**Prof. Dr. Ing. Elena HORSKÁ** - Aktualisht është profesoreshë e Marketingut dhe Menaxhimit në Departamentin e Marketingut dhe dekane e Fakultetit të Ekonomisë dhe Menaxhimit, Universiteti Sllovak i Bujqësisë në Nitra. Në vitet 2003-2010 ka qenë zëvendës dekan për marrëdhënie ndërkombëtare dhe 2010-2014 zëvendës-rektore për marrëdhëniet ndërkombëtare. Në vitin 2011 ajo u nderua me titullin "Profesor Honoris Causa" nga ana e Shkollës së Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve të Delhit, Neë Delhi, Indi. Orientimi i saj kryesor i kërkimit përfshin internacionalizimin brenda dhe jashtë kufijve të BE-së, identifikimin e mundësive për të bërë biznes në tregjet fqinje (Visegrad), Evropë, vendet më pak të zhvilluara dhe ato në zhvillim (fokus agrobiznesi dhe tregu agro-ushqimor), studime të konsumatorëve, neuromarketing. Ajo

ka qenë profesor vizitore në Shkollën e Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve Delhi në Nju Delhi, Indi, në Universitetin Kombëtar Kazakistik të Kazakistanit në Almaty, në Finlandë, Itali, Portugali, Spanjë dhe Irlandës dhe në programin CEEPUS në Kroaci, Hungari, Austri dhe Poloni. Ajo ka qenë një koordinatorë e 6 projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe 22 projekte ndërkombëtare. Ajo është autore e më shumë se 200 botimeve, përfshirë 6 tekste kombëtare / ndërkombëtare, 10 monografi kombëtare / ndërkombëtare të botuara në Sllovaki, Çeki, Poloni, Austri, Spanjë, Rumani dhe Kroaci dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në Tajlandë, Kinë, Maltë, Ganë, Hungari, Greqi, Poloni, Çeki, Austri, Brazil, Indonezi, SHBA dhe Singapor. Ajo është koordinatorë e programit të diplomës së dyfishtë "Marketing dhe Tregti Agrare" të organizuar së bashku me Universitetin Agrare të Rusisë - Akademia Timiryazev e Moskës dhe anëtare e Agjencisë Evropiane të Akreditimit për Bordin e Shkencave të Jetës (me Sekretariatin EALS në Francë). Elena.Horska @ gmail.com



**Prof. Dr. Fatmir MEMAJ-** ka një eksperiencë më shumë se 30 vite në institucionet e arsimit të lartë si Lektor i Statistikës dhe Demografisë. Mori gradën PhD në vitin 1996. Në Maj të vitit 2011, Profesor i Asociuar dhe në Mars të vitit 2007 Profesor. Prof. Memaj ka një eksperiencë të gjerë në arsimim dhe ekonomi, duke theksuar: Zëvendës Ministër i Mbrojtjes për çështjet ekonomike (1992-1993); Lektor, Fakulteti i Biznesit dhe i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1994-1997); Drejtues i Departamentit të Statistikës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1997-1998), Zëvendës Dekan, Fakulteti i Ekonomisë, UT (2003-2016), etj. Aktualisht, ai është profesor në Fakultetin e Ekonomisë, UT dhe Drejtor Ekzekutiv i Forumit Shqiptar Social-Ekonomik (ASET) [www.aset-al.com](http://www.aset-al.com). Autor dhe bashkë-autor i shumë librave dhe monografive dhe mbi 50 artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, i më shumë se 80 punimeve të konferencave dhe i një sërë studimesh dhe punimesh kërkimore në fushën e tij. E-mail: [fmema@yahoo.com](mailto:fmema@yahoo.com) ose [fatmirmemaj@feut.edu.al](mailto:fatmirmemaj@feut.edu.al)



**Prof. Dr. Dr.h.c. Heinz-Dieter WENZEL-** ka një eksperiencë të gjerë në çështjet ekonomike. Ai ka studiuar matematikë në Universitetin e Munster-nit dhe mori gradën PhD në vitin 1975 në Universitetin e Heidelberg-ut. Ai ka qenë Profesor i Financave Publike në Universitetin e Heidelberg-ut (1983-1985) dhe Profesor i Teorisë së Ekonomisë në Universitetin Ludëig-Maximilian, Munihi (1985-1989). Nga viti 1989, ai ka qenë Profesor i Ekonomisë Publike në Universitetin e Bamberg-ut, ku ai doli në pension në vitin 2011. Nga viti 1989 deri në vitin 2011, ai ishte Drejtues i Grupit të Kërkimeve Ekonomike të Bamberg-ut për Qeverisjen dhe Rritjen (BERG). Gjithashtu, në vitin 2000 ai mori përsipër menaxhimin e një projekti bashkëpunues midis Univ të Bamberg-ut, Budapest, Sarajevë, Tiranë, Tetovë, që formoi bashkëpunim ekonomik në kërkim dhe mësimdhënie. Ai është autor i shumë librave dhe artikujve shkencorë. E-mail: [heinz-dieter.enzenel@uni-bamberg.de](mailto:heinz-dieter.enzenel@uni-bamberg.de)



**Prof. Dr. Iraj HASHI-** ka përfunduar studimet e tij të Masterit në Shtetet e Bashkuara (Universiteti i Maryland ) dhe studimet e doktoraturës në Britaninë e Madhe ( Universiteti i Keele). Ai e filloi karrierën e mësimdhënies në Universitetin e Staffordshire në vitin 1978 si Lektor për lëndën e Ekonomisë. Aktualisht është Profesor i Ekonomisë dhe Drejtor i Qendrës për Kërkime mbi Ekonomitë në Zhvillim, në Universitetin e Staffordshire-it. Ai është i specializuar në Mikroekonomi, Ekonomi Industriale dhe që nga viti 1990, Ekonomia në Tranzicion. Ai ka koordinuar Projektin Erasmus, Socrates dhe programet e Tempus-it dhe aktivitetet e tij në Evropën Qendrore dhe Lindore. Dr. Hashi ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në kërkime, mësimdhënie dhe konsulencë në ekonomitë në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore që nga viti 1992, dhe ka punuar me universitetet dhe institucionet kërkimore dhe konsulencës në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Republikën Çeke, Kosovë, Maqedoni, Poloni dhe Rusi në një gamë të gjerë projektesh që kishin në qendër të tyre sfidat e tranzicionit në këto vende. Interesat e tij kërkimore përfshijnë: privatizimin dhe ristrukturimin, qeverisjen e korporatave, konkurrencën industriale, falimentimin dhe riorganizimin, risinë dhe ndryshimet teknike. Ka botuar shumë artikuj në revista shkencore dhe libra. E-mail: [i.hashi@staffs.ac.uk](mailto:i.hashi@staffs.ac.uk)



**Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR-** Profesor i Ekonomisë, është Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Evropën Juglindore dhe themelues dhe drejtor i Programit Master i Biznesit dhe Organizimit në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin e Lubjanës, program me diplomë të njohur në nivel ndërkombëtar. Ai ka qenë anëtar i Bordit Strategjik të Kryeministrit të Sllovenisë dhe të komitetit të programit të Presidentit të Sllovenisë. Si një hulumtues ai është i lidhur me Institutin Ëilliam Davidson në Shkollën e Biznesit, Universiteti i Michigan, SHBA, dhe Qendrën për Hulumtime të Politikave Ekonomike (CEPR) në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Fushat e ekspertizës të Dr Prašnikar përfshijnë ekonomitë në tranzicion, sjelljen e ndërmarrjeve, sipërmarrjen, ekonominë menaxheriale dhe marrëdhëniet e punës. Dr. Janez Prašnikar mbaruar Ph.D. në Universitetin e

Lubjanës (1982). Ka qenë profesor vizitor në Universitetin e Berkeley (vjeshtë 1984), Universitetin Cornell (pranverë 1985) dhe Universiteti Pitsburg (vjeshtë 1987). Nga pranverë 1997-2005 ai ishte profesor i afliuar në në Shkollën e Biznesit në Universitetin e Michiganit. Profesor Prašnikar ka kryer hulumtime dhe këshillime të politikave për kompanitë dhe qeveritë për ish-Jugosllavinë, Kinën dhe Slloveninë. Ai ka shërbyer si president apo anëtar i Bordeve mbikëqyrës në firmat e shumta. Email: janez.prasnikar@ef.uni-lj.si



**Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA**- ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ajo filloi si asistente dhe mori gradën PhD në vitin 2004. Ajo ka qenë lektore në Universitetin e Tetovës (1994-1999) dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë (2004-2004), si dhe universiteteve private në Prishtinë: Iliria (2006-2007), Fama (2006-2007) dhe Globus (2011). Prof Shiroka - Pula ka drejtuar Departamentin e Matematikë dhe Statistikës të Fakultetit të Ekonomisë nga 1999 deri në 2001, si dhe ka qenë Drejtuese e Bordit të Studimeve Master të Programit të Manaxhimit të Shëndetësisë (2002-2003). Përveç angazhimit të saj akademik, Prof Shiroka - Pula ka qenë Ministre e Energjisë dhe Minierave (2007-2011). Aktualisht ajo është deputete në parlamentin e Kosovës nga viti që nga viti 2011. Ajo gjithashtu

ka shumë tekste në fushën vendim-marrjes manaxheriale, programimit operacional dhe sipërmarrjes. Dr. Pula është certifikuar nga programet e shumta mbi Bizneset e vogla dhe të mesme, Sipërmarrjes, dhe Gruaja në ekonomi, në Francë (Qeveria Franceze), në SHBA (Departamenti i Shtetit ) dhe UNIFEM. Aktualisht Prof Shiroka - Pula është profesoreshë e Menaxhimit të SME-ve, Vendimmarrjes Manaxheriale dhe Mjedisit të Biznesit në ciklin e studimeve Bachelor; Sipërmarrja e SME-ve dhe Metodave të Kërkimit në Manaxhim në ciklin e studimeve Master. E-mail:justinapula@hotmail.com



**Prof. Dr. Luigi D'AMBRA**- Profesor Statistike, Departamenti i Ekonomiksit, Institucionet e Manaxhimit (Universiteti i Napolit-Itali). Ai ka realizuar një aktivitet të thelluar didaktik dhe shkencor në Universitetin e Napolit. Aktiviteti i tij është i përqendruar në analizën me shumë ndryshore, matricat, shkallët shumëdimensionale, analizat jo simetrike dhe analizat kumulative korresponduese. Subjekt tjetër e kërkimit të tij kanë qenë modelet log-bilinear dhe log-trilinear. Ka realizuar kurse mbi analizën e të dhënave dhe regresion me variabla diskrete të varura. Ka organizuar disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilën janë diskutuar vlerësimet e sistemeve universitare. Ai gjithashtu ka redaktuar hartimin e disa librave në kuadër të cilësisë së shërbimeve. Në korrik 2015 kam marrë emërimin nga ana e Shefit të Sektorit të Vlerësimit

në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri si pedagog i jashtëm për të vlerësuar programin e studimit të ciklit të tretë, "Ph.D në Statistike "ofruar nga Universitë Nostra Signora del Buon Consiglio të Tiranës. Nga viti 2011 ai është anëtar i Bordit Këshillimor JAQM (Revista e Metodave Sasiore e aplikuar) dhe Editor i Revistës Elektronike për Analizat Statistike e Aplikuar (EJASA) E-mail: dambra@unina.it



**Prof. Dr. Nasir SELIMI** është profesor në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë që nga viti 2002. Në vitin 2004 - 2008 kreu funksionin e Dekanit në FBE. Lëmit në të cilat më së shumti është i përkushtuar, prof. Selimi janë ato të ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. Ka botuar një numër të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Prof. N. Selimi poashtu ka të botuar disa libra dhe teksteve universitare në sferën e ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. E-mail: n.selimi@seeu.edu.mk



**Prof. Dr. Statty STATTEV**- Rektori i Universitetit National and World Economy (UNWE). Zëvendëskryetari i Konferencës së Rektorëve në Bullgari. Nga 2003-2011 ai ka qenë zëvendës Rektori i parë i UNWE, dhe 1999-2003 -Dekani i Fakultetit të Ekonomisë së Përgjithshme të të njëjtit universitet. Në 1984-1985 është specializuar në Departamentin e Ekonomisë Politike në Universitetin shetror "M. Lomonosov ", Moskë, Rusi. Në 1989-1990 ai ka kryer një specializim Fulbright si hulumtues në Departamentin Ekonomik të Universitetit Boston, Massachusetts, USA. Si një profesor vizitor në Universitetin e Bostonit ai jep kurse të rregullta dhe verore lidhur me ekonomitë e vendeve të Evropës Lindore. Ai ka punuar si konsulent i Bankës Botërore. Ka udhëhequr dhe ka marrë pjesë në një numër të madh projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. Stattev është përfaqësues i Republikës së Bullgarisë dhe Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Nismës së Evropës Qendrore për Rrjetin e Universiteteve. Ai ka më shumë se 170 publikime në bullgarisht, rusisht, anglisht, polonisht, greqisht,

serbisht, dhe shqip. Ai është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Kombëtare Bullgare dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të kompanisë Mint. E-mail: sstatte@unwe.bg



**Prof. Dr. Shyqyri LLACI** - është pedagog në FEUT, në fushën e Menaxhimit të Biznesit, Lidershitip dhe qeverisjes së korporatave. Ai ka titullin Doktor në fushën e menaxhimit të produktivitetit dhe është pedagog në FEUT që nga viti 2001. Prof. Dr. Shyqyri Llaci është autor dhe bashkëautor i disa teksteve universitare, një monografi dhe ka qenë i përfshirë në projekte të ndryshme dhe aktivitete lidhur me kërkimet shkencore. Gjithashtu, ka botuar shumë artikuj në Shqipëri dhe jashtë vendit, në revista dhe konferenca të njohura shkencore. Gjatë viteve 1993-1994 dhe 2008-2012 ka qenë Zv/ Dekan dhe në vitet 1994-1995 Dekan i Fakultetit të Ekonomisë. Që nga viti 2012 mban postin e Shefit të Departamentit të Menaxhimit. Anëtar i komisionit të Lartë të Akreditimit të Arsimit të Lartë për 8 vjet deri në vitin 2012. Ka botuar artikuj dhe studime shkencore mbi menaxhimin dhe biznesin, aspekte të organizimit të firmave dhe të efektivitetit organizativ, dimensione të lidërshiptit në mjedisin shqiptar. Menaxhimi dhe motivimi i punonjësve në shekullin e ri, qeverisja e shoqërive aksionere dhe atyre tregtare në tërësi, qeverisja e shoqërive aksionere në sektorin publik dhe në vendet e EJL, menaxhimi i produktivitetit. Fushë e interesit shkencor është edhe menaxhimi krahasues, si edhe reformimi, financimi dhe akreditimi i arsimit të lartë në Shqipëri. E-mail: shyqyrrllaci@feut.edu.al



**Prof. Dr. Tomasz MROCKOWSKI** - ka një eksperiencë të gjerë në mësimdhënie. Ai ka qenë lektor në universitete në Japoni dhe Evropë, duke përfshirë edhe Akademinë Kombëtare të Mbrojtjes në Japoni, Shkollën e Biznesit të Kopenhagen-it, Universiteti i Cambridge, Universiteti i Paris-Sorbonne, dhe ESCP-EAP në Paris. Ai ka realizuar shumë seminare ekzekutive të zhvillimit për kompani lider në Amerikë dhe Evropë, siç janë GM, AT&T, Union Carbide, GE dhe Polaroid. Ai ka qenë anëtar i Bordeve Redaktuesish, i shumë revistave shkencore duke përfshirë Revistën e Zhvillimit të Biznesit Global në Azinë Jugore, Revista e East-West Business, dhe Ëorlvdieë-një publikim shkencor amerikan. Ai ka fituar një numër të madh grandesh nga kompanitë private dhe fondacione publike, duke përfshirë Fondacionin i Andreë A. Mellon, Agjencia Amerikane për zhvillim ndërkombëtar, dhe German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara. Aktualisht, ai është profesor dhe drejtues i Departamentit të Biznesit Ndërkombëtar, Shkolla Kogod e Biznesit, Universiteti Amerikan, Ëashington DC. Ai jep mësim mbi Biznesin Ndërkombëtar dhe Menaxhimin e Tregjeve që janë në Zhvillim, në ciklin e studimeve Master. Ai është autor i shumë artikujve shkencorë, raporteve kërkimore dhe librave. E-mail: mrock@american.edu



**Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS** - Profesor Emeritus i Universitetit të Maqedonisë, Selanik, Greqi. Ka studiuar në Fakultetin e Shkencave Ekonomike e Politike të Universitetit të Bazelit (1962-1968), dhe Ph.D. 1968-1971 në Universitetin e Bazelit. Prof. Tsekouras u bë menaxher i projektit në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Kantonit të Baselit, Zvicër 1971-1974. Në 1977 ai u zgjodh Profesor extraordinarius i Universitetit të Maqedonisë (ish-Shkollës së Lartë të Industrisë) Selanik, Greqi. Në 1980 ai u zgjodh profesor i Universitetit të Maqedonisë, në vitin 2004 ai u zgjodh anëtar i Parlamentit grek dhe Sekretar i Komisionit Parlamentar të Punëve të Jashtme dhe të Mbrojtjes dhe gjatë 2007-2015 ai ishte këshilltar i Presidentit të të Greqisë. Prof. Tsekouras ishte kryetar i Departamentit të Shkencave Ekonomike në Universitetin e Maqedonisë (1987-1991), rektor i Universitetit të Maqedonisë (1991-1997). Ai është zgjedhur Kryetar i Departamentit dhe Politikës Sociale, Kryetari i Departamentit të Ballkanistikës, Sllavistikës dhe Studimeve Orientale, Drejtor i Institutit të Kërkimeve të Universitetit të Maqedonisë. Gjatë periudhës 1998-2015, Prof. Trsekouras është themelues i Shoqatës së Universiteteve Ekonomike të Europës Jugore dhe Lindore dhe Rajonit të Detit të Zi (ASECU). Ai është autor dhe bashkautor i 36 teksteve universitare, monografive dhe artikujve, si dhe 22 kumtesa të paraqitura në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare E-mail: tsekourj@uom.gr



**Prof. Dr. Zhaklina PETO** - Ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës në vitin 1995, me rezultate shumë të mira. Në vitin 1996, është emëruar pedagoge efektive pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në Departamentin e të Drejtës Civile, detyrë të cilën vazhdon ta kryej aktualisht. Gjatë kësaj periudhe, ka realizuar hap pas hapi të gjitha shkallët e kualifikimit shkencor dhe profesional dhe tashmë mban titullin Profesor Doktor. Përvoja shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies si lektore e disa moduleve në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoraturë e ka ndihmuar për të qenë një njohëse e mirë e doktrinës dhe jurisprudencës vendase dhe asaj të huaj. Formimi i saj akademik dhe profesional, si autore e disa teksteve universitare dhe publikimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me një shtrirje kohore, dëshmon për një veprimtari shkencore të pandërprerë në fushën e së drejtës. Ndër vite ka ushtruar disa pozicione drejtuese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës si: Anëtare e



zgjedhur në Këshillin Shkencor të Fakultetit të Drejtësisë, anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, anëtare e Këshillit të Profesorëve, Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Civile e zgjedhur në dy mandate, pozicion të cilin e ushtron aktualisht. E-mail: zhaklinpeto@gmail.com



**Prof. As Dr. Dorina HOXHA** dorina.hoxha@fdu.edu.al ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Padovës (Itali) në 2004. Në 2008 ka përfunduar studimet master të nivelit të dytë LLM në Itali. Temën e masterit si kërkuese shkencore e ka përfunduar pranë PAMECA-s në 2007. Në 2008 ka punuar si eksperte ligjore në programin “Shteti ligjor” një projekt i USAID-it, me detyra kryesore si koordinimi i ndihmës teknike në gjykata pilot duke përfshirë edhe zbatimin e reformës ligjore. Në 2013 ka marrë gradën shkencore “Doktor” me një temë në të drejtën penale, duke analizuar lidhjen e kohës dhe veprës penale. Ajo ka fituar gradën shkencore “Profesor i asociuar” në 2016 dhe është bashkëautore në publikime të ndryshme si “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”, një libër i detyrueshëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Mbi 15 vjet ajo jep leksione në lëndën “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”. Ajo është avokate në çështjet civile dhe penale me një eksperience mbi 15 vjet dhe në vitin 2019 ajo ka fituar çmimin “Toga e artë” nga Shoqata e Avokatëve Penalistë. Ajo është autore e disa artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit.



**Prof. Asoc. Dr. Etleva LESKAJ**, është përgjegjëse e Departamentit të Manaxhimit, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo mban titullin akademik Professore e Asociuar. Gjatë periudhës 2018-2020, ka qenë zv. dekanë për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo ka mbaruar studimet Master në Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë, UT në 2005. Doktoruar në fushën e kulturës organizative në 2009, në fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ajo është lektore e Manaxhimit Strategjik, Planifikimit Strategjik dhe Marrjes së Vendimeve Menaxheriale. Ka marrë pjesë në programe të ndryshme shkëmbimi, për trajnim apo si lektore e ftuar, në Francë, Spanjë, Gjermani, Danimarkë, Angli, Slloveni etj. Prej vitit 2012 është eksperte vleresimi e jashtme pranë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë. Fushat e saj të ekspertizës janë, vendimmarrja manaxheriale, manaxhimi strategjik dhe kultura organizative. E-mail: etlevaleskaj@feut.edu.al



**Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA**- Diplomuar në Financë (2003). Në vitin 2005, ai mori Diplomën e Masterit në Administrim Biznes në Universitetin e Dunarea-s, Galati. Në vitin 2009, ai mori gradën e PhD në Ekonomiks. Prof. Nuta ka realizuar studimet e tij post-doktorale në Universitetin e Messinës (IT) dhe CNAM Paris (FR) në fushën e Përgjegjësisë Sociale dhe Mjedisore e SME-ve. Ai është Redaktor Ekzekutiv i Revistës së Kontabilitetit dhe Menaxhimit dhe anëtar i disa bordeve këshilluese të revistave shkencore. Prof. Nuta është koordinator i Laboratorit të Kontabilitetit dhe Kërkimeve Fiskale, dhe ka një përfshirje aktive në nisimat kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore. Ai është autor dhe bashkautor i shumë librave, më shumë se 30 artikuj të botuar në revista shkencore të njohura ndërkombëtare dhe më shumë se 40 punime nëpër konferenca. Aktualisht ai është Lektor në Universitetin e Danubius Galati, Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Rumania, i përfshirë në aktivitetet e menaxhimit kërkimor dhe mësimdhënies në fushën e financave dhe kontabilitetit. E-mail: floriann@univ-danubius.ro



**Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO** - është Professore e Asociuar në Universitetin e Barit (Departamenti Jonico i Sistemeve të Ekonomisë dhe Ekonomisë së Msdheut). Ajo ka më shumë se 20 vjet përvojë didaktike në Kurset Universitare të të Drejtës civile dhe private, fillimisht si lektore, pastaj si Asistent Professore dhe më në fund si Professore e asociuar. Ka mbaruar doktoraturën në të Drejtën Civile në 2003. Në vitin 1997 u pranua në Shkollën e Specializimit në të Drejtën Civile në Universitetin e Camerino; në vitin 2001 fitoi pozicionin e asistent profesore në të drejtën private, në vitin 2004 fitoi titullin professore e asociuar. Nga viti 2006 deri në vitin 2012 ka qenë anëtare e Bordit të Mësimdhënies të programit PhD të të Drejtës Civile; nga viti 2007 e në vazhdim ajo është anëtare e Komiteteve të ndryshme të Fakultetit dhe ka disa detyra Institucionale (Zëvendëseshfe e Departamentit, Zëvendës dekanë, Kryetare e Këshillit të Kualifikimeve). Aktualisht, ajo është Dekane e Shkollës në Shkencë dhe Menaxhim Teknik Nautical. Ajo ka një përvojë të gjerë në arsimin universitar dhe pasuniversitar, si drejtuese, propozuese dhe koordinatorë shkencore të disa kurseve të avancuara dhe kurse trajnimi (2007-2013). Prej vitit 2000 e në vazhdim, ajo ka bashkëpunuar dhe ka

qenë Koordinatore Shkencore për projekte të ndryshme kërkimore. Prej vitit 2005 e në vazhdim ka realizuar punime shkencore dhe leksione të ndryshme, të paraqitura në takime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e saj kërkimore. Është autore dhe bashkëautore e monografive dhe eseve të botuara në takime Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe është anëtare e redaksisë dhe e Komitetit Shkencor në disa Komitete Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare Email: laura.tafaro@uniba.it

**Recenzentë në këtë numër:** *(në rend alfabetik)*

Armira LAZAJ

Eglantina ZYKA

Elena MYFTARAJ

Etleva BAJRAMI

Etleva LESKAJ

Fatmir MEMAJ

Frederik ÇUÇLLARI

Kreshnik VUKATANA

Ledina ALOLLI

Mirela MERSINI Zamira

SINAJ

Zef PREÇI



## KRITERET PËR BOTIMIN E ARTIKUJVE

*Të nderuar bashkëpuntorë,*

Redaksia e Revistës Shqiptare Social - Ekonomike, nisur nga dëshira e mirë për të patur një nivel sa më të lartë shkencor të artikujve të botuar në këtë revistë, ju paraqet kriteret bazë për pranimin e një artikulli për tu shqyrtuar për botim.

1. Artikulli duhet të dërgohet në dy gjuhë (shqip edhe anglisht). Versioni anglisht do të botohet elektronikisht në faqen eeb të Revistes Shqiptare Social Ekonomike <http://ëëë.aser.revieë-al.org>
2. Artikujt do të pranohen për tu shqyrtuar për botim në numrin e radhës së revistës në se dërgohen jo më vonë se 1 muaj përpara mbylljes së tremujorit respektiv.
3. Artikulli nuk duhet të jetë më i shkurtër se 2.500 fjalë dhe zakonisht jo më i gjatë se 4.000 fjalë.
4. Artikulli duhet të jetë i shkruar në MSËord.
5. Artikulli duhet të ketë një strukturë relativisht standarte. Ai duhet të përmbajë një pjesë të shkurtër dhe koncize në formën e hyrjes dhe të jetë i ndarë në çështje dhe nënçështje. Në fund të artikullit duhet të ketë konkluzione dhe rekomandime.
6. Në artikull është shumë e rëndësishme referimi i burimeve bibliografike në formën e literatures se konsultuar. Ajo duhet të jetë e renditur sipas mbiemrit të autorëve; titullit të botimit, vitit, etj (P.sh. Kodra, A., “Probleme të ekonomive në tranzicion”, Revista Shqiptare Social Ekonomik Nr. 1 (5), 2011, Tiranë, 2011)
7. Tabelat statistikore duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre në një rend vijues. ( P.sh. Tabela 4. Numri i popullsisë në Shqipëri)
8. Grafikët duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre, ku numërimi të bëhet me numra arab, pavarësisht nga numri i tabelave, dhe në rend vijues. (P.sh. Grafiku 4. Struktura e popullsisë sipas gjinisë)
9. Bëni përpjekje të eliminoni tabelat në formate të mëdha. Është e këshillueshme që tabela të tilla të përfshihen në material vetëm kur gjykohen tepër të domosdoshme dhe në një aneks të artikullit duke e referuar në tekst.
10. Artikulli duhet të përmbajë trajtimin e problemeve praktike të ekonomisë shqiptare në tranzicion minimalisht në masën 40%.
11. Artikulli duhet që të ketë të dhëna relevante që i përkasin një periudhe jo më tepër se një vit nga periudha aktuale.
12. Artikulli duhet të mos ketë gabime gjuhësore dhe të punohet patjetër duke përdorur shkronjat ë dhe ç.
13. Në rastet kur përdoren footnotes ato duhet të vendosen me numërim të automatizuar “auto Number”.
14. Artikulli duhet të shoqërohet patjetër me një përmbledhje në gjuhën angleze, e cila duhet të jetë midis 150-250 fjalë.

Artikulli do të pranohet si i mundshëm për tu gjykuar për botim vetëm pas përmbushjes strikte të kushteve të mësipërme. Për çdo artikull do të ketë recensa, vërejtjet themelore të së cilave janë të detyrueshme për tu reflektuar përpara botimit.

Në bazë të politikës së ndjekur nga bordi i revistës dhe të raporteve në trajtimin e temave të ndryshme, stafi i revistës ruan të drejtën për spostimin në kohë të botimit të artikujve të ndryshëm.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe duke pritur bashkëpunimin tuaj të frutshëm!

**Redaksia**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
 Drejtoria e Kerkimit Shkences  
 Tel/Fax: + 355 42 40468  
 E-mail: magim@rotary.org.al

1379

Nr. Prot.

Tirane, 23.04.1999


Lenda. Miratim periodiku shkencor

### Qendres shqiptare për kërkime ekonomike

Ne pergjigje te shkrese suaj date 9.04.1999, Komisioni i Rikonsiderimit te Periodikëve Shkencore prane Drejtorise sone, ju tjofton, se ne mbledhjen e tij te dates 23.04.1999, mori vendimin, qe periodiku Ekonomia dhe Tranzicioni, i botuar prej jush, te konsiderohet periodik shkencor, per tu marre ne konsiderate nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor

DREJTORI

Agha M. KROZI



Per dijeni,

- Universiteteve/ Fakulteteve Ekonomike
- Organizatave Jo-qeveritare Ekonomike
- Akademi se Shkencave / Inst. Shkencore
- Ministrite dhe Institucionet Qendrore
- Parlamentit / Komisionit Ekonomi-Finance-Privatizim, Komisionit te Punes dhe Çeshjteve Sociale